



Ky projekt financohet
nga Bashkimi European

DORACAK PËR LEGJISLACIONIN E RI TË KOSOVËS NGA FUSHA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË



Implementuar nga:



**DORACAK PËR
LEGJISLACIONIN E RI TË
KOSOVËS NGA FUSHA E
SIGURISË DHE
SHËNDETIT NË PUNË**

Fjala e Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale

Parathënie

Vizioni i Qeverisë së Kosovës dhe vet Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale konsiston në ndërtimin e një Shoqërie ku mbrojtja sociale dhe gjithëpërfshirja për të gjithë qytetarët e saj është e siguarar për një jetë me dinjitet ekonomik e social, përfshirë kushte të përshtatshme pune, mundësi të barabarta për punësim. Këto ambicie po mbështeten nga bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe integritet me EU.

Integrimi European i Kosovës, përkrahur nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe nënshkruar në Tetor 2015, është interes nacional dhe objektivë strategjike e Qeverisë së Kosovës. Një nga zotimet e MSA është edhe përmirësimi i kushteve të punës për puntorët kosovar përmes përafrimit gradual të legjislacionit të Kosovës me EU aquis, mbështetja e ligjeve të reja me masa adekuate implementuese dhe mbështetëse.

Kosova kërkoj mbështetje nga BE në fushën e procesit të harmonizimit, dhe pozitivisht u përkrahë nga BE. Ky projekt ofron asistencë teknike për MPMS në transpozimin e Direktivave të BE në legjislacionin nacional në fushën e kushteve të punës.

MPMS përmes Inspektoratit të Punës si organ i pavarur i Administratës Shtetërore, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në kuadër të pushtetit ekzekutiv të Republikës së Kosovës, bënë monitorimin e zbatimit të legjislacionit nga fusha e marrëdhënies së punës si dhe sigurisë dhe shëndetit në punë.

Inspektorati i Punës mbikëqyrë zbatimin e **Ligjit të Punës Nr.03/L-212**, si dhe **Ligjin Nr. 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë**, bashkë me disa dispozita të disa ligjeve tjera, sikurse edhe mbikëqyrë edhe zbatueshmërinë e akteve nënligjore që dalin nga këto ligje dhe që lidhen me marrëdhënien e punës si dhe sigurinë dhe shëndetin në punë.

Dëshiroj të shpreh vlerësimin tim për mundësinë e ofrimit të këtij **Doracakut për Legjislacionin e ri të Kosovës nga Fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë**, që kësaj here ka përfshirë **Ligjin për Siguri dhe Shëndet në Punë me nëntë Rregullore tashmë të miratuara**.

Tashmë, **SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË (SSHP)** është komponent i rëndësishëm i mbrojtjes sociale të punonjësve kundër aspekteve negative të punës, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, përmirëson kënaqësinë në punë dhe fuqizon funksionimin e tregut të punës dhe cilësinë e kapitalit njerëzor. Inspektorati i Punës promovon një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm, duke punuar në preventivë

dhe me përpjekje për të përmirësuar implementimin e ligjit të punës dhe sigurisë së shëndetit më punë. Sigurimi i kushteve më të mira dhe më të sigurta të punës do të thotë cilësi më e lartë e jetës për qytetarët.

Ndryshimi i qasjes, ndryshimi i shprehive dhe ndryshimi i kulturës së punës është me rëndësi të madhe në këtë proces. Ky doracak synon të kontribuoj tutje në ***Qëndrueshmërinë e Implementimit të paketës së Legjislacionit të ri nga fusha e Sigurisë dhe Shëndetit më Punë***, duke siguruar ***ngritjen e kapaciteteve të Inspektoratit të Punës, mekanizmave tjera dhe përgjegjësve tjerë relevant*** nën objektivën e përgjithshme të fushatës mbi Sigurinë e Shëndetin në Punë, duke promovuar dhe vetëdijësuar shoqërinë kosovare mbi legjislacionin e ri rreth sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe kushteve e raporteve tjera të punës me impaktin pozitivë në punësim.

Vlerësimi dhe mirënjohja ime shkojnë për të gjitha palët e përfshira në përgatitjen e këtij Doracaku, nën mbështetjen e asistencës teknike të ofruar nga projekti i Bashkimit European për Harmonizimin e Legjislacionit të Kosovës me atë të Bashkimit European në fushën e kushteve të Punës

Skender REÇICA - Ministër

Përmbajtja

LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË	6
RREGULLORE Nr.04/2014 - PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË VENDIN E PUNËS.....	26
DRAFT- RREGULLORE (MPMS) NR.05 /2014 - PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PËRDORIMIN E PAJISJEVE TË PUNËS NË VENDIN E PUNËS	44
RREGULLORE (MPMS) Nr.02/2016 - PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PËRDORIMIN E PAJISJEVE PERSONALE MBROJTËSE NË VENDIN E PUNËS	62
RREGULLORE (MPMS) Nr. 03/2016 - PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR MBROJTJEN E PUNËSUARËVE LIDHUR ME PUNËN E KRAHUT ME NGARKESA	80
RREGULLORE (MPMS) NR.04/2016 - PËR KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURIMIN E SHENJAVE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË	89
RREGULLORE (MPMS) Nr.05/2016 - PËR KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË TË PUNËMARRËSVE NË RISK NGA AMBIENTET SHPËRTHYESE	117
RREGULLORE (MPMS) Nr. 06/2016 - PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PUNËN ME PAJISJE ME EKRAN SHFAQËS.....	131
RREGULLORE (MPMS) Nr.01/2017 - PËR MBROJTJEN E TË PUNËSUARËVE NGA RREZIQET LIDHUR ME DRIDHJEN NË VENDIN E PUNËS	140
RREGULLORE (MPMS) Nr.02/2017 - PËR MBROJTJEN E TË PUNËSUARËVE NGA RREZIQET LIDHUR ME ZHURMËN NË VENDIN E PUNËS	149

LIGJI NR. 04/L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë.
2. Ky ligj përmban parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidentev, informimit, konsultimit, pjesëmarrjes së balancuar në përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, trajnimit të të punësuarve, përfaqësuesve të tyre dhe udhëzimeve të përgjithshme për zbatimin e këtyre parimeve.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen në sektorin publik, privat, publiko-privat dhe sektorin e administratës shtetërore të nivelit qendror dhe lokal.
2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për: praktikantët, nxënësit dhe studentët në punë praktike gjatë shkollimit, personat në vuajtje të dënimit të angazhuar në punë, vizitorët, bashkëpunëtorët afaristë, shfrytëzuesit e shërbimeve dhe personat në aftësim ose riaftësim profesional te punëdhënësi.
3. Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në sektorët, veprimtaria e të cilëve rregullohet me ligje të veçanta, si: Forcat e Sigurisë së Kosovës, policia, shërbimi i zjarrfikësve dhe shërbimet për mbrojtje dhe shpëtim

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Punëdhënësi** – personi fizik apo juridik i cili siguron punë për një ose më shumë të punësuar, i paguan pagën të punësuarit/ve për punën ose shërbimet e kryera dhe është përgjegjës për subjektin punues;

1.2. **I punësuar** - personi fizik i cili kryen punë ose shërbime me pagesë për punëdhënësin dhe ka marrëdhënie punësimi me punëdhënësin;

1.3. **Siguria dhe shëndeti në punë** – pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës, duke ndërmarrë masat parandaluese, që kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të punësuarëve dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punës;

1.4. **Rrezik** – mundësia që të punësuarit t'i shkaktohet plagë, sëmundje ose problem shëndetësor të menjëhershme apo të mëvonshme, si rezultat i ekspozimit në ambientin e punës ku paraqiten elemente të dëmshme kimike, fizike dhe biologjike, mjeteve të punës dhe makinerive pa pajisje mbrojtëse dhe të pasigurta për përdorim, mënyrës së gabuar të përdorimit të mjeteve të punës dhe makinerive si dhe mënyrës së gabuar të organizimit të punës;

1.5. **Rrezik i mundshëm dhe serioz** - veprimtari e identifikueshme, që paraqet rrezik, dhe e cila në një periudhë të shkurtër kohore mund të shkaktojë dëme materiale ose në njerëz;

1.6. **Sëmundje profesionale** - çdo sëmundje e shkaktuar nga ekspozimi në elementet e dëmshme dhe të rrezikshme kimike, fizike dhe biologjike në ambientin e punës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës;

1.7. **Masat parandaluese** - të gjitha veprimet e ndërmarra dhe të planifikuara në të gjitha proceset e punës në subjektin punues për të evituar dhe minimizuar rreziqeve që shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së punës;

1.8. **Vendet e punës** - përfshijnë të gjitha vendet dhe hapësirat nën mbikëqyrjen direkte dhe indirekte nga punëdhënësit ku të punësuarit duhet të kryejnë aktivitete pune dhe të qëndrojnë gjatë procesit të punës;

1.9. **Dokument i vlerësimit të rrezikut** - dokumenti ku përshkruhen karakteristikat e procesit të punës, identifikimi i burimit të rrezikut, përcaktimi kush mund të rrezikohet, nga çfarë rrezikohet dhe si, vlerësimi i rrezikut për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe përcakton masat e nevojshme dhe të domosdoshme, që duhet të ndërmerren për t'i përparuar këto masa në pajtim me rivlerësimet që do të bëhen kohë pas kohë;

1.10. **Personi i ngarkuar për sigurinë dhe shëndetin në punë** - profesionist i cili është i punësuar te punëdhënësi dhe është i caktuar për të kryer detyra që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë;

1.11. **Persona ose shërbime të specializuara** – personat fizikë ose juridikë, jashtë subjekteve punuese të kualifikuar dhe të licencuar, për të kryer eprimtarinë nga siguria dhe shëndeti në punë në pajtim me këtë ligj;

1.12. **Aksident në punë ose për shkak të punës** - çdo ngjarje të papritur gjatë procesit të punës, që shkakton dëmtimin të menjëhershëm trupor të të punësuarit/ve, dëmtim që sjell paaftësi të përkohshme, paaftësi të përhershme ose që sjell vdekje, si dhe çdo dëmtim tjetër të shëndetit që lidhet drejtpërdrejt me ushtrimin e veprimtarisë së punës;

1.13. **Inspektorati i Punës** – trup ekzekutiv i MPMS që mbikëqyr zbatimin e legjislacionit të punës, përfshirë edhe këtë ligj.

1.14. **Ministria** - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Këshilli Nacional për siguri dhe shëndet në punë

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Ministrit të punës dhe mirëqenies sociale, themelon Këshillin Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, i cili propozon, rekomandon dhe harton politika për përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përcjell në vazhdimësi gjendjen e sigurisë dhe shëndetit në punë të të punësuarve.

2. Këshilli, përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë: tre (3) përfaqësues të Qeverisë, dy (2) përfaqësues të punëdhënësve, dy (2) përfaqësues të të punësuarve, dy (2) ekspertë nga lëmi I sigurisë dhe shëndetit në punë, një (1) ekspert i mjekësisë së punës dhe një (1) ekspert ad hoc, varësisht nga natyra e çështjes.

3. Mandati i anëtareve të Këshillit, është tre (3) vjeçar.

4. Rregullat dhe procedurat e punës së Këshillit, përcaktohen me akt të veçantë të cilën e nxjerr Qeveria.

KREU II DETYRIMET E PUNËDHËNËSIT

Neni 5 Parimet e përgjithshme për punëdhënësin

1. Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës.
2. Punëdhënësi është i detyruar që të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale, nëse nuk i ka siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve të të punësuarit në pikëpamje shëndetësore.
3. Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilën vend të punës.
4. Punëdhënësi është i detyruar të udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të punësuarit.

Neni 6 Detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit

1. Në kuadër të përgjegjësive të tij, punëdhënësi detyrohet të ndër marrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurtë, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.
2. Punëdhënësi duhet të veprojë në vazhdimësi në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e ndërmarra më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike – teknologjike.
3. Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.

Neni 7 Masat parandaluese

1. Punëdhënësi detyrohet të zbatojë masat parandaluese, bazuar në parimet e përgjithshme të parandalimit, si:

- 1.1. shmangien e rreziqeve;
 - 1.2. vlerësimin e rreziqeve të pashmangshme;
 - 1.3. luftimin e rrezikut prej fillimit ose burimit
 - 1.4. tejkalimin e shkaqeve të rrezikut;
 - 1.5. adaptimin e punës ndaj individit, veçmas në lidhje me karakteristikat e vendit të punës dhe ambientit të punës;
 - 1.6. zgjedhjen e pajisjeve, metodave të punës dhe të procesit të punës, për të lehtësuar punën e njëtrajtshme- monotone dhe për t'i reduktuar efektet e saj në shëndet;
 - 1.7. përshtatjen me progresin teknik;
 - 1.8. zëvendësimin e kushteve të rrezikshme, me kushte të pa rrezikshme ose më pak të rrezikshme;
 - 1.9. zhvillimin e një politike parandaluese gjithëpërfshirëse që ka të bëjë me teknologjinë, organizimin e punës, kushtet e punës, marrëdhëniet shoqërore dhe ndikimin e faktorëve që lidhen me mjedisin e punës;
 - 1.10. hënien e përparësisë së sigurisë kolektive në raport me sigurinë individuale;
 - 1.11. sigurimin e udhëzimeve të përshtatshme për punë të sigurtë dhe të shëndetshme, për të punësuarin dhe vendosjen e tyre në vendet e dukshme dhe në gjuhën që e kupton ai/ajo.
2. Punëdhënësi, duke marrë parasysh natyrën e aktiviteteve të subjektit punues, bën vlerësimin e rrezikshmërisë të vendeve të punës, substancave ose preparateve kimike që përdoren.
3. Punëdhënësi, pas vlerësimit të bërë nga paragrafi 2. i këtij neni, nëse është e domosdoshme, duhet të:
- 3.1. sigurojë një nivel më të mirë të sigurisë dhe shëndetit në punë për të punësuarit duke eliminuar faktorët e rrezikut, zvogëluar ndikimin e substancave të dëmshme kimike, përmirësuar pajisjet e punës dhe duke larguar shprehitë e këqija në veprim gjatë procesit të punës;
 - 3.2. integrojë dhe zbatojë masat parandaluese që dalin prej vlerësimit të rrezikut në të gjitha aktivitetet e subjektit punues dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë.
4. Punëdhënësi, kur ia beson detyrat e punës një të punësuarit, detyrohet të marrë parasysh aftësitë e tij/saj për kryerjen e atyre detyrave të punës.

5. Punëdhënësi detyrohet t'i informojë dhe trajnojë të punësuarit për punë të sigurtë, me rastin e zëvendësimit të teknologjisë ekzistuese me teknologji të reja.

6. Punëdhënësi detyrohet që të ndërmarrë masat e duhura për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke siguruar udhëzime të përshtatshme për punë, për të punësuarit në vende të punës me rrezikshmëri të lartë dhe në këto vende të punës mund t'i angazhojë vetëm të punësuarit e trajnuar dhe të kualifikuar për ato vende përkatëse.

Neni 8

Bashkëpunimi i punëdhënësve në zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë

1. Punëdhënësit të cilët shfrytëzojnë të njëjtën zonë (hapësirë, lokale, rrugë, etj.) të punës, janë të detyruar që të bashkëpunojnë në zbatimin e masave që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, duke marrë parasysh natyrën e aktiviteteve të subjekteve punuese.

2. Punëdhënësit duhet të koordinojnë aktivitetet e tyre për të krijuar kushte të sigurta dhe të shëndetshme në punë, dhe t'i informojnë të punësuarit ose përfaqësuesit e tyre për rreziqet në punë.

3. Masat e sigurisë dhe shëndeti në punë, nën asnjë rrethanë, nuk mund të bien në ngarkesë financiare të të punësuarve.

4. Punëdhënësi në cilësinë e investitorit, do të lidhë marrëveshje kontraktuale në formë të shkruar, me personat të cilët kryejnë veprimtari pune për të, përkatësisht me kontraktuesit dhe nënkontraktuesit, në të cilën marrëveshje përcaktohet përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë.

5. Nëse nuk arrihet marrëveshje kontraktuale në pajtim me paragrafin 4. të këtij neni, përgjegjësia për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas këtij ligji, bie mbi investitorin.

Neni 9

Shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin

1. Çdo punëdhënësi është i detyruar të ngarkojë një ose më shumë të punësuar, për të kryer aktivitete nga siguria dhe shëndeti në punë, nëse nuk është përcaktuar ndryshe me këtë ligj.

2. I punësuar i ngarkuar sipas paragrafit 1. të këtij neni, nuk mund të cenohet për shkak të aktiviteteve të tij në lidhje me mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve në punë, as nga punëdhënësi, as nga të punësuarit e tjerë.

3. Për të punësuarin e ngarkuar, i cili ushtron aktivitetet nga siguria dhe shëndeti në punë, punëdhënësi duhet të sigurojë trajnime dhe mjete të nevojshme për punë.

4. Punëdhënësi, në mungesë të personelit të kualifikuar për të udhëhequr me sigurinë dhe shëndetin në punë, brenda subjektit të tij do të angazhojë persona ose institucione për shërbime profesionale të jashtme.

5. Ministria, me akt nënligjor, varësisht prej llojit të veprimtarisë, përcakton kushtet dhe kriteret, për certifikimin dhe licencimin e personave dhe institucioneve për shërbime nga paragrafi 4. i këtij neni.

6. Personat e jashtëm apo institucionet për të ushtruar aktivitetet nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë duhet të jenë të pajisura me mjetet dhe pajisjet e duhura profesionale të punës si dhe aparaturat matëse adekuate.

7. Në rastet kur punëdhënësi angazhon persona apo institucion për shërbime nga siguria dhe shëndeti në punë, është i detyruar t'i informojë dhe njoftojë ata me procesin e punës, me rreziqet e mundshme, me rrethanat të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë në sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve dhe me masat parandaluese që i ka ndërmarrë për të krijuar kushte të sigurta dhe të shëndetshme të punës për të punësuarit.

Neni 10

Të punësuarit e ngarkuar për siguri dhe shëndet në punë

1. Punëdhënësi i cili punëson deri në pesëdhjetë (50) të punësuar, nëse është i aftë/kompetent, mund të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin e masave të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 9 të këtij ligji, me kusht që t'i plotësojë kushtet dhe kriteret sipas paragrafit 5. të nenit 9 të këtij ligji.

2. Punëdhënësi i cili punëson mbi pesëdhjetë (50) e më pak se dyqindpesëdhjetë (250) të punësuar, është i detyruar të caktojë një ekspertë, për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë.

3. Punëdhënësi i cili punëson më shumë se dyqind e pesëdhjetë (250) të punësuar duhet të angazhojë një (1) ose më shumë ekspertë për kryerjen e detyrave nga siguria dhe shëndeti në punë..

Neni 11

Ndihma e parë, fikja e zjarreve, evakuimi i të punësuarve, rreziqet serioze dhe të mundshme

1. Punëdhënësi është i detyruar të ndërmarrë masat e nevojshme për ndihmën e parë, fikjen e zjarrit dhe evakuimin e të punësuarve, të përshtatura sipas natyrës së aktiviteteve dhe madhësisë së subjekteve punuese.

2. Punëdhënësi është i detyruar të organizojë dhe t'i ofrojë ndihmën e parë të punësuarve në rast të lëndimit në punë ose sëmundjeve të papritura dhe të sigurojë përcjelljen e tyre për trajtim mjekësor.

3. Punëdhënësi trajnon personat, që do të kryejnë evakuimin, shpëtimin, fikjen e zjarrit dhe dhënien e ndihmës së parë.

4. Punëdhënësi përmes personave të trajnuar, kryen evakuimin, shpëtimin, fikjen e zjarrit dhe dhënien e ndihmës së parë, për të punësuarit në subjektin punues.

5. Punëdhënësi harton një plan për evakuimin dhe shpëtimin në situata emergjente, të cilin ia bën të ditur të gjithë të punësuarve, si dhe kryen ushtrime praktike, të paktën një herë në dy (2) vjet, në përputhje me këtë plan.

6. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë kontakte të nevojshme me shërbime të jashtme, sidomos lidhur me ndihmën e parë, kujdesin emergjent mjekësor, shërbime shpëtimi dhe shërbimin e zjarrfikësve.

7. Punëdhënësi, në rast të rrezikut të mundshëm dhe serioz për jetën dhe shëndetin e të punësuarve, duhet që:

7.1. sa më shpejtë të jetë e mundur, t'i informojë të gjithë të punësuarit të cilët janë, apo mund të jenë të ekspozuar në rreziqe serioze dhe të mundshme, në mënyrë që të parandalojë ose zvogëlojë rrezikun për jetën dhe shëndetin;

7.2. të marrë masa dhe të japë udhëzime për t'iu mundësuar të punësuarve, që në rast të rreziqeve serioze dhe të mundshme në vendin e punës ta ndërpresin punën dhe menjëherë ta braktisin atë vend të punës dhe të vendosen në një vend të sigurt;

7.3. të përmbahet nga kërkesa drejtuar të punësuarve që të vazhdojnë punën në situatë kur ende ka rrezik serioz dhe të mundshëm;

7.4. të angazhohjë në punë për evitim të rrezikut dhe normalizimin e procesit të punës, vetëm të punësuarit e kualifikuar, të specializuar dhe të trajnuar për kryerjen e punëve në kushte të veçanta dhe me rrezikshmëri të lartë;

7.5. të organizojë vazhdimin e procesit të punës vetëm pas kalimit të rrezikut, përveç në rastet e jashtëzakonshme dhe objektivisht të justifikuara kur ndërprerja e procesit të punës shkakton dëme më të mëdha në njerëz.

8. Të punësuarit në rastet kur janë të rrezikuar seriozisht dhe të cilët nuk mund të kontaktojnë menjëherë me eprorin përgjegjës do të veprojnë sipas aftësive të tyre të fituara me trajnime dhe pajisjeve teknike që kanë në dispozicion, për të shmangur pasojat e një rreziku të tillë.

9. Të punësuarit të cilët veprojnë në përputhje me paragrafit 8. të këtij neni, nuk do të kenë përgjegjësi për pasojat e mundshme, përveç në rastet kur ata veprojnë qëllimisht në kundërshtim me udhëzimet për veprim ose nuk veprojnë fare duke neglizhuar rrezikun.

Neni 12

Detyrimet e punëdhënësit për caktimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale

1. Punëdhënësi, për caktimin e masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, është i detyruar që të:

1.1. miratojë fazën e kërkimit, të projektimit dhe hartimit të planit për përdorimin e pajisjeve të punës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme, që çojnë në zvogëlimin dhe shmangien e rreziqeve, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;

1.2. përpilojë një dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut që përmban masat me karakter teknik, organizativ, higjieniko-sanitar, të cilat do të zbatohen sipas kushteve specifike të vendeve të punës për veprimtarinë përkatëse;

1.3. përcaktojë cilësitë dhe përgjegjësitë e të punësuarit në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë, në përshkrimet e punës, sipas pozicionit përkatës të punës.

Neni 13

Detyrimet e punëdhënësit për zbatimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale

1. Për garantimin e zbatimit të masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, punëdhënësi është i detyruar që të:

1.1. mbikëqyrë punën dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve të personave ose të shërbimeve të jashtme të kontraktuara prej tij për sigurinë dhe shëndetin në punë;

1.2. ndërmarrë masat për të siguruar materialet e nevojshme për informimin dhe trajnimin e të punësuarve dhe të vendosë shenja adekuate për siguri, postera, fletushka, filma, filmime të lidhura me sigurinë dhe shëndetin në punë;

1.3. sigurojë informimin e çdo të punësuarit përpara fillimit të punës për rreziqet ndaj të cilave ai mund të ekspozohet në vendin e tij/saj të punës, si dhe për masat e nevojshme parandaluese dhe mbrojtëse;

1.4. sigurojë që të punësuarit të jenë të pajisur me kualifikimet përkatëse profesionale;

1.5. sigurojë funksionimin e vazhdueshëm dhe të duhur të sistemeve dhe mjeteve mbrojtëse, mjeteve të matjes dhe të kontrollit, si dhe të pajisjeve të diktimit, mbajtjes nën kontroll dhe neutralizimit të substancave të rrezikshme që lirohen gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike;

1.6. marrë në punë të punësuarin në bazë të ekzaminimit mjekësor të tij, në varësi të vendit të punës;

1.7. lejojë përfaqësuesin e të punësuarve, me kërkesën e këtij të fundit, të marrë pjesë gjatë vizitës së inspektimit, si dhe në rastet e hetimit të ngjarjeve;

1.8. lejojë të punësuarin të marrë pjesë në inspektimin dhe hetimin e ngjarjeve, me kërkesën e inspektorit të punës;

1.9. ruajë të gjitha provat në vendngjarje ku ka ndodh aksidenti me pasojë vdekjeje, qoftë ky dhe kolektiv, me përjashtim të rasteve kur ruajtja e atyre provave në vendngjarje mund të shkaktojë një tjetër aksident;

1.10. sigurojë numër të mjaftueshëm të aparateve për fikjen e zjarrit dhe të njëjtat të jenë me mbushje adekuate sipas llojit të shkaktarit të zjarrit;

1.11. mbajë në gjendje të rregullt dhe t'i rimbushë në afate të caktuara të cilat shënohen në tiketën e vendosur në aparat;

1.12. vendosë në vende të përshtatshme aparatet për fikjen e zjarrit;

1.13. instalojë hidrantë në subjektet punuese ku ka rrezik të shtuar për shpërthimin e zjarrit dhe ku konsiderohet që aparatet për fikjen e zjarrit nuk janë të mjaftueshme;

1.14. vendosë hidrantet në vende të dukshme, të përshtatshme dhe duhet të jenë në gjendje të rregullt për përdorim në çdo kohë;

1.15. të shënojë qartë ndalimin e pirjes së duhanit në vendet e punës dhe në vende publike;

1.16. pajisë të punësuarit, në mënyrë të detyrueshme, me pajisje mbrojtëse individuale, të sigurojë mirëmbajtjen e tyre dhe të respektojë afatet e skadimit të përdorimit të tyre.

Neni 14

Përdorimi i mjeteve të punës dhe pajisjeve mbrojtëse individuale gjatë procesit të punës

1. Punëdhënësi është i obliguar që mjetet e punës t'i mbajë në gjendje të rregullt, ta kontrollojë rregullsinë dhe sigurinë e tyre me kontrollat të herëpashershme në afate të përcaktuara me aktin që e miraton ai, përkatësisht me udhëzimin e prodhuesit, dispozitat dhe standardet teknike.

2. Nëse me udhëzimin e prodhuesit nuk janë parashikuar afate të tjera, unëdhënësi është i obliguar që mjetet e punës t'i kontrollojë, provojë dhe testojë:

2.1. para përdorimit të parë,

2.2. pas rekonstruktimit, pas avarisë dhe

2.3. pas zhvendosjes nga njëri vend në vendin tjetër.

3. Punëdhënësi duhet të sigurojë që mjetet e punës dhe pajisjet individuale mbrojtëse, të jenë në gjendje të mirë dhe të rregullt në çdo kohë.

4. Punëdhënësi nuk mund të përdorë apo të vërë në punë, mjetet dhe pajisjet për mbrojtje individuale, në qoftë se ato nuk i përgjigjen standardeve teknike në përputhje me rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Neni 15 **Objektet/ndërtesat**

1. Për çdo objekt / ndërtesë, të destinuar për punë, punëdhënësi duhet të sigurojë:

1.1. secila ndërtesë t'i ketë daljet emergjente;

1.2. planin për evakuim në mënyrë që të punësuarit të evakohen nga objekti/ndërtesa, në rastin e ngjarjeve të papritura, prej të cilave rrezikohet jeta dhe shëndeti i tyre;

1.3. që rrugët dhe daljet emergjente të jenë të shënuara qartë me shenja adekuate, të cilat do të vendosen në vende të dukshme dhe në përputhje me rregullat;

1.4. që rrugët dhe daljet emergjente të jenë të lira, pa pengesa dhe të cilat të dërgojnë direkt jashtë zonës së rrezikshme apo në një zonë të sigurt;

1.5. hapësirën për dhënien e ndihmës së parë dhe pajisjet e nevojshme;

1.6. hapësirën e nevojshme për pushim;

1.7. hapësirat ndihmëse (dhoma për ushqim, dhoma e veshjeve/garderoba, banjo, tualetet ndaras për femra dhe meshkuj);

1.8. objektet për pastrimin dhe dezinfektimin e rrobave të punës dhe pajisjet mbrojtëse.

Neni 16

Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës

1. Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e të punësuarve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës.
2. Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës bëhet nga profesionistë të fushave përkatëse brenda subjektit punues të caktuar nga punëdhënësi, përkatësisht nga shërbimet e jashtme ose personat e kontraktuar nga punëdhënësi.
3. Punëdhënësi, pas procesit të vlerësimit të rrezikshmërisë, është i detyruar të hartojë dokumentin e vlerësimit të rrezikut dhe të ndërmarrë masat mbrojtëse të domosdoshme për sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarve.
4. Mënyra e përgatitjes së dokumentit për vlerësimin e rrezikut, përmbajtja e tij si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut, rregullohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria, në pajtim me ministrinë kompetente për çështjet e shëndetësisë.
5. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë evidencën për lëndime në punë, sëmundjet profesionale dhe të pajisë të lënduarin me fletëlëndim në vend të punës.
6. Punëdhënësi është i detyruar që në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për siguri dhe shëndet në punë, të hartojë raporte mbi aksidentet dhe sëmundjet profesionale në subjektin e tij punues.

Neni 17

Punët me kushte të veçanta

1. Punë me kushte të veçanta sipas dispozitave të këtij ligji, janë punët që mund të kryhen vetëm nga të punësuarit të cilët përveç kushteve të përgjithshme për themelimin e marrëdhënies së punës, duhet të përmbushin edhe kushtet dhe kriteret e veçanta të moshës, gjinisë, aftësisë profesionale, shëndetësore, fizike, gjendjes mendore, psiko-fizike dhe psikologjike.
2. Punëdhënësi nuk duhet të caktojë të punësuarin në punë me kushte të veçanta, në qoftë se paraprakisht, në mënyrë të shkruar, nuk është përcaktuar që i punësuarit i plotëson kushtet dhe kriteret e nevojshme nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Punëdhënësi është i detyruar që para së ta caktojë të punësuarin në vend të punës me kushte të veçanta, ta dërgojë atë në kontroll mjekësor, që të konstatojë aftësitë e tij shëndetësore, fizike dhe psikike, për kryerjen e punëve në atë vend të punës.

4. Punëdhënësi është i detyruar të ofrojë dëshmi me shkrim në përshkrimin e punëve dhe detyrave të punës për të punësuarin në vend të punës me kushte të veçanta, se ai i plotëson kushtet dhe kriteret për punë në vend të punës me kushte të veçanta në pajtim me paragrafin të këtij neni.

5. Punëdhënësi të punësuarin i cili punon në vend të punës me kushte të veçanta të punës, është i detyruar ta dërgojë në kontrollim mjekësorë së paku një herë në vit dhe sa herë të paraqitet nevoja, varësisht prej gjendjes shëndetësore të tij.

Neni 18 **Informimi i të punësuarve**

1. Punëdhënësi merr masa adekuate që të punësuarit apo përfaqësuesit e tyre të marrin të gjitha informatat e nevojshme lidhur me:

1.1. çdo rrezik që mund të paraqitet në vendet e punës, masat mbrojtëse dhe parandaluese si dhe aktivitetet që i ndërmerrë nga ana e tij për eliminimin e këtyre rreziqeve;

1.2. informimin e të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre për ndihmën e parë, masat në rast zjarri, evakuimin, si dhe përgjegjësitë e veçanta të secilit për marrjen e këtyre masave;

1.3. vlerësimin e rrezikut, si dhe masat e ndërmarra për të siguruar shëndetin dhe mbrojtjen në punë për të punësuarit, fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna, gratë me fëmijë në gji dhe personat me aftësi të kufizuara.

2. Punëdhënësi do të ndërmarrë masa adekuate për informimin e punëdhënësit të kontraktuar, të angazhuar me punë në subjektin e tij ekonomik lidhur me nënparagrafët 1.1., 1.2. dhe 1.3. të paragrafit 1. të këtij neni.

2. Punëdhënësi vë në dispozicion të të punësuarve udhëzimet e hollësishme, në zbatimin e dokumentit të vlerësimit dhe parandalimit të rrezikut, për çdo vend pune, i dokumentuar nëpërmjet një procesverbali.

Neni 19

Konsultimet dhe pjesëmarrja e të punësuarve

1. Punëdhënësi duhet të konsultohet me të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre duke i'u mundësuar atyre të marrin pjesë në diskutime lidhur me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë që përfshijnë:

1.1. masat që duhen ndërmarrë, të cilat mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në rritjen e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë;

1.2. informacionin për vlerësimin e rreziqeve, masat mbrojtëse dhe parandaluese, regjistrin dhe raportet e aksidenteve në punë, si dhe raportet nga inspektorati;

1.3. listën e personave ose të shërbimeve të jashtme që kontraktohen për të kryer shërbime sipas nenit 9 të këtij ligji;

1.4. planin dhe organizimin e trajnimeve të punëtorëve nga siguria dhe shëndeti në punë.

2. Përfaqësuesit e të punësuarve dhe anëtarët e Këshillit për Siguri dhe Shëndet në punë kanë të drejtë të kërkojnë nga punëdhënësi që të ndërmarrë masa adekuate dhe të dorëzojnë propozime tek ai me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve për të punësuarit ose të largojë burimet e rrezikut.

3. Të punësuarit ose përfaqësuesit e tyre kanë të drejtë ankese në përputhje me ligjet, tek inspektori i punës, nëse ata konsiderojnë që masat e ndërmarrë nga punëdhënësi nuk janë adekuate dhe të mjaftueshme për sigurinë dhe shëndetin në punë.

4. Përfaqësuesve të të punësuarve duhet t'u jepet rasti që të paraqesin vërejtjet e tyre tek inspektori i punës për mangësitë që kanë ndikim në sigurinë dhe shëndetin në punë.

Neni 20

Trajnimi i të punësuarve

1. Punëdhënësi përkujdeset që secili i punësuar të trajnohet nga siguria dhe shëndeti në punë, për vendin e tij të punës si:

1.1. para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës;

- 1.2. në rast të transferimit apo ndërrimit të vendit të punës;
 - 1.3. në rast të paraqitjes së pajisjeve të reja apo ndërrimit të pajisjeve të punës;
 - 1.4. në rast të përdorimit të teknologjisë së re;
 - 1.5. kohë pas kohe nëse është e domosdoshme.
2. Punëdhënësi përkujdeset që të punësuarit e subjektit të kontraktuar të marrin udhëzimet adekuate për sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë aktivitetit të tyre në subjektin e tij.
 3. Përfaqësuesit e punëtorëve me rol specifik për sigurinë dhe shëndetin në punë do të kenë të drejtë të vijnë trajnime adekuate.
 4. Trajnimi i referuar në paragrafin 1. të këtij neni organizohet gjatë orarit të punës.

KREU III

DETYRIMET E TË PUNËSUARVE

Neni 21

Detyrimet e të punësuarit

1. Çdo i punësuar ka përgjegjësi të përkujdeset për sigurinë dhe shëndetin e vet dhe të personave të tjerë në punë, në përputhje me trajnimin dhe udhëzimet që i janë dhënë nga punëdhënësi.
2. Në përputhje me trajnimin, udhëzimet e dhëna nga punëdhënësi, doracakët, udhëzimet dhe rregulloret teknike, i punësuarit është i detyruar të:
 - 2.1. përdorë me korrektësi makineritë, aparaturat, veglat, pajisjet e transportit mjetet tjera për punë dhe të veprojë me kujdes me substancat e rrezikshme;
 - 2.2. përdorë me korrektësi pajisjet mbrojtëse individuale të vëna në dispozicion të tyre dhe pas përdorimit t'i rikthejë ato në vendin që është planifikuar për ruajtjen e tyre të sigurt;
 - 2.3. mos nxjerrë jashtë shërbimit, të ndryshoj ose të zhvendosë arbitrarisht mekanizmat e sigurisë të montuara në makineri, aparatura, vegla, impiante, ndërtesa dhe t'i përdorë si duhet këta mekanizma;
 - 2.4. njoftojë menjëherë punëdhënësin, personin e ngarkuar për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e të punësuarve, për çdo situatë pune, për të cilën kanë një motiv të arsyeshëm për ta vlerësuar si rast

që paraqet një rrezik të rëndë dhe të menjëhershëm për sigurinë dhe shëndetin në punë;

2.5. respektojë të gjitha detyrimet e përcaktuara prej punëdhënësit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, në të kundërtën do të jetë përgjegjës për dëmin ose aksidentin e shkaktuar.

3. I punësuar do ta lajmërojë inspektorin e punës, nëse punëdhënësi nuk i ka ndërmarrë masat përkatëse për menjanimin, evitimin dhe eliminimin e rrezikut të bazuar nga nënparagrafi 2.4. i paragrafit 2. të këtij neni.

4. I punësuar mund të refuzojë urdhëresën për punë, nëse e ka lajmëruar punëdhënësin, personin për çështje të sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesin e të punësuarve për rrezikun që i kanoset atij/asaj nëse punon në ato kushte të punës, derisa nuk evitohet rreziku dhe nuk krijohen kushtet normale për punë.

KREU IV KONTROLLIMET MJEKËSORE TË TË PUNËSUARVE

Neni 22 Kontrollimet mjekësore

1. Punëdhënësi është i detyruar t'iu sigurojë të punësuarve kontrollime mjekësore në institucionet shëndetësore të licencuara për shërbime nga mjekësia e punës në pajtim me paragrafin 5. të nenit 17 të këtij ligji.

2. Punëdhënësi është i detyruar t'i dërgojë në kontrollim mjekësor të gjithë të punësuarit së paku një herë në tre (3) vite.

KREU V NJOFTIMI PËR AKSIDENTET NË PUNË

Neni 23 Njoftimi për aksidentet në punë

1. Në rastet kur ka ndodhur aksidenti me pasojë lëndimin apo vdekjen e të punësuarit, punëdhënësi është i detyruar ta lajmërojë menjëherë inspektorin e punës.

2. Për aksidentet në punë, inspektori i punës detyrohet të bëjë procesverbal me shkrim me të cilin konstaton gjendjen faktike në kohën kur ka ndodhur aksidenti.

3. Inspektori i punës do t'i marrë masat adekuate në pajtim me ligjin për shkeljet e konstatuara në rastin kur ka ndodhur aksidenti.

4. Inspektori i punës urdhëron me vendim ndërrmarrjen e masave të menjëhershme për evitimin e rrezikut, dhe nëse ka fakte të pamohueshme se kushtet e punës paraqesin rrezik serioz për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve, urdhëron ndalimin e përkohshëm të procesit të punës në atë subjekt punues, njësi të subjektit punues ose makinë punuese.

5. Ndalimi i përkohshëm i procesit të punës do të zgjasë deri në ofrimin e fakteve nga punëdhënësi i subjektit punues, se janë ndërmarrë masat për evitimin e rrezikshmërisë dhe se kushtet aktuale të punës nuk paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e të punësuarve.

6. Inspektori i punës me të pranuar faktet nga paragrafi 4. i këtij neni, do të bëjë inspektim në subjektin punues. Pas konstatimit se kushtet e punës janë përmirësuar dhe është evituar rreziku për sigurinë dhe shëndetin në punë, me vendim lejon vazhdimin e procesit të punës për të punësuarit.

7. Aksidenti vlerësohet se ka ndodhur në punë ose lidhur me punën kur i punësuari lëndohet gjatë:

7.1. kryerjes së punës në subjektin e punës ku është i punësuar;

7.2. kryerjes së një pune tjetër, pa ose me urdhër të punëdhënësit për arsye madhore në interes të punës;

7.3. kohës së pushimit të përcaktuar nga punëdhënësi, vënien në rregull të makinerive, veglave të punës, veshmbathjeve, pastrimit të vendit të punës para ose pas mbarimit të punës;

7.4. kohës së aftësisimit dhe trajnimit profesional;

7.5. dhënies së ndihmës së parë lidhur me punën.

8. Bazuar në pasojat, aksidentet në punë klasifikohen si më poshtë:

8.1. aksidente të cilat shkaktojnë paaftësi të përkohshme për punë;

8.2. aksidente të cilat shkaktojnë paaftësi të përhershme në punë;

8.3. aksidente me pasojë vdekje në punë.

9. Bazuar në numrin e personave të lënduar në punë, aksidentet në punë klasifikohen si më poshtë:

9.1. aksidente individuale kur lëndim në punë pëson vetëm një i punësuar dhe

9.2. aksidente masive ku të paktën dy (2) apo më shumë të punësuar lëndohen në të njëjtën kohë dhe për shkak të arsyeve të njëjta.

KREU VI DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

Neni 24 Mbikëqyrja

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji e bën Inspektorati i Punës.

Neni 25 Gjobat

1. Personi fizik dhe personi juridik, që nuk i zbaton dispozitat e këtij ligji, në procedure ligjore do të dënohet në të holla për secilën dispozitë të shkelur.
2. Për shkelje të dispozitave të nenit 5, 6, 9 dhe 10 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri në dhjetmijë (10.000) Euro..
3. Për shkeljet e dispozitave të nenit 7, 11, 12, 13, 15 dhe 17 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri tridhjetepesëmijë (35.000) Euro.
4. Për shkeljet e dispozitave të nenit 8 të këtij ligji, investitori, kontraktuesi, ose nënkontraktuesi do të dënohet në të holla në shumën prej pesmijë (5.000) deri tridhjetepesëmijë (35.000) Euro.
5. Për shkeljet e dispozitave të nenit 14 dhe 16 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri njëzetepesëmijë (25.000) Euro.
6. Për shkeljet e dispozitave të nenit 18 dhe 19 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri pesëmbëdhjetëmijë (15.000) Euro.
7. Për shkeljet e dispozitave të nenit 20, 22 dhe 23 të këtij ligji, punëdhënësi do të dënohet në të holla në shumën prej pesqind (500) deri njëzetmijë (20 000) Euro.
8. Për shkeljet e dispozitave të nenit 21 të këtij ligji, i punësuar do të dënohet në të holla në shumën prej njëqind (100) deri pesëmijë (5.000) Euro.

Neni 26
Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij ligji, në afat prej gjashtë (6) muajsh.
2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale detyrohet që në vazhdimësi të hartojë akte normative për zbatimin e politikave dhe për të realizuar ërputhshmërinë me *Acquis* në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Neni 27
Shfuqizimi i akteve ligjore

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, shfuqizohet Ligji Nr. 2003/19 për Siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës dhe aktet nënligjore.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 1

Qëllim

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktoj kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës. Kjo rregullore është e harmonizuar me Direktivën e BE-së Nr. 89/654/KEE të datës 30 nëntor 1989, për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendet e punës (direktiva e parë individuale e bazuar në nenin 16 parag.1. të Direktivës kornizë Nr. 89/391/KEE) e amendamentuar me Direktiven 2007/30/EC të Parlamentit dhe Keshillit Evropian me 20 Qershor 2007

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë punëdhënësit dhe vendet e punës, që janë të përcaktuara me legjislacionin nga fusha e sigurisë dhe shëndetin në punë, ku zhvillohet veprimtari pune apo trajnimi lidhur me punën, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojit të subjektit juridik dhe shkaqeve për të cilat zhvillohet puna apo trajnimi.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:

2.1. mjetet e transportit që përdoren jashtë objektit dhe vendet e punës brenda mjeteve të transportit;

2.2. kantieret e lëvizshme apo të përkohshme të punës;

2.3. eksploatimi (nxjerja) e xeheve mbitokësore dhe nëntokësore;

2.4. anijet e peshkimit;

2.5. fushat, pyjet dhe vendet e tjera që janë pjesë e ndërmarrjeve bujqësore dhe pyjore, të cilat ndodhen jashtë ndërtesave dhe territorit të punëdhënësit.

Neni 3

Përkufizimet

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë sikurse shprehjet që janë përcaktuar në Ligjin nr.04/L-161 ‘Për sigurinë dhe shëndetinë në punë’.

Neni 4

Detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit

1. Vendet e punës që përdoren për herë të parë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, duhen ti plotësojnë kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në vendin e punës të përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.
2. Vendet e punës që janë tashmë në përdorim, duhet të plotësojnë kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit, të përcaktuara në Shtojcën 2, në afat prej tri (3) vjetësh nga hyrja në fuqi e kësaj rregullore.
3. Kur vendet e punës u nënshtrohen modifikimeve, zgjerimeve apo rindërtimeve, punëdhënësi merr masat e nevojshme që këto modifikime, zgjerime dhe/apo transformime të jenë në përputhje me kërkesat minimale përkatëse të përcaktuara në Shtojcën 1, të kësaj rregullore.

Neni 5

Kërkesa të përgjithshme për vendet e punës

1. Për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve në vendin e punës, punëdhënësi siguron:
 - 1.1. rrugët të lëvizjes drejt daljeve emergjente dhe daljeve tjera, në çdo kohë duhet të jenë të pastërta dhe pa pegesa;
 - 1.2. mirëmbajtjen teknike të vendit të punës dhe të mjeteve e pajisjeve, si dhe korrigjimin sa më shpejt të jetë e mundur të çfarëdo defekti ose mangësie të konstatuar, që cenon sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës;
 - 1.3. kontrollin dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të pajisjeve të sigurisë dhe mjeteve mbrojtëse për parandalimin e rrezikut dhe eliminimin e rreziqeve;

1.4. pastrimin e vazhdueshëm të vendit të punës, të pajisjeve dhe mjeteve të punës, si dhe mjediseve të tjera të lidhura me vendin e punës me qëllim sigurimin e një niveli të përshtatshëm të higjienës.

Neni 6 Shtojca

Shtojca 1 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për vendet e reja të punës dhe Shtojca 2 për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për vendet ekzistuese, janë pjesë përbërse të kësaj rregulloreje

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Botimit në Gazeten Zyrtare të Republikës së Kosovës.

SHTOJCA 1

KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR VENDET E REJA TE PUNES

1. Përcaktime paraprake

Kërkesat e përcaktuara në këtë shtojcë zbatohen sa herë diktohen nga specifikat, veprimtaria, rrethanat apo rreziku në vendin e punës.

2. Qëndrueshmëria dhe fortësia

Ndërtesat në të cilat ndodhen vendet e punës duhet të kenë një strukturë të fortë dhe të qëndrueshme dhe të përshtatshme me natyrën e përdorimit të tyre.

3. Instalimet elektrike

3.1. Instalimet dhe pajisjet elektrike projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë, që të mos shkaktojnë rrezik për zjarre apo shpërthime.

3.2. Nga kontakti i drejtpërdrejtë apo i tërthortë me elektricitetin, të punësuarit dhe personat e tjerë mbrohen në mënyrë të përshtatshme ndaj risqeve që shkaktojnë lëndime.

3.3. Projektimi, ndërtimi dhe zgjedhja e materialeve dhe mjeteve mbrojtëse të instalimeve elektrike i përshtaten tensionit elektrik, kushteve të jashtme, procesit të punës dhe aftësive të personave që kanë akses në pjesët e instalimit.

3.4. Instalimet dhe pajisjet elektrike kryhen nga shërbimet dhe personat që kanë kualifikimet dhe kapacitetet e nevojshme.

4. Rrugët dhe daljet e emergjencës

4.1. Rrugët dhe daljet e emergjencës mbahen të lira dhe çojnë në mënyrë sa më të drejtpërdrejtë jashtë apo në një zonë të sigurt.

4.2. Në rast rreziku, të punësuarit dhe personat të tjerë duhet të kenë mundësi të evakohen sa më shpejt dhe në mënyrë të sigurt .

4.3. Numri, shpërndarja dhe dimensionet e rrugëve dhe daljeve të emergjencës përcaktohen në varësi të përdorimit, pajisjeve dhe dimensioneve të ambientit të punës dhe numrit maksimal të personave që mund të jenë të pranishëm.

4.4. Dyertë e emergjencës duhet të hapen nga jashtë.

4.4.1. Dyert që janë synuar në mënyrë të veçantë si rrugë daljeje të emergjencës nuk lejohet të jenë rrëshqitëse apo rrotulluese;

4.4.2. Dyert e emergjencës mbyllen në mënyrë të tillë që mund të hapen lehtësisht dhe menjëherë nga një person që mund të ketë nevojë t'i përdorë ato në një situatë urgjence;

4.5. Rrugët dhe daljet e emergjencës të përcaktuara duhet të shënjohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalistikën.

4.5.1. Këto shenja duhet të vendosen në vende të përshtatshme dhe t'i rezistojnë kohës.

4.6. Dyert e emergjencës nuk duhet të kyçen.

4.6.1 Rrugët dhe daljet e emergjencës, si dhe rrugët e qarkullimit dhe dyert që të çojnë tek ato, nuk duhet të kenë pengesa, në mënyrë që të mund të përdoren pa vështirësi në çdo kohë.

4.7. Rrugët dhe daljet e emergjencës, duhet të pajisen me ndriçim të sigurt të një intensiteti të mjaftueshëm në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

5. Zbulimi dhe shuarja e zjarrit

5.1. Vendet e punës duhet të pajisen me mjete të përshtatshme zjarrfikëse, sipas nevojës, me detektorë dhe sisteme alarmi për zjarret në varësi të përmasave dhe përdorimit të ndërtesave, pajisjeve që ato përmbajnë, vetive fizike dhe kimike të substancave që ndodhen në to, dhe numrit maksimal të mundshëm të njerëzve të pranishëm.

5.2. Pajisjet joautomatike kundër zjarrit duhet të jenë lehtësisht të arritshme, të thjeshta për t'u përdorur në përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalistikën.

Shenjat e tilla duhet të jenë të përshtatshme dhe përherëshme.

6. Ajrimi i vendeve të mbyllura të punës

6.1. Vendet e mbyllura të punës duhet të kenë ajrim të mjaftueshëm, që mundëson shkëmbimin e nevojshëm të ajrit, duke pasur parasysh metodat dhe natyrën e punës, ngarkesat fizike të të punësuarëve, si dhe standardet për qarkullimin e ajrit, temperaturën dhe lagështinë relative.

6.2. Kur përdoren instalime të kondicionimit të ajrit apo të ajrimit mekanik, ato duhet të funksionojnë në atë mënyrë, që të punësuarit të mos jenë të ekspozuar ndaj rrymave të ajrit që shkaktojnë parehati dhe respektimin e kërkesave higjienike.

6.3. Në rastet kur përdoret një sistem ajrimi mekanik, ai mbahet në gjendje funksionale.

6.4. Çdo grumbullim papastërtish, që duke ndotur atmosferën, mund të krijojë një rrezik të menjëhershëm për shëndetin e të punësuarëve dhe të njëjtat duhet të hiqet menjëherë. Në rastin kur ka një mundësi për lëshimin aksidental të substancave toksike apo krijimit të përqendrimeve shpërthyesë dhe të ndezshme apo krijimin e risqeve të tjera në vendet e punës apo vendet individuale të punës, sistemet e ajrimit duhet të funksionojnë automatikisht dhe çdo avari duhet të njoftohet nga një sistem kontrolli.

7. Temperatura e mjedisit të punës

7.1. Gjatë orarit të punës, temperatura në mjediset ku ndodhen vendet e punës duhet të jenë të përshtatshme për qeniet njerëzore, duke pasur parasysh metodat e punës që përdoren dhe ngarkesat fizike të punësuarve.

7.2. Temperatura në mjediset e pushimit, të ngrënies, të ndihmës së parë, higjieno-sanitare, si dhe ato të personelit që kryen shërbim të vazhdueshëm duhet t'i përshtaten qëllimit të posaçëm që kanë këto hapësira.

7.3. Dritaret, çatitë prej xhami dhe ndarëset prej qelqi, duhet të ndërtohen apo të përshtaten që ti shmangin pasojat nga ndriçimi i diellit, duke pasur parasysh llojin e punës dhe të vendit të punës.

8. Ndriçimi natyral dhe artificial i mjedisit të punës

8.1. Vendet e punës preferohen të kenë ndriçim natyral të mjaftueshëm dhe duhet të pajisen me ndriçim artificial të përshtatshëm për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punësuarve dhe personave të tjerë, në përputhje me rregulloret e veçanta dhe standardet. Ngjyrat e ndriçimit artificial që përdoret nuk duhet të pengojnë apo ndikojnë perceptimin e shenjave dhe sinjaleve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

8.2. Instalimet për ndriçimin e mjedisit të punës dhe të vendkalimeve, duhet të vendosen në mënyrë të tillë që lloji i ndriçimit të mos përbëjë rrezik për aksidente të punësuarve dhe personave të tjerë.

8.3. Vendet e punës dhe hapësirat në të cilat të punësuarit dhe persona të tjerë janë veçanërisht të ekspozuar ndaj rreziqeve, në rast të ndërprerjes së ndriçimit artificial, duhet të pajisen me ndriçim urgjence me intensitet të mjaftueshëm.

9. Dyshemetë, muret, tavanet e mjediseve të punës dhe çatitë

9.1. Dyshemetë e vendeve të punës duhet të jenë ndërtuara dhe të mirëmbahen në mënyrë të tillë që të jenë të palëvizshme dhe të qëndrueshme, jo të rrëshqitshme, pa disnivele, shpate, gunga dhe të çara të rrezikshme. Vendet e punës që janë brenda ndërtesave apo objekteve të destinuara për kryerjen e atyre punëve, duhet të jenë të izoluar në mënyrë adekuate, duke pasur parasysh llojin e ndërmarrjes përfshirë dhe aktivitetin fizik të të punësuarëve.

9.2. Sipërfaqet e dyshemeve, mureve dhe tavaneve të vendeve të punës ndërtohen në mënyrë të përshtatshme që të mos vështirësojnë pastrimin apo riparimin e tyre, sipas kërkesave të prodhimit dhe të higjienës.

9.3 Muret e ndërtuara nga materiale të tejdukshme, e posaçërisht atyre prej qelqit në mjedise apo pranë vendeve të punës dhe rrugët lëvizëse, duhet të jenë të pastërta dhe qartësisht të shënuara, dhe të përbëra nga materiale të sigurta, thyerja apo dëmtimi i të cilave nuk do haktojë lëndime të punësuarëve apo personave të tjerë.

9.4 Aksesi në çati dhe sipërfaqe të tjera që përbëhen nga materiale me fortësi të pamjaftueshme, lejohet vetëm kur përdoren pajisje që garantojnë një punë të sigurt, duke marrë masa për parandalimin e shkeljes së paqëllimitë në këto sipërfaqe apo rënies bashkë me to.

10. Dritaret dhe dritaret në çatitë (pullazet)

10.1. Dritaret, dritaret në çatitë (pullazet) dhe pajisjet e ajrimit të vendeve të punës duhet të jenë të manovrueshme në mënyrë të sigurt, që të mos shkaktojnë rreziqe për të punësuarit rreth ndërtesës. Kur janë ato të hapura, nuk duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë që të shkaktojnë rrezik.

10.2. Dritaret dhe dritaret në çatitë (pullazet) projektohen në mënyrë të tillë që pajisjet për pastrimin e tyre të mos përbëjnë rrezik për të punësuarit të pranishëm në ndërtesë dhe përreth saj.

11. Dyert dhe portat

11.1. Pozicioni, numri, përmasat dhe lloji i dyerve dhe portave dhe materiali prej të cilave ato janë prodhuar, përcaktohen sipas natyrës së veprimtarisë, llojit të mjediseve të punës, mjeteve të transportit dhe ngarkesës së tyre, si dhe kërkesave të evakuimit në rast të aksidenteve dhe zjarrit.

11.2. Dyert të tejdukshme, duhet të shënohen apo të mbrohen me qëllim shmangien e përplasjeve dhe shënjimimi të bëhet në një lartësi në nivelin e syrit.

11.3. Dyert dhe portat rrotulluese dhe lëkundëse duhet të jenë të tejdukshme apo të kenë pjesë të hapura që sigurojnë shikueshmëri.

11.4. Në qoftë se sipërfaqet të tejdukshme në dyer dhe porta nuk janë prej materialeve të sigurta dhe nëse ekziston rreziku që personat mund të dëmtohen në qoftë se dera thyhet, sipërfaqet duhet të mbrohen kundër thyerjeve.

11.5. Dyert dhe hyrjet e rrëshqitshme duhet të jenë të pajisura me një pajisje të sigurisë për të parandaluar rrëshqitjen dhe rënien e tyre jashtë shinave.

11.6. Dyert dhe portat që hapen nga jashtë pajisen me një mekanizëm kundër lëvizjeve mbrapa apo rënies së pakontrolluar.

11.7. Dyert përgjatë rrugëve të daljes së emergjencës duhet të shënjohen në mënyrë të përshtatshme në përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalistikën. Ato duhet të hapen nga brenda-jashtë, në çdo kohë, pa ndonjë ndihmë të veçantë. Ato duhet të jetë të gatshme për hapje edhe kur vendet e punës janë të zëna.

11.8. Kur portat e parashikuara për qarkullimin e mjeteve të transportit nuk mundësojnë edhe lëvizjen e sigurt të këmbësorëve, në afërsi të tyre duhet të ekzistojnë dyert e kalimit të këmbësorëve, të cilat shënjohen në mënyrë të dallueshme dhe janë lehtësisht të hapshme.

11.9. Dyert mekanike dhe porta duhet të funksionojë në mënyrë të tillë që nuk ka rrezik të ndonjë aksidentit të të unësuarve dhe personat e tjerë. Ato duhet të pajisen me mjete emergjence lehtësisht të arritshme dhe të identifikueshme nëse është e nevojshme. Në rast të ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike, kur dyert mekanike nuk hapen automatikisht, atëherë ato duhet të hapen manualisht.

12. Rrugët e lëvizjes - zonat e rrezikut

12.1. Rrugët e lëvizjes, përfshirë shkallët, shkallët vertikale të fiksuara, rampat ngarkuese fikse dhe rampat ngarkuese të lëvizshme, vendosen dhe përlloragiten në mënyrë që të sigurojnë përdorim të lehtë, të sigurt dhe të përshtatshëm për këmbësorët apo mjetet, në mënyrë të tillë që të mos rrezikohen këmbësorët dhe personat në afërsi të këtyre rrugëve të lëvizjes. Rrugët e lëvizjes duhet të përcaktohen, organizohen dhe të kenë përmasat në varësi të qëllimit të tyre.

12.2. Përlloragritja e përmasave të rrugëve të lëvizjes së këmbësorëve apo mallrave, varet nga numri i përdoruesve të mundshëm, dhe lloji i veprimtarive të ndërmarrjes, gjithmonë duke siguruar hapësirë të sigurt të mjaftueshme për këmbësorët. Kur mjetet e transportit lëvizin në këto rrugë parashikohet një hapësirë sigurie për këmbësorët.

12.3. Ndërmjet rrugëve të lëvizjes së mjeteve dhe dyerve, portave, kalimeve për këmbësorët, korridoreve dhe shkallëve, sigurohet hapësirë e mjaftueshme.

12.4. Rrugët e lëvizjes shënjohen, mirëmbahen dhe kontrollohen në përputhje me rregulloret përkatëse.

12.5. Nëse mjediset e punës, për shkak të natyrës së punës, përmbajnë zona të rrezikshme që paraqesin rrezik të rënies së të punësuarit dhe objekteve nga lartësia, ato duhet të jenë të pajisura, me shenja dalluese dhe mjete që parandalojnë hyrjen e paautorizuar të punësuarit.

12.6. Të punësuarit të cilët janë të autorizuar për të hyrë në zonat e rrezikut, punëdhënsi duhet të ndërmerret masa të përshtatshme për mbrojtjen dhe sigurinë e të e tyre.

13. Shkallët dhe platformat lëvizëse

13.1 Shkallët dhe platformat lëvizëse duhet të funksionojnë në mënyrë të sigurt, duke u pajisur me mjetet e nevojshme të sigurisë dhe butonat e emergjencës, të cilat duhet të jenë të lehtësisht të dukshme dhe të arritshme.

14. Platformat dhe rampat ngarkuese

14.1 Platformat dhe rampat ngarkuese përshtaten me përmasat e ngarkesave dhe teknologjitë e zbatuara në ngarkim-shkarkim. Ato duhet të kenë të paktën një pikë daljeje.

14.2 Kur është teknikisht e realizueshme, platformat me gjatësi të konsiderueshme duhet të kenë një pikë daljeje në secilin skaj.

14.3 Rampat ngarkuese duhet, të jenë të sigurta aq sa të parandalojnë rënien e punëmarrësve apo personave të tjerë dhe të makinave të përdorura.

15. Përmasat e mjedisit të brendshëm të punës dhe hapësirat në vendet e punës – Lëvizja e lire në vendin e punës

15.1 Mjediset e brendshme të punës duhet të kenë sipërfaqe, lartësi dhe vëllim të mjaftueshëm ajri, në mënyrë që të punësuarit të kenë mundësi të kryejnë punën e tyre pa rreziqe për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e tyre.

15.2 Përmasat e hapësirave të lira, të pamobiluara në vendin e punës përllogariten në mënyrë të tillë që t'i lejojnë të punësuarve lëvizjeje të mjaftueshme të lire për të kryer punën e tyre. Nëse kjo nuk mund të arrihet për arsye specifike të vendit të punës, punësuarit duhet t'i sigurohet një hapësirë e lirë lëvizjeje e mjaftueshme afër vendit të tij individual të punës.

16. Mjediset e çlodhjes (pushimit)

16.1 Mjediset e çlodhjes (pushimit) u sigurohen të punësuarve kur procesi teknologjik ose prania e një numri të caktuar të punësuarish kërkon ndërprerje të shpeshtë ose të gjatë të punës, për të garantuar regjime pune të sigurta dhe të

shëndetshme. Kjo dispozitë nuk zbatohet për të punësuarit që punojnë në zyra apo mjedise të ngjashme, që krijojnë të njëjtën mundësi çlodhjeje (pushimi) gjatë pushimit.

16.2 Mjediset e çlodhjes duhet të jenë lehtësisht të arritshme nga të punësuarit, me hapësirë, ajrim, temperaturë dhe ndriçim të mjaftueshëm, në përputhje me numrin e personave që i përdorin ato në të njëjtën kohë. Këto mjedise duhet të jenë të pajisura me mjete në përputhje me natyrën e çlodhjes së nevojshme dhe me tavolina dhe karrige me mbështetëse.

16.3 Ndalohet pirja e duhanit në mjediset e çlodhjes (pushimit).

16.4 Nëse oraret e punës ndërpriten rregullisht dhe shpesh dhe nuk ka mjedise çlodhjeje (pushimi), duhet të ofrohen dhoma apo hapësira të tjera në të cilat të punësuarit mund të qëndrojnë gjatë këtyre ndërprerjeve, kurdo që kjo nevojitet për sigurinë apo shëndetin e tyre.

17. Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji

17.1. Për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji, duhet të krijohen kushte të përshtatshme për të qëndruar dhe për t'u çlodhur, (pushuar).

18. Pajisjet higjieno-sanitare

18.1. Dhomat e zhveshjes dhe dollapët personale .

18.1.1. Të punësuarve iu sigurohen dhoma të përshtatshme për t'u ndërruar në qoftë se ata duhet të veshin rroba të veçanta pune dhe kur, për arsye të shëndetit ose të etikës, atyre nuk mund t'u kërkohet të ndërrohen në një dhomë tjetër. Dhomat e ndërrimit duhet të jenë lehtësisht të arritshme, të kenë kapacitete të mjaftueshme dhe të jenë pajisur me ndenjëse.

18.1.2. Dhomat e ndërrimit duhet të jenë mjaftueshëm të mëdha dhe të kenë ambiente për t'i krijuar mundësi çdo punëmarrësi për të kyçur veshjet e tij gjatë orarit të punës. Nëse rrethanat e kërkojnë (p.sh. substancat e rrezikshme, lagështia, papastërtia), dollapët me kyç (dryn) për veshjet e punës duhet të jenë të ndarë nga ato për veshjet e zakonshme.

18.1.3. Duhet parashikuar dhoma të ndara të ndërrimit apo përdorime të ndara të dhomave të ndërrimit për burrat dhe gratë.

18.1.4 Nëse për dhomat e ndërrimit nuk kërkohen kushtet sipas pikes

18.1.1, secilit të punësuar u sigurohet një vend për të vendosur veshjet e tij.

18.2. Dushet dhe lavamanët

18.2.1. Duhet të sigurohen dushe të përshtatshme për të punësuarit në qoftë se kërkohen nga natyra e punës ose nga arsye shëndetësore. Dushet duhet të jenë në dhoma të ndara për përdorim të veçantë për burrat dhe gratë.

18.2.2. Dhomat e dusheve duhet të kenë përmasa të përshtatshme për t'i dhënë mundësi çdo të punësuarit që të lahët pa pengesa në kushtet e një standardi të përshtatshëm të higjienës.

18.2.3. Dushet duhet të pajisen me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë.

18.2.4. Kur dushet nuk janë të nevojshme në bazë të nënparagrafit të parë të 18.2.1, duhet të ketë lavamanë të përshtatshëm, me ujë të rrjedhshëm (ujë të ngrohtë nëse është e nevojshme) në afërsi të vendit individual të punës dhe dhomave të ndërrimit. Këta lavamanë duhet të jenë të ndarë apo të përdoren veçmas për burrat dhe gratë.

18.2.5. Kur dhomat e dusheve apo mjediset me lavamanë janë të ndara nga dhomat e veshjes, duhet të ketë komunikim të lehtë ndërmjet tyre.

18.3. WC-të dhe lavamanët

18.3.1 Në afërsi të vendeve individuale të punës, dhomave të çlodhjes, dhomave të ndërrimit dhe dhomave ku ndodhen dushet dhe lavamanët duhet të ketë hapësira të ndara, me një numër të përshtatshëm të WC-ve dhe lavamanëve veçmas për burrat dhe gratë.

19. Dhomat e ndihmës së parë

19.1. Në varësi të përmasave të ndërmarrjes, llojit të punës dhe shpeshësisë e seriozitetit të aksidenteve në punë duhet të ketë një ose më shumë dhoma të ndihmës së parë.

19.2. Dhomat e ndihmës së parë duhet të pajisen me pajisjet dhe mjetet bazë për dhënien e ndihmës së parë. Dhomat e ndihmës së parë shënjohen me shenja të dallueshme sipas legjislacionit në fuqi dhe duhet të mundësojnë hyrjen dhe përdorimin e barelave.

19.3. Përveç përcaktimeve në pikat 19.1 dhe 19.2, në të gjitha vendet e punës ku kushtet e punës e kërkojnë duhet të sigurohen mjete për dhënien e ndihmës së parë. Këto duhet të shënjohen me shenja të posaçme të dallueshme dhe të jenë lehtësisht të arritshme.

20. Të Punësuarit me aftësi të kufizuara

20.1. Mjediset e punës, nëse është e nevojshme, përshtaten në mënyrë të tillë që të marrin parasysh nevojat e të punësuarve me aftësi të kufizuara.

20.2. Kjo dispozitë vlen në veçanti sa u përket dyerve, rrugëkalimeve, shkallëve, dusheve, lavamanëve, WC-ve dhe vendeve individuale të punës të përdorura apo të zëna direkt nga personat me aftësi të kufizuara.

21. Vendet e punës në mjedis të hapur (dispozita të veçanta)

21.1. Vendet individuale të punës, rrugët e qarkullimit dhe zonat apo instalimet e tjera jashtë, të cilat përdoren apo janë të zëna me të punësuar gjatë veprimtarisë së tyre, duhet të organizohen në mënyrë të tillë që këmbësorët dhe mjetet të mund të lëvizin në mënyrë të sigurt. Përcaktimet në pikat 12, 13 dhe 14 zbatohen edhe për rrugët kryesore të lëvizjes në ambientet e jashtme të ndërmarrjes (rrugët e lëvizjes që çojnë në vendet individuale të punës fikse), për rrugët e lëvizjes që përdoren për mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe mbikëqyrjen e instalimeve të ndërmarrjes dhe për platformat e ngarkimit. Përcaktimet në pikën 12 janë të zbatueshme, gjithashtu, për vendet e punës në ambient të hapur.

21.2. Vendet e punës në mjedise të hapura duhet të ndriçohen me ndriçim të përshtatshëm artificial, nëse ndriçimi natyral nuk është i mjaftueshëm.

21.3. Nëse të punësuarit punojnë në mjedise të hapura, vendet individuale të punës organizohen, për sa është e mundur, në mënyrë të tillë që të punësuarit:

21.3.1. të jenë të mbrojtur ndaj kushteve të motit me shi dhe nëse është e nevojshme ndaj objekteve që bien;

21.3.2. të mos jenë të ekspozuar ndaj niveleve të dëmshme të zhurmës dhe as ndaj ndikimeve të dëmshme të lëndëve që çlirohen në mjediset e hapura, të tilla si: gazra, avuj ose pluhura;

21.3.3. të jenë në gjendje të largohen nga vendi i tyre i punës me shpejtësi në rast të një rreziku apo të mund të ndihmohen me shpejtësi;

21.3.4. të shmangin mundësin e rrëshqitjes apo rënies.

22. Furnizimi me ujë

Të Punësuarve iu sigurohet ujë i rrjedhshëm për përdorim në mjediset e higjienës personale dhe ujë higjienikisht i pastër në mjediset e punës.

SHTOJCA 2

KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR VENDET EKZISTUESE TË PUNËS

1. Përcaktime paraprake

Kërkesat e përcaktuara në këtë shtojcë zbatohen sa herë diktohen nga specifikat, veprimtaria, rrethanat apo rreziku në vendin e punës.

2. Qëndrueshmëria dhe fortësia

Ndërtesat në të cilat ndodhen vendet e punës duhet të kenë një strukturë të fortë dhe të qëndrueshme, të përshtatshme me natyrën e përdorimit të tyre.

3. Instalimet elektrike

3.1. Instalimet dhe pajisjet elektrike projektohen dhe ndërtohen në mënyrë të tillë, që të mos përbëjnë risk për zjarre apo shpërthime.

3.2. Të punësuarit dhe personat e tjerë mbrohen në mënyrë të përshtatshme ndaj risqeve për lëndime të shkaktuara nga kontakti i drejtpërdrejtë apo i tërthortë me elektricitetin.

3.3 Projektimi, ndërtimi dhe zgjedhja e materialeve dhe mjeteve mbrojtëse të instalimeve elektrike i përshtaten tensionit elektrik, kushteve të jashtme, procesit të punës dhe aftësive të personave që kanë akses në pjesët e instalimit.

3.4. Instalimet dhe pajisjet elektrike kryhen nga shërbime dhe nga personat që kanë kualifikimet dhe kapacitetet e nevojshme.

4. Rrugët dhe daljet e emergjencës

4.1. Rrugët dhe daljet e emergjencës mbahen të lira dhe çojnë në mënyrë sa më të drejtpërdrejtë jashtë apo në një zonë të sigurt.

4.2. Në rast rreziku, të punësuarit dhe personat të tjerë duhet të kenë mundësi të evakohen sa më shpejt dhe në mënyrë të sigurt .

4.3. Numri, shpërndarja dhe dimensionet e rrugëve dhe daljeve të emergjencës përcaktohen në varësi të përdorimit, pajisjeve dhe dimensioneve të ambientit të punës dhe numrit maksimal të personave që mund të jenë të pranishëm.

4.4. Dyertë e emergjencës duhet të hapen nga jashtë.

4.4.1. Dyert që janë synuar në mënyrë të veçantë si rrugë daljeje të emergjencës nuk lejohet të jenë rrëshqitëse apo rrotulluese;

4.4.2. Dyert e emergjencës mbyllen në mënyrë të tillë që mund të hapen lehtësisht dhe menjëherë nga një person që mund të ketë nevojë t'i përdorë ato në një situatë urgjence;

4.5. Rrugët dhe daljet e emergjencës të përcaktuara duhet të shënjojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalistikën.

4.5.1. Këto shenja duhet të vendosen në vende të përshtatshme dhe t'i rezistojnë kohës.

4.6 Dyert e emergjencës nuk duhet të kyçen.

4.6.1 Rrugët dhe daljet e emergjencës, si dhe rrugët e qarkullimit dhe dyert që të çojnë tek ato, nuk duhet të kenë pengesa, në mënyrë që të mund të përdoren pa vështirësi në çdo kohë.

4.7. Rrugët dhe daljet e emergjencës, duhet të pajisen me ndriçim të sigurt të një intensiteti të mjaftueshëm në rastet e ndërprerjes së energjisë elektrike.

5. Zbulimi dhe shuarja e zjarrit

5.1. Vendet e punës duhet të pajisen me mjete të përshtatshme zjarrfikëse dhe, sipas nevojës, me detektorë dhe sisteme alarmi për zjarret në varësi të përmasave dhe përdorimit të ndërtesave, pajisjeve që ato përmbajnë, vetive fizike dhe kimike të substancave që ndodhen në to, dhe numrit maksimal të mundshëm të njerëzve të pranishëm.

5.2. Pajisjet joautomatike kundër zjarrit duhet të jenë lehtësisht të arritshme, të thjeshta për t'u përdorur në përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalistikën.

Shenjat e tilla duhet të jenë të përshtatshme dhe përhershme.

6. Ajrimi i vendeve të mbyllura të punës

6.1. Vendet e mbyllura të punës duhet të kenë ajrim të mjaftueshëm, që mundëson shkëmbimin e nevojshëm të ajrit, duke pasur parasysh metodat dhe natyrën e punës, ngarkesat fizike të të punësuarëve, si dhe standardet për qarkullimin e ajrit, temperaturën dhe lagështinë relative.

6.2. Kur përdoren instalime të kondicionimit të ajrit apo të ajrimit mekanik, ato duhet të funksionojnë në atë mënyrë, që të punësuarit të mos jenë të ekspozuar ndaj rrymave të ajrit që shkaktojnë parehati dhe respektimin e kërkesave higjienike.

6.3. Në rastet kur përdoret një sistem ajrimi mekanik, ai mbahet në gjendje funksionale.

6.4. Çdo grumbullim papastërtish, që duke ndotur atmosferën, mund të krijojë një rrezik të menjëhershëm për shëndetin e të punësuarëve dhe të njëjtat duhet të hiqet menjëherë.

Në rastin kur ka një mundësi për lëshimin aksidental të substancave toksike apo krijimit të përqendrimeve shpërthyes dhe të ndezshme apo krijimin e risqeve të tjera në vendet e punës apo vendet individuale të punës, sistemet e ajrimit duhet të funksionojnë automatikisht dhe çdo avari duhet të njoftohet nga një sistem kontrolli.

7. Temperatura e mjedisit të punës

7.1. Gjatë orarit të punës, temperatura në mjediset ku ndodhen vendet e punës duhet të jenë të përshtatshme për qeniet njerëzore, duke pasur parasysh metodat e punës që përdoren dhe ngarkesat fizike të punësuarve.

7.2. Temperatura në mjediset e pushimit, të ngrënies, të ndihmës së parë, higjieno-sanitare, si dhe ato të personelit që kryen shërbim të vazhdueshëm duhet t'i përshtatet qëllimit të posaçëm që kanë këto hapësira.

7.3. Dritaret, çatitë prej xhami dhe ndarëset prej qelqi, duhet të ndërtohen apo të përshtaten që të shmangin pasojat nga ndriçimi i diellit, duke pasur parasysh llojin e punës dhe të vendit të punës.

8. Ndriçimi natyral dhe artificial i mjedisit të punës

8.1. Vendet e punës preferohet të kenë ndriçim natyral të mjaftueshëm dhe duhet të pajisen me ndriçim artificial të përshtatshëm për mbrojtjen e sigurisë dhe shëndetit të punësuarve dhe personave të tjerë, në përputhje me rregulloret e veçanta dhe standardet. Ngjyrat e ndriçimit artificial që përdoret nuk duhet të pengojnë apo ndikojnë perceptimin e shenjave dhe sinjaleve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

8.2. Instalimet për ndriçimin e mjedisit të punës dhe të vendkalimeve, duhet të vendosen në mënyrë të tillë që lloji i ndriçimit të mos përbëjë rrezik për aksidente të punësuarve dhe personave të tjerë.

8.3. Vendet e punës dhe hapësirat në të cilat të punësuarit dhe persona të tjerë janë veçanërisht të ekspozuar ndaj rreziqeve, në rast të ndërprerjes së ndriçimit artificial, duhet të pajisen me ndriçim urgjence me intensitet të mjaftueshëm.

9. Dyshemetë, muret, tavanet e mjediseve të punës dhe çatitë

9.1. Dyshemetë e vendeve të punës duhet të jenë ndërtuara dhe të mirëmbahen në mënyrë të tillë që të jenë të palëvizshme dhe të qëndrueshme, jo të rrëshqitshme, pa disnivele, shpate, gunga dhe të çara të rrezikshme. Vendet e punës që janë brenda ndërtesave apo objekteve të destinuara për kryerjen e atyre

punëve, duhet të jenë të izoluar në mënyrë adekuate, duke pasur parasysh llojin e ndërmarrjes përfshirë dhe aktivitetin fizik të punëtorëve.

9.2. Sipërfaqet e dysHEMEVE, mureve dhe tavaneve të vendeve të punës ndërtohen në mënyrë të përshtatshme që të mos vështirësojnë pastrimin apo riparimin e tyre, sipas kërkesave të prodhimit dhe të higjienës.

9.3 Muret e ndërtuara nga materiale të tejdukshme, e posaçrisht atyre prej qelqit në mjedise apo pranë vendeve të punës dhe rrugët lëvizëse, duhet të jenë të pastërta dhe qartësisht të shënuara, dhe të përbëra nga materiale të sigurta, thyerja apo dëmtimi i të cilave nuk do shkaktojë lëndime të punësuarëve apo personave të tjerë.

9.4 Aksesi në çati dhe sipërfaqe të tjera që përbëhen nga materiale me fortësi të pamjaftueshme lejohet vetëm kur përdoren pajisje që garantojnë një punë të sigurt, duke marrë masa për parandalimin e shkeljes së paqëllimtë në këto sipërfaqe apo rënies bashkë me to.

10. Zonat e rrezikut

10.1. Nëse mjediset e punës, për shkak të natyrës së punës, përmbajnë zona të rrezikshme që paraqesin rrezik të rënies së të punësuarit dhe objekteve nga lartësia, ato duhet të jenë të pajisura, me shenja dalluese dhe mjete që parandalojnë hyrjen e paautorizuar të punësuarit.

10.2. Të punësuarit të cilët janë të autorizuar për të hyrë në zonat e rrezikut, punëdhënsi duhet të ndërmerr, masa të përshtatshme për mbrojtjen dhe sigurinë e të e tyre.

10.3. Zonat e rrezikut duhet të shënohen në mënyrë të qartë.

11. Mjediset e çlodhjes (pushimit)

11.1. Mjediset e çlodhjes (pushimit) u sigurohen të punësuarve kur procesi teknologjik ose prania e një numri të caktuar të punësuarish kërkon ndërprerje të shpeshtë ose të gjatë të punës, për të garantuar regjime pune të sigurta dhe të shëndetshme. Kjo dispozitë nuk zbatohet për të punësuarit që punojnë në zyrë apo mjedise të ngjashme, që krijojnë të njëjtën mundësi çlodhjeje (pushimi) gjatë pushimit.

11.2. Mjediset e çlodhjes (pushimit) duhet të jenë të pajisura me mjete në përputhje me natyrën e çlodhjes së nevojshme dhe me tavolina dhe karrige me mbështetëse.

11.3. Ndalohet pirja e duhanit në mjediset e çlodhjes.

11.4. Nëse oraret e punës ndërpriten rregullisht dhe shpesh dhe nuk ka mjedise çlodhjeje (pushimi), duhet të ofrohen dhoma apo hapësira të tjera në të cilat të punësuarit mund të qëndrojnë gjatë këtyre ndërprerjeve, kurdo që kjo nevojitet për sigurinë apo shëndetin e tyre.

12. Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji

Për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji, duhet të krijohen kushte të përshtatshme për të qëndruar dhe për t'u çlodhur.

13. Pajisjet higjieno-sanitare

13.1. Dhomat e zhveshjes dhe dollapët personalë

13.1.1. Të punësuarve iu sigurohen dhoma të përshtatshme për t'u ndërruar në qoftë se ata duhet të veshin rroba të veçanta pune dhe kur, për arsye të shëndetit ose të etikës, atyre nuk mund t'u kërkohet të ndërrohen në një dhomë tjetër. Dhomat e ndërrimit duhet të jenë lehtësisht të arritshme, të kenë kapacitete të mjaftueshme dhe të jenë pajisur me ndenjëse.

13.1.2. Dhomat e ndërrimit duhet të jenë mjaftueshëm të mëdha dhe të kenë ambiente për t'i krijuar mundësi çdo të punësuarit për të kyçur veshjet e tij gjatë orarit të punës. Nëse rrethanat e kërkojnë (p.sh. substancat e rrezikshme, lagështia, papastërtia), dollapët me kyç (dryn) për veshjet e punës duhet të jenë të ndarë nga ato për veshjet e zakonshme.

13.1.3. Duhet parashikuar dhoma të ndara të ndërrimit apo përdorime të ndara të dhomave të ndërrimit për burrat dhe gratë.

13.1.4 Nëse për dhomat e ndërrimit nuk kërkohen kushtet sipas pikes

18.1.1, secilit të punësuar u sigurohet një vend për të vendosur veshjet e tij.

13.2 Dushet, lavamanët dhe WC-të

13.2.1. Vendet e punës të cilat kërkohet nga natyra e punës së tyre duhet të jenë të pajisura në mënyrë të tillë që punëtorët kanë në afërsi dushë, objekte të veçanta të pajisura me një numri adekuat të lavamanëve dhe WC-ve.

13.2.3. Dushet duhet të pajisen me ujë të rrjedhshëm, dhe nëse është e nevojshme edhe me ujë të ngrohtë.

13.2.4. Dushet duhet të jenë të ndarë apo të përdoren veçmas për burrat dhe gratë.

13.2.5. Lavamanët janë të ndara nga dhomat e veshjes, duhet të ketë komunikim të lehtë ndërmjet tyre.

14. Dhomat e ndihmës së parë

14.1. Vendet e punës duhet të jenë të pajisura me pajisje të ndihmës së parë.

14.2. Pajisjet duhet të shënohet në mënyrë të përshtatshme dhe lehtësisht të arritshme

15. Të Punësuarit me aftësi të kufizuara

15.1. Mjediset e punës, nëse është e nevojshme, përshtaten në mënyrë të tillë që të marrin parasysh nevojat e të punësuarve me aftësi të kufizuara.

15.2. Kjo dispozitë vlen në veçanti sa u përket dyerve, rrugëkalimeve, shkallëve, dusheve, lavamanëve, WC-ve dhe vendeve individuale të punës të përdorura apo të zëna direkt nga personat me aftësi të kufizuara.

16. Lëvizja e këmbësorëve dhe automjeteve

Vendet e punës të hapura dhe të mbyllura duhet të organizohet në mënyrë të tillë që këmbësorët dhe automjetet mund të qarkullojnë në mënyrë të sigurt dhe të lirshëm.

17. Vendet e punës në mjedis të hapur (dispozita të veçanta)

17.1. Nëse të punësuarit punojnë në mjedise të hapura, vendet individuale të punës organizohen, për sa është e mundur, në mënyrë të tillë që të punësuarit:

17.1.1. të jenë të mbrojtur ndaj kushteve të motit me shi dhe nëse është e nevojshme ndaj objekteve që bien;

17.1.2. të mos jenë të ekspozuar ndaj niveleve të dëmshme të zhurmës dhe as ndaj ndikimeve të dëmshme të lëndëve që çlirohen në mjediset e hapura, të tilla si: gazra, avuj ose pluhura;

17.1.3. të jenë në gjendje të largohen nga vendi i tyre individual i punës me shpejtësi në rast të një rreziku apo të mund të ndihmohen me shpejtësi;

17.1.4. të shmangin mundësin e rrëshqitjes apo rënies.

DRAFT- RREGULLORE (MPMS) NR.05 /2014 - PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PËRDORIMIN E PAJISJEVE TË PUNËS NË VENDIN E PUNËS

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktoj kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit të të punësuarëve gjatë përdorimit të pajisjeve të punës në vendin e punës. Kjo rregullore është në përputhshmëri me Direktivën 2009/104/EC E Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dt.16 shtator 2009 në lidhje me kërkesat e sigurisë minimale dhe të shëndetit për përdorimin e pajisjeve të punës nga ana e punëtorëve në punë (Direktiva e dytë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE)

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë punëdhënësit, që janë të përcaktuarë me legjislacionin nga fusha e sigurisë dhe shëndetin në punë ku zhvillohet veprimtari pune apo trajnimi lidhur me punën, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojit të subjektit juridik dhe shkaqeve për të cilat zhvillohet puna apo trajnimi.

Neni 3

Përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1.1.“përdorim i pajisjeve të punës” është çdo veprimtari që ka lidhje me pajisjen e punës, të tilla si: vënia në punë, ndalimi, përdorimi, transporti, riparimi, modifikimi, kryerja e shërbimeve, mirëmbajtja, përfshirë pastrimin e tyre;

1.2.“zonë rreziku” është çdo zonë brenda dhe/ose përfaqë pajisjes së punës, në të cilën punëmarrësi, apo persona të tjerë të pranishëm në vendin e punës, janë të ekspozuar ndaj një risku për sigurinë dhe shëndetin e tyre;

1.3.“person i rrezikuar” është çdopunëmarrës, apo person tjetër, që është tërësisht apo pjesërisht në një zonë rreziku;

1.4.“operator” është çdo i punësuar, apo person tjetër që i kërkohet të përdorë pajisjet e punës;

1.5. “ergonomia e pajisjeve të punës” është disiplina e përqendruar tek prodhimi i pajisjeve të punës që i përshtaten trupit të njeriut, me qëllim zvogëlimin e sforcimit fizik, parahatisë dhe rreziqeve;

1.6. ergonomike konsiderohet pajisja e punës që i përshtatet trupit të njeriut

1.7. të gjitha shprehjet tjera të përdorura në këtë rregullore, kanë kuptimin e njëjtë sikurse shprehjet që janë përcaktuar përcaktuarë me legjislacionin nga fusha e sigurisë dhe shëndetin në punë.

Neni 4

Detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit

1. Punëdhënësi merr masat e nevojshme për të siguruar që pajisjet e punës, të vëna në dispozicion të punësuarëve në vendin e punës, të jenë të përshtatshme për punën, me qëllim të punësuarëve mos i rezikohet siguria dhe shëndeti i tyre në punë.
2. Në përzgjedhjen e pajisjeve të punës që ai parashikon për t'u përdorur, punëdhënësi duhet të ketë kujdes dhe vëmendje kushteve dhe karakteristikave specifike të punës dhe rreziqeve që ekzistojnë në vendin e punës, për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarëve dhe çdo rreziku shtesë që vjen nga përdorimi i pajisjeve të punës në fjalë.
3. Kur nuk është e mundur të sigurohet plotësisht që pajisjet e punës të mund të përdoren pa rreziqe për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve, punëdhënësi merr masa të përshtatshme për minimizimin e këtyre rreziqeve.

Neni 5

Rregullat lidhur me pajisjet e punës

1. Të gjitha pajisjet e punës të siguruara nga punëdhënësi për të punësuarin në vendin e punës, janë në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në Shtojcën I të kësaj rregulloreje, si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi mbi konformitetin e makinerive dhe pajisjeve të tjera teknike, rregullat teknike përkatëse, si dhe standardet ndërkombëtare të lidhura me to.
2. Punëdhënësi siguron pajisjet e punës së bashku me dokumentacionin përcjellës, në gjuhën shqipe, si dhe në gjuhë të tjera të kuptueshme për të punësuarin, me të gjitha të dhënat e nevojshme dhe kërkesat lidhur me përdorimin, funksionimin, mirëmbajtjen dhe riparimin e tyre të sigurt.
3. Pajisjet e siguruara nga punëdhënësi, përfshirë instrumentet manuale, me apo pa motor:
 - 3.1. instalohen dhe përdoren në mënyrë korrekte;
 - 3.2. mirëmbahen në kushte të mira funksionale;

3.3 shërbimet kryhen nga të punësuarit apo persona të trajnuar në mënyrë të përcaktuar;

3.4. përdoren vetëm në përputhje me qëllimin e tyre; dhe

3.5. përdoren në përputhje me dispozitat e Shtojcës II që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje.

Neni 6

Kontrolli i pajisjeve të punës

1. Kur siguria e pajisjeve të punës varet nga kushtet e instalimit, punëdhënësi garanton me anë të personave kompetentë:

1.1.kontrollin fillestar pas instalimit dhe përpara vënies në punë për herë të parë;

1.2.kontrollin pas instalimit të pajisjes së punës, në një vend tjetër pune apo për ndryshimin e vendndodhjes së saj.

2. Nëse pajisja e punës i ekspozohet kushteve, që mund të shkaktojnë përkeqësimin e gjendjes së saj dhe mund të sjellë situata të rrezikshme, punëdhënësi garanton:

2.1. kontrole periodike, dhe kur është e përshtatshme, testime periodike nga persona kompetentë, për të garantuar funksionimin e sigurt të saj;

2.2. kontrole speciale, të kryera nga persona kompetentë, sa herë që paraqiten rrethana të jashtëzakonshme, shkaktojnë për rrezikimin e sigurisë së pajisjeve të punës, të tilla si: rikonstruksionet apo ndryshime të tjera në procesin e prodhimit, modifikimet, aksidentet, dukuritë natyrore apo periudha të zgjatura të mospërdorimit.

3. Kur legjislacioni përkatës në fuqi nuk parashikon ndryshe, kontrolli sipas pikës 1 dhe 2 kryhet nga persona të pajtuar nga punëdhënësi, që kanë kualifikimet e nevojshme dhe që mund t'i përkasin një organizate të jashtme përkatëse.

4.Rezultatet e kontroleve duhet të regjistrohen dhe mbahen, në mënyrë që të vihen në dispozicion të autoriteteve kompetente. Nëse dispozitat e legjislacionit në fuqi nuk parashikojnë ndryshe, rezultatet e kontrollit duhet të mbahen për:

4.1. kontrollet e kryera në përputhje me paragrafin 1, gjatë gjithë periudhës së funksionimit të pajisjes;

4.2. kontrollet e kryera sipas paragrafit 2, të paktën për 5 vjet.

5. Kur pajisja e punës përdoret jashtë ndërmarrjes, ajo duhet të shoqërohet me një kopje me shkrim të rezultateve apo me dokumente të tjera që kanë lidhje me kontrollin e fundit.

Neni 7

Pajisjet e punës që përfshijnë rreziqe të veçanta

1. Kur pajisja e punës krijon risqe të veçanta për sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve, punëdhënësi merr masat e nevojshme për të siguruar që:

1.1. përdorimi i pajisjes së punës të lejohet vetëm për ata persona, që u është dhënë detyra për t'i përdorur ato;

1.2. në rastin e instalimeve, ç'instalimeve, ndryshimeve, përshtatjeve, mirëmbajtjes, shërbimeve dhe riparimeve të pajisjes së përdorur, të punësuarit që i kryejnë ato, janë ata që janë të kualifikuar dhe janë ngarkuar veçanërisht për këtë punë.

Neni 8

Ergonomia dhe shëndeti në punë

Punëdhënësi, për zbatimin e kërkesave minimale të sigurisë dhe shëndetit në punë, merr tërësisht në konsideratë organizimin e vendit të punës dhe pozicionin e të punësuarve gjatë përdorimit të pajisjeve të punës, si dhe parimet ergonomike.

Neni 9

Informimi i punësuarve dhe të vetëpunësuarve

1. Punëdhënësi informon punëmarrësit lidhur me përdorimin e pajisjeve të punës, dhe kur është e nevojshme nëpërmjet udhëzimeve të duhura me shkrim.

2. Informacioni dhe udhëzimet me shkrim, sipas paragrafit 1, përmbajnë të paktën informacione lidhur me:

2.1. kushtet për përdorimin e sigurtë të e pajisjeve të punës;

2.2. situatat jonormale të parashikueshme;

2.3. kërkesat e sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjes së punës;

2.4. konkluzionet që rrjedhin nga përvoja e përfituar gjatë shfrytëzimit të pajisjeve të punës ;

3. Informacioni dhe udhëzimet me shkrim duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme për të punësuarit e interesuar.

4. Të punësuarit informohen mbi risqet e rëndësishme për ta, pajisjet e punës që ndodhen në zonën e punës apo në vendin e punës, si dhe për çdo ndryshim, që sjell ndikim tek ata, për aq sa ky ndryshim ndikon në pajisjen e punës, që ndodhet në afërsi të tyre, edhe nëse ata nuk i përdorin këto pajisje në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Neni 10

Trajnimi i të punësuarëve

1. Punëdhënësi ofron trajnime të përshtatshme për të punësuarit, përfshirë trajnime për çdo risk të mundshëm, nëpërmjet demonstrimeve lidhur me paisjet e përdorura të punës.
2. Trajnime të veçanta ju ofrohen të punësuarëve nga neni 6 parag. 1. pika 1.2, të kësaj rregulloreje.

Neni 11

Konsultimi dhe pjesëmarrja e të punësuarve

Konsultimi dhe pjesëmarrja e të punësuarve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre lidhur me përzgjedhjen dhe përdorimin e pajisjes së punës, informimi dhe trajnimi, si dhe aspekte të tjera të mbuluara nga kjo rregullore, kryhen në përputhje me nenin 19 të Ligjit përkatës për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Neni 12

Shtojca

Shtojca 1 për kërkesat minimale dhe Shtojca 2 lidhur me përdorimin e paisjeve të punës, janë pjesë përbërse të kësaj rregulloreje .

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi, shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

SHTOJCA I: KËRKESAT MINIMALE

1. Përcaktime të përgjithshme

1.1. Detyrimet e përcaktuara në këtë shtojcë, zbatohen duke pasur parasysh këtë rregullore dhe kur ekzistojnë risqet përkatëse për pajisjet e punës në fjalë.

1.2. Kërkesat minimale, për aq sa ato zbatohen për pajisjet e punës në përdorim, nuk shprehin domosdoshmërisht nevojën për të marrë masa të njëjta me kërkesat thelbësore për pajisjet e reja të punës.

2. Kërkesa minimale të përgjithshme, të zbatueshme për pajisjet e punës

2.1. Mjetet e komandimit të pajisjeve të punës, të cilat ndikojnë mbi sigurinë, duhet të jenë qartazi të dukshme dhe të identifikueshme, dhe nëse është e nevojshme, të shënuara në mënyrë të përshtatshme në përputhje me legjislacionin në fuqi për sinjalistikën. Me përjashtim të rasteve kur kjo është e domosdoshme, mjetet e veçanta dhe të përgjithshme të komandimit duhet të vendosen jashtë zonave të rrezikut dhe në mënyrë të tillë që funksionimi i tyre të mos përbëjë risk shtesë. Këto nuk duhet të sjellin risqe nga ndonjë veprim i paqëllimshëm.

2.1.1. Kur është e nevojshme, nga pozicioni kryesor i komandimit, operatori duhet të jetë në gjendje të sigurojë që askush të mos jetë i pranishëm në zonat e rrezikut. Nëse kjo është e pamundur, lëshohet automatikisht një sinjal paralajmërues i dëgjueshëm dhe/ose i dukshëm, sa herë që një makineri është gati për të filluar.

2.1.2. Një punëmarrës apo person tjetër i pranishëm në vendin e punës i ekspozuar duhet të ketë kohën dhe mjetet që me shpejtësi të shmangë rreziqet e shkaktuara nga fillimi ose ndalimi i pajisjeve të punës.

2.1.3. Sistemet e komandimit duhet të jenë të sigurta dhe të përzgjidhen duke llogaritur edhe avaritë, defektet dhe kufizimet e pritshme nga një përdorim normal i pajisjes së punës.

2.2. Vënia në punë e pajisjeve të punës kryhet vetëm nëpërmjet veprimeve të qëllimshme me një sistem komande të sigurt.

2.2.1. Të njëjtat kërkesa vlejné:

2.2.1.1. për ta rivënë atë në punë, pas ndalimit për çfarëdo arsye;

2.2.1.2 për kontrollin e një ndryshimi thelbësor të kushteve funksionale, si shpejtësia, trysnia, etj., me përjashtim të rastit kur kjo rivënie në punë apo ndryshim nuk sjell ndonjë rrezik për punëmarrësit apo personat e ekspozuar.

2.2.2. Kjo kërkesë nuk zbatohet për rivënien në punë apo ndryshimin në kushtet e funksionimit, si rezultat i ciklit normal të funksionimit të një pajisjeje automatike.

2.3. Të gjitha pajisjet e punës duhet të kenë një sistem komandimi për ndalimin e tyre plotësisht dhe në mënyrë të sigurt. Çdo vend individual i punës duhet të jetë i pajisur me një sistem komandimi për ndalimin e disa ose të gjitha pajisjeve të punës, në varësi të llojit të rrezikut, në mënyrë që pajisja të jetë në gjendje të sigurt. Komanda e ndalimit të pajisjeve duhet të ketë prioritet mbi komandat e lëshimit. Kur pajisja e punës ose pjesët e rrezikshme të saj kanë ndalur, furnizimi me energji i mekanizmave në fjalë duhet të ndërpritet.

2.4. Kur është e përshtatshme, dhe në varësi të rreziqeve që paraqet pajisja dhe koha normale për ndalimin e saj, pajisjet e punës duhet të kenë një mekanizëm për ndalimin urgjent të tyre.

2.5. Pajisjet e punës që përbëjnë rrezik për shkak të objekteve që bien apo shkëputen, duhet të jenë të pajisura me mjetet e duhura të sigurisë që i korrespondojnë riskut. Pajisjet e punës që paraqesin rreziqe për shkak të emetimeve të gazit, avullit, lëngjeve apo pluhurave, duhet të pajisen me mjetet e duhura të mbledhjes dhe/ose të thithjes, të vendosura pranë burimeve të riskut.

2.6. Pajisjet e punës dhe pjesë të tyre, kur është e nevojshme për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve duhet të fiksohen duke u mbërthyer apo nëpërmjet mjeteve të tjera.

2.7. Aty ku ekziston risku i shpërthimit ose shpërbërjes së pjesëve të pajisjes së punës, që mund të paraqesë një rrezik të madh për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve dhe të personave të tjerë, duhet të merren masat e duhura mbrojtëse.

2.8. Aty ku ekziston risku i kontaktit mekanik me pjesët lëvizëse të pajisjeve të punës që mund shkaktojë aksidente, këto pjesë duhet të pajisen me barriera dhe pajisje mbrojtëse që parandalojnë hyrjen në zonat e rrezikut ose ndalojnë lëvizjen e pjesëve të rrezikshme përpara hyrjes në to.

2.8.1. Barrierat dhe pajisjet e mbrojtjes duhet:

2.8.1.1. të kenë një konstruksion të fortë;

2.8.1.2. të mos shkaktojnë risk shtesë;

2.8.1.3. të mos hiqen apo të bëhen jofunksionale me lehtësi;

2.8.1.4. të jenë vendosur në largësi të mjaftueshme nga zona e rrezikut;

- 2.8.1.5. të mos e kufizojnë më shumë seç duhet shikueshmërinë e ciklit të punës së pajisjeve;
- 2.8.1.6. të lejojnë operacionet e nevojshme për vendosjen apo zëvendësimin e pjesëve dhe për mirëmbajtjen, duke lejuar hyrjen vetëm në zonën ku do të kryhet puna dhe, nëse është e mundur, pa hequr barrierat apo pajisjet mbrojtëse.
- 2.9. Zonat dhe vendet e punës, ose mirëmbajtjes së pajisjeve të punës, duhet të ndriçohen në mënyrë të përshtatshme në përputhje me veprimtarinë e kryer.
- 2.10. Pjesët e pajisjes së punës me temperaturë të lartë ose shumë të ulët, kur është e përshtatshme, duhet të mbrohen për të shmangur riskun që personat të afrohen shumë afër apo të vijnë në kontakt me to.
- 2.11. Mjetet paralajmëruese që përdoren në pajisjet e punës, duhet të jenë të qarta, lehtësisht të perceptueshme dhe të kuptueshme.
- 2.12. Pajisjet e punës mund të përdoren vetëm për proceset operacionale dhe në kushte për të cilat janë parashikuar.
- 2.13. Operacionet e mirëmbajtjes kryhen vetëm atëherë kur pajisja është e fikur. Në rast të kundërt, merren masat e duhura për kryerjen e këtyre operacioneve jashtë zonave të rrezikut. Në rastet kur makineria ka libër mirëmbajtjeje, ky i fundit përditësohet rregullisht.
- 2.14. Të gjitha pajisjet e punës pajisen me mjete për ndërprerjen e furnizimit të tyre me energji elektrike, të cilat janë qartësisht të dallueshme. Lidhja sërish me burimin e energjisë elektrike nuk sjell vënie në punë të pajisjes apo ndonjë risk për të punësuarit në fjalë.
- 2.15. Pajisjet e punës kanë shenja paralajmëruese, të dallueshme për të garantuar sigurinë e të punësuarëve.
- 2.16. Punëmarrësit dhe persona të tjerë pranë pajisjeve të punës duhet të kenë akses të sigurt dhe mundësi qëndrimi të sigurt në të gjitha zonat e nevojshme gjatë proceseve të prodhimit, riparimit dhe të mirëmbajtjes.
- 2.17. Të gjitha pajisjet e punës janë të përshtatshme për mbrojtjen e të punësuarëve nga risku i marrjes flakë apo mbinxehjes së pajisjeve të punës, apo shkarkimit të gazrave, pluhurit, lëngut, avullit ose substancave të tjera të prodhuara, të përdorura ose të depozituara në pajisjet e punës.
- 2.18. Të gjitha pajisjet e punës duhet të jenë të përshtatshme për parandalimin e riskut të shpërthimit të pajisjeve të punës apo të substancave të prodhuara, të përdorura apo të depozituara në pajisjet e punës.

2.19. Të gjitha pajisjet e punës duhet të jenë të përshtatshme për mbrojtjen e të punësuarëve apo personave të tjerë, që janë të ekspozuar ndaj riskut të kontaktit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me energjinë elektrike.

3. Kërkesa minimale shtesë, të zbatueshme për lloje të veçanta të pajisjeve të punës

3.1. Kërkesa minimale për pajisjet e lëvizshme të punës, qofshin ato vetëlëvizëse ose jo;

3.1.1. Mjetet e lëvizshme të punës me persona në bord, pajisen në mënyrë të tillë që zvogëlon risqet për personat gjatë udhëtimit. Këto risqe përfshijnë kontaktin e këtyre personave, apo shtypjen e tyre nga rrotat apo vetë mjete.

3.1.2. Kur një bllokim i pavullnetshëm i njësisë lëvizëse të makinerisë, me çdo objekt të lëvizshëm të punës, apo çdo gjëje të rimorkiuar, mund të krijojë një risk të veçantë, këto pajisje duhet të shoqërohen me mjete të tjera, apo të përshtaten për parandalimin e bllokimit të tyre. Kur ky bllokim nuk mund të shmanget, atëherë duhet marrë çdo masë e mundshme për të evituar ndikimet negative mbi personat.

3.1.3. Kur boshtet e transmetimit të lëvizjes ndërmjet objekteve të lëvizshme të pajisjeve të punës mund të ndoten apo të dëmtohen nga fërkimi me tokën, duhet të vihen në dispozicion pajisje për rregullimin e tyre.

3.1.4. Pajisjet e lëvizshme të punës me persona në bord duhet të jenë të projektuara për të kufizuar, në kushtet reale të përdorimit, risqet që lindin nga batimi i pajisjes së punës:

3.1.4.1. nëpërmjet një strukture mbrojtëse të projektuar për të siguruar që pajisja të mos anohet me më shumë se 22 gradë ose

3.1.4.2. nëpërmjet një strukture që lejon hapësirë të mjaftueshme rreth personave në bord, nëse lëvizja tejkalon 22 gradë ose

3.1.4.3. nëpërmjet disa pajisjeve të tjera me efekt të njëjtë. Këto struktura mbrojtjeje mund të jenë pjesë përbërëse e pajisjeve të punës. Këto struktura mbrojtjeje nuk janë të nevojshme, kur pajisja e punës është e qëndrueshme gjatë operacionit dhe/ose kur struktura e saj e bën të pamundur batimin. Aty ku ekziston risku që një person në bord të shtypet ndërmjet pjesëve të pajisjes së punës dhe tokës, nëse pajisja batohet, duhet të instalohet një sistem mbrojtës për këta persona.

3.1.5. Automjetet me pirun që transportojnë një ose më shumë të punësuar duhet të përshtaten apo pajisen në mënyrë të tillë që të kufizohet risku i përmbysjes së tyre, p.sh.:

- 3.1.5.1. nëpërmjet instalimit të një strukture rrethuese për drejtuesin e mjetit;
- 3.1.5.2. nëpërmjet një strukture që nuk e lejon automjetin me pirun që të përmbysset;
- 3.1.5.3. nëpërmjet një strukture e cila siguron që, nëse automjeti me pirun përmbysset, mbetet hapësirë e mjaftueshme ndërmjet tokës dhe të pjesëve të caktuara të tij për personat në bord; ose
- 3.1.5.4. nëpërmjet një strukture që i kufizon të punësuarit në vendin e drejtimit në mënyrë të tillë, që parandalon shtypjen e tyre nga pjesët e automjetit pirun kur ai përmbysset.
- 3.1.6. Pajisjet vetëlëvizëse të punës, të cilat kur janë në lëvizje mund të sjellin risqe për personat, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
- 3.1.6.1. të kenë mekanizma për parandalimin e nisjes së paautorizuar të tyre;
- 3.1.6.2. të kenë mekanizma të përshtatshme për amortizimin e pasojave të përplasjeve, kur pajisja e punës që lëviz mbi shina, ka më shumë se një njësi, të cilat lëvizin në të njëjtën kohë;
- 3.1.6.3. duhet të ketë mjete për frenimin dhe ndalimin e tyre. Kur e kërkojnë kufizimet e sigurisë, vihen në dispozicion mekanizma të emergjencave, të cilët komandohen me mjete lehtësisht të arritshme apo sisteme automatike, për frenimin dhe ndalimin e menjëhershëm të pajisjeve, kur ka një avari të pajisjes kryesore;
- 3.1.6.4. kur fushëpanja e drejtuesit të mjetit është e pamjaftueshme për të garantuar siguri, në këtë rast duhen instaluar pajisje ndihmëse të përshtatshme për të përmirësuar shikueshmërinë;
- 3.1.6.5. pajisjet e punës të projektuara për përdorim gjatë natës ose në vende të errëta, duhet të pajisen me ndriçim të përshtatshëm për punën që do të kryhet dhe të garantojnë siguri të mjaftueshme për punëmarrësit dhe personat e tjerë;
- 3.1.6.6. pajisja e punës që përbën rrezik zjarri, qoftë vetë ose për shkak të çfarëdo mjeti të rimorkiuar me të apo mbahet nga ai dhe, që mund të rrezikojë punëmarrësit apo personat e tjerë, duhet të pajiset me mjete zjarrfikëse të përshtatshme, në rastet kur nuk ka të tilla në vendin e përdorimit;
- 3.1.6.7. pajisjet e punës që komandohen me telekomandë, duhet të ndalojnë automatikisht, kur ato ndodhen jashtë fushës së kontrollit;
- 3.1.6.8. pajisjet e punës që komandohen me telekomandë, të cilat në kushte normale mund të sjellin një rrezik shtypje apo përplasje, pajisen me

mekanizma për ruajtjen e tyre kundër këtij risku, përveç rasteve kur pajisja ka mjete të tjera të përshtatshme për parandalimin e këtij risku.

3.2. Kërkesa minimale për pajisjet e punës për ngritjen e ngarkesave .

3.2.1. Kur pajisja e punës për ngritjen e ngarkesave është instaluar në mënyrë të përhershme, duhet siguar qëndrueshmëria e saj gjatë përdorimit, duke pasur parasysh, në veçanti, ngarkesat që do të ngrihet dhe tensionin e ushtruar në pikën e montimit apo fiksimit të strukturave.

3.2.2. Makineritë për ngritjen e ngarkesave duhet të shënjoen për të treguar dukshëm ngarkesën e tyre nominale dhe, kur është e përshtatshme, duhet të pajisen me tabelë të ngarkesës nominale, për çdo konfigurim të makinerisë. Pjesët shtesë për ngritjen e ngarkesave shënjoen për të treguar në mënyrë të identifikueshme karakteristikat thelbësore për përdorim të sigurt. Pajisjet e punës që nuk janë projektuar për ngritjen e personave, por që mund të përdoren për këtë qëllim gabimisht, duhet të shënjoen për të treguar në mënyrë të qartë këtë qëllim.

3.2.3. Pajisjet e instaluar në mënyrë përhershme duhet të montohen në mënyrë të tillë që të zvogëlohet risku që ngarkesa:

3.2.3.1. të godasë punëmarrësit apo persona të tjerë;

3.2.3.2. të rrëshqasë në mënyrë të pavullnetshme me rrezik apo të bjerë lirisht;

3.2.3.3. të lëshohet në mënyrë të pavullnetshme.

3.2.4. Pajisjet e punës për ngritjen lart apo zhvendosjen e të punësuarve apo personave të tjerë duhet të jenë të tilla që:

3.2.4.1 të parandalojnë riskun e rënies së makinerisë, kur ekziston ky risk, me anë të mjeteve të përshtatshme;

3.2.4.2. të parandalojnë riskun e rënies së vetë përdoruesit nga makineria kur ky risk ekziston;

3.2.4.3. të parandalojnë riskun e shtypjes, zënies apo bllokimit të përdoruesit veçanërisht nëpërmjet kontaktit të paqëllimshëm me objekte;

3.2.4.4. të sigurojnë që personat e bllokuar në makineri në rast të një incidenti të mos ekspozohen ndaj rreziqeve dhe të mund të nxirren.

Nëse, për arsye që i atribuohen vendit dhe dallimeve të lartësisë, risqet e përmendura në pikën “3.2.4.1” nuk mund të shmangen me ndonjë masë sigurie, duhet të instalohet një litar pezullimi me litar sigurie me koeficient të përforcuar, i cili kontrollohet çdo ditë pune.

SHTOJCA II

DISPOZITA LIDHUR ME PËRDORIMIN E PAJISJEVE TË PUNËS

1. Përcaktime të përgjithshme

Kjo shtojcë zbatohet duke pasur parasysh këtë rregullore dhe kur ekziston risku përkatës për pajisjet e punës në fjalë.

2. Dispozita të përgjithshme për të gjitha pajisjet e punës

2.1. Pajisjet e punës duhen instaluar, vendosur dhe përdorur në një mënyrë të tillë që të zvogëlohet risku për përdoruesit e tyre apo personat e tjerë, për shembull duke siguruar hapësirë të mjaftueshme ndërmjet pjesëve të lëvizshme të pajisjes së punës dhe pjesëve fikse apo të lëvizshme në mjedisin e saj dhe, që të gjitha format e energjisë dhe substancave të përdorura ose prodhuara të mund të furnizohen apo hiqen në mënyrë të sigurt.

2.2. Pajisjet e punës duhet të ngrihen lart apo çmontohen në kushte të sigurta, në mënyrë të veçantë, duke respektuar çdo udhëzim që mund të jetë dhënë nga prodhuesi.

2.3. Pajisjet e punës që mund të goditen nga rrufeja gjatë përdorimit, mbrohen me pajisje apo mjete të përshtatshme për t'iu kundërvënë efekteve të rrufesë.

3. Dispozitat në lidhje me përdorimin e pajisjeve të lëvizshme, vetëlëvizëse ose jo

3.1. Pajisjet vetëlëvizëse të punës drejtohen vetëm nga punëmarrësit apo personat e trajnuar siç duhet për të drejtuar këto pajisje në mënyrë të sigurt.

3.2. Nëse pajisja e punës lëviz rreth një zone të punës, duhen përcaktuar dhe respektuar rregulla të përshtatshme të trafikut.

3.3. Duhet të merren masa organizative për të parandaluar hyrjen e të punësuarëve këmbësorë brenda fushës së operimit të pajisjeve vetëlëvizëse të punës. Nëse puna mund të kryhet siç duhet, vetëm nëse janë të pranishëm punëmarrës apo persona të tjerë në këmbë, atëherë duhen marrë masat e duhura për të parandaluar lëndimin e tyre nga ana e pajisjeve.

3.4. Transporti i të punësuarëve me pajisje pune të lëvizshme të drejtuara mekanikisht është i autorizuar vetëm kur për këtë qëllim janë vënë në dispozicion facilitete të sigurta. Nëse puna duhet të kryhet gjatë udhëtimit, shpejtësitë duhen përshtatur sipas nevojës.

3.5. Pajisjet e lëvizshme të punës me një motor me djegie të brendshme nuk mund të përdoren në zonat e punës, me përjashtim të rasteve kur garantohen sasi të mjaftueshme të ajrit, që nuk paraqesin risqe për shëndetin apo sigurinë e të punësuarëve.

4. Dispozita lidhur me përdorimin e pajisjeve të punës për ngritjen e ngarkesave

4.1. Përcaktime të përgjithshme .

4.1.1. Pajisja e punës e lëvizshme apo e çmontueshme që shërben për ngritjen e ngarkesave, duhet të përdoret në mënyrë të tillë që të sigurojë qëndrueshmërinë e pajisjes së punës gjatë përdorimit të saj në të gjitha kushtet e parashikueshme, përfshirë natyrën e tokës.

4.1.2. Personat mund të ngrihen vetëm me anë të pajisjeve të punës dhe pjesëve shtesë të parashikuara për këtë qëllim. Pa cenuar dispozitat e Ligjit nr.04/L-161, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, në mënyrë përjashtimore, pajisjet e punës që nuk janë projektuar posaçërisht për ngritjen e personave, mund të përdoren për këtë qëllim, me kusht që të kryen veprime të përshtatshme për garantimin e sigurisë në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare që parashikojnë mbikëqyrje të duhur.

.Kur në pajisjen e punës të projektuar për ngritjen e ngarkesave ndodhen punëmarrës apo persona të tjerë, vendi i pozicionit të kontrollit duhet të ketë drejtues në çdo kohë. Personat që ngrihen duhet të kenë mjete të sigurta të komunikimit. Në rast rreziku, duhet të ketë mjete të sigurta për evakuimin e tyre.

4.1.3.Duhet marrë masa për të siguruar që punëmarrësit apo persona të tjerë të mos jenë të pranishëm poshtë ngarkesave të varura, përveç rasteve kur prezenca e tyre është e nevojshme për funksionimin e mirë të punës.

Nuk lejohet lëvizja në lartësi e ngarkesave, mbi vendet e punës, ku qëndrojnë zakonisht të punësuarit Kur kjo ndodh, nëse puna nuk mund të kryhet siç duhet në mënyrë tjetër, atëherë duhet përcaktuar dhe zbatuar procedura të përshtatshme.

4.1.4.Pjesët shtesë duhet të përzgjidhen në bazë të ngarkesave që do të ngrihen, pikave të kapjes, pajisjes bashkëlidhëse dhe kushteve atmosferike, duke marrë në konsideratë mënyrën dhe konfigurimin e varjes në litar. Pjesa shtesë për ngritjen, duhet të shënjohen për të treguar qartë në mënyrë që përdoruesit të njihen me karakteristikat saj, kur ky mjet nuk çmontohet pas përdorimit.

4.15. Pjesët shtesë për ngritjen duhet të ruhen në një mënyrë që garanton mosdëmtimin dhe mosdegradimin e tyre.

4.2. Pajisjet e punës për ngritjen e ngarkesave të padrejtuara .

4.2.1.Kur dy ose më shumë njësi të pajisjeve të punës, që përdoren për ngritjen e ngarkesave të padrejtuara, instalohen ose montohen në mënyrë të

tillë që sjell mbivendosjen e rrezes të punës së tyre, duhen marrë masa për shmangien e përplasjeve midis ngarkesave apo vetë pjesëve të pajisjeve të punës.

4.2.2. Kur për ngritjen e ngarkesave të padrejtuara përdoren pajisje të lëvizshme të punës, duhet të merren masa për parandalimin e pjerrësimit apo përmbysjes së pajisjeve dhe, sipas rastit, lëvizjes apo rrëshqitjes së tyre. Duhet kryer kontrolle për të siguruar që këto masa janë zbatuar siç duhet.

4.2.3. Nëse operatori i pajisjeve të punës, të projektuara për ngritjen e ngarkesave të padrejtuara, nuk mund të vëzhgojë të gjithë rrugën as drejtpërdrejt dhe as me anë të pajisjeve ndihmëse, që ofrojnë informacionin e nevojshëm, personi kompetent duhet të jetë në komunikim me operatorin për ta udhëhequr atë. Gjithashtu duhen marrë masa organizative për të parandaluar goditjet e ngarkesës që mund të rrezikojë punëmarrësit apo persona të tjerë.

4.2.4. Kur një punëmarrës apo person tjetër ngarkon apo shkarkon një ngarkesë me dorë, ky i fundit duhet të jetë në gjendje, nëpërmjet organizimit të mirë të punës, të ruajë kontrollin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë mbi pajisjen e punës.

4.2.5. Të gjitha operacionet e ngritjes duhet të planifikohen, të mbikëqyren dhe të zhvillohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë mbrojtjen e punëmarrësve dhe personave të tjerë. Nëse një peshë duhet të ngrihet në të njëjtën kohë nga dy ose më shumë objekte të pajisjeve të punës të projektuara për ngritjen e ngarkesave të padrejtuara, duhet të parashikohet dhe të zbatohet një procedurë për të siguruar një koordinim të mirë nga ana e operatorëve.

4.2.6. Nëse, si pasojë e një ndërprerjeje, të plotë apo të pjesshme të energjisë, pajisjet e punës të projektuara për ngritjen e ngarkesave të padrejtuara nuk mund të mbajnë ngarkesën e tyre, merren masat e duhura për të shmangur ekspozimin e punëmarrësve apo çdo personi tjetër nga çdo risk që buron nga kjo situatë.

Ngarkesat pezull nuk duhet të lihen pa mbikëqyrje, përveç rasteve kur hyrja në zonën e rrezikut është e ndaluar dhe ngarkesa është ndaluar dhe mbahet në mënyrë të sigurt.

4.2.7. Përdorimi i pajisjeve të punës, të projektuara për ngritjen e ngarkesave të padrejtuara, në ambient të hapur, duhet të ndalet kur kushtet meteorologjike përkeqësohen deri në pikën që rrezikojnë përdorimin e sigurt të pajisjeve dhe ekspozojnë punëmarrësit apo të sit ndaj risqeve. Duhet marrë masa mbrojtjeje të përshtatshme, veçanërisht, masa specifike, për shmangien

e përmbyshjes së pajisjes, për të evituar risqet për punëmarrësit apo persona të tjerë.

5. Dispozitat lidhur me përdorimin e pajisjeve të punës për punë të përkohshme në lartësi

5.1. Dispozita të përgjithshme

5.1.1. Nëse puna e përkohshme në lartësi nuk mund të kryhet në mënyrë të sigurt dhe në kushte të përshtatshme ergonomike, nga një sipërfaqe e përshtatshme, duhet të përzgjidhet pajisja e punës më e duhur për garantimin dhe ruajtjen e kushteve të sigurta të punës. Masave kolektive të mbrojtjes duhet t'u jepet përparësi ndaj masave individuale të mbrojtjes. Përmasat e pajisjeve të punës duhet të jenë të përshtatshme me natyrën e punës që do të kryet dhe ngarkesat e parashikueshme, dhe të lejojnë qarkullimin pa rreziqe.

Për aksesin në vendet e përkohshme të punës në lartësi duhet të përzgjidhen mjetet më të përshtatshme, në bazë të shpeshtësisë së kalimit, lartësisë dhe kohëzgjatjes së përdorimit. Kjo zgjedhje duhet të lejojë evakuimin në rast rreziku të menjëhershëm. Kalimi në secilin drejtim nga mjeti për akses dhe platformave, dyshemeve dhe kalimeve, nuk duhet të shkaktojë ndonjë risk shtesë për rënie.

5.1.2. Shkallët vertikale mund të përdoren si vende pune individuale në lartësi, vetëm në ato rrethana ku sipas pikës 5.1.1, përdorimi i pajisjeve të tjera më të sigurta të punës nuk justifikohet, për shkak të nivelit të ulët të riskut dhe/ose për shkak të kohëzgjatjes së shkurtër të përdorimit apo karakteristikave ekzistuese, të cilat punëdhënësi nuk mund t'i ndryshojë.

5.1.3. Puna në lartësi në platforma të varura në litarë me pajisje për pozicionimin, mund të kryhet vetëm në rrethanat kur:

5.1.3.1 nuk justifikohet përdorimi i pajisjeve të tjera më të sigurta;

5.1.3.2. vlerësimi i riskut tregon se puna mund të kryhet në mënyrë të sigurt. Në varësi të kohëzgjatjes së punës dhe parimeve ergonomike, vendi individual i punës pajiset me ndenjësë të përshtatshme.

5.1.4. Në varësi të pajisjes së punës së përzgjedhur, si më sipër, duhen marrë masat e duhura për të minimizuar risqet që rrjedhin nga përdorimi i tyre. Kur është e nevojshme, merren masa për instalimin e mjeteve mbrojtëse për parandalimin e rënies. Këto pajisje duhet të kenë një konfigurim të përshtatshëm dhe fortësi të mjaftueshme për të parandaluar ose ndaluar rënie nga lartësitë dhe, për sa është e mundur, për të mos lejuar dëmtimin e punëmarrësve apo personave të tjerë. Mjetet e mbrojtjes kolektive për

parandalimin e rënieve mund të hapen vetëm në vendet e takimit me shkallët vertikale apo hyrjeve me shkallë.

5.1.5. Kur kryerja e një detyre të caktuar kërkon largimin e përkohshëm të një mjeti për mbrojtjen kolektive, të projektuar për parandalimin e rënieve, duhet të merren masa kompensuese sigurie të efektshme. Puna nuk mund të kryhet deri sa të jenë marrë këto masa. Kur puna ka përfunduar ose përfundimisht, ose përkohësisht, duhen rivendosur mjetet kolektive të mbrojtjes për parandalimin e rënieve.

5.1.6. Puna e përkohshme në lartësi mund të kryhet vetëm kur kushtet e motit nuk rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve.

5.2. Dispozita të veçanta lidhur me përdorimin e shkallëve vertikale

5.2.1. Shkallët vertikale duhet të pozicionohen në mënyrë të tillë, e cila siguron qëndrueshmërinë e tyre gjatë përdorimit. Shkallët vertikale portative duhet të qëndrojnë në pika mbështetjeje të palëvizshme, që janë të qëndrueshme e të forta, dhe me përmasa të përshtatshme, në mënyrë të tillë që shkallaret të qëndrojnë në pozicion horizontal. Shkallët horizontale pezull duhen kapur në mënyrë të sigurt dhe, me përjashtim të shkallëve me litar, në mënyrë të tillë që ato të mos zhvendosen apo lëkunden.

5.2.2. Rrëshqitja e këmbëve të shkallëve vertikale portative duhet të parandalohet gjatë përdorimit, me anë të kapjes së skajeve të tyre të sipërme apo të poshtme, me anë të çfarëdolloj pajisjeje kundër rrëshqitjes së shkallës ose me çdo mjet zgjidhjeje me të njëjtin funksion. Shkallët vertikale bashkuese dhe shkallët vertikale zgjatuese duhet të përdoren në mënyrë të tillë që pjesët e ndryshme të mos lejohet të lëvizin afër njëra-tjetrës. Shkallët vertikale lëvizëse nuk duhet të jenë të lëvizshme para se të hipet në to.

5.2.4. Shkallët vertikale duhet të përdoren në mënyrë të tillë që të kenë një vend për të mbajtur duart dhe qëndrim të sigurt për punëmarrësit në çdo kohë. Në veçanti, nëse duhet të mbahet një peshë në dorë në një shkallë vertikale, kjo nuk duhet të krijojë pengesa drejt pikave të kapjes me dorë.

5.3. Dispozita të veçanta lidhur me përdorimin e skelës

5.3.1. Kur nuk ka një dokument që përmban llogaritjet e skelës e përzgjedhur apo ky dokument nuk përmban zgjidhjet strukturore të parashikuara, duhet të kryhen përlllogaritja e forcës dhe stabilitetit, me përjashtim të rasteve kur skela është montuar në përputhje me një konfiguracion standard, përgjithësisht të njohur.

5.3.2. Në varësi të kompleksitetit të skelave të përzgjedhura, duhet të hartohet një plan për montimin, përdorimin dhe çmontimin nga një person kompetent.

Kjo mund të jetë në formën e një plani standard, që përmban aspektet mbi detajet specifike të skelës në fjalë.

5.3.3. Duhet siguruar qëndrueshmëria e skelës. Duhet të parandalohet rrëshqitja e komponentëve mbajtës së tyre, qoftë duke i bashkëngjitur ato me sipërfaqen mbajtëse, sigurimin e pajisjeve kundër rrëshqitjes apo çdo mjet tjetër me efektshmëri të njëjtë. Sipërfaqja që mban ngarkesën duhet të ketë kapacitet të mjaftueshëm.

5.3.4. Për skelat me rrota duhet të parandalohet lëvizja e tyre aksidentale gjatë punës në lartësi me anë të pajisjeve të duhura.

5.3.5. Dimensionet, forma dhe struktura e dyshemeve të skelave duhet të jenë të përshtatshme me natyrën e punës që kryhet dhe ngarkesat që do mbahen. Ato duhet të lejojnë zhvillimin e sigurt të punës dhe kalim të sigurt mbi to. Dyshemetë e skelave duhet të montohen në mënyrë të tillë që komponentët e tyre të mos lëvizin gjatë përdorimit normal. Nuk duhet të ketë boshllëqe të rrezikshme ndërmjet elementeve të dyshemesë dhe mjeteve për mbrojtjen kolektive vertikale kundër rënies.

5.3.6. Kur pjesët e një skele nuk janë gati për përdorim, për shembull gjatë montimit, çmontimit ose ndryshimit, ato duhet të shënohen me shenja paralajmëruese të sinjalistikën në kantier dhe në vendin e punës”. Ato duhet të kufizohen në mënyrë të përshtatshme me barriera fizike, të cilat pengojnë hyrjen në zonën e rrezikut.

5.3.7. Skela mund të montohet, çmontohet ose modifikohet në shkallë të konsiderueshme, vetëm nën mbikëqyrjen e një personi kompetent dhe punëmarrësve të trajnuar siç duhet për operacionet e parashikuara, duke adresuar risqet specifike në pajtim me nenin 9 të kësaj rregulloreje, dhe më në veçanti mbi:

5.3.7.1. të kuptuarit e planit të montimit, çmontimit apo ndryshimit të skelës në fjalë;

5.3.7.2. sigurinë gjatë montimit, çmontimit apo ndryshimit të skelës në fjalë;

5.3.7.3. masat për parandalimin e riskut të rënies së personave ose objekteve;

5.3.7.4. masat e sigurisë, në rast të ndryshimit të kushteve të motit, që mund të ndikojë negativisht mbi sigurinë e skelës në fjalë;

5.3.7.5. ngarkesat e lejuara;

5.3.7.6. çdo risk tjetër që mund të mbartë montimi, çmontimi apo operacionet e ndryshimit të lartpërmendura. Personi që mbikëqyr dhe punëmarrësit në fjalë duhet të kenë në dispozicion planin e montimit dhe çmontimit, të përmendur në pikën 5.3.2, përfshirë çdo udhëzim që ai mund të përmbajë.

5.4. Dispozitat e veçanta lidhur me punën në lartësi në platforma të varura në litarë me pajisje për pozicionimin.

Puna në lartësi në platforma të varura në litar dhe me pajisjet të pozicionimit duhet të përputhet me kushtet e mëposhtme:

5.4.1. pjesët përbërëse të tyre duhet të përmbajnë të paktën dy litarë të ankoruar veç e veç; një si mjet hyrje, zbritje dhe mbështetje (litari i punës) dhe tjetri si rezervë (litar sigurie);

5.4.2. të punësuarit duhet të pajisen me dhe të përdorin një rrip trupi sigurie të përshtatshëm, i cili është i lidhur me litarin e sigurisë;

5.4.3. litari i punës duhet të pajiset me mjete të sigurta të ngjitjes dhe zbritjes dhe të ketë një sistem vetëbllokimi, për të parandaluar rënien e përdoruesit, nëse ai e humb kontrollin e lëvizjeve të tij. Litari i sigurisë duhet të pajiset me një sistem për parandalimin e rënies, gjatë lëvizjes që ndjek lëvizjet e punëmarrësit apo personave të tjerë;

5.4.4. mjetet dhe aksesorët e tjerë, që do të përdoren nga një punëmarrës apo personat e tjerë, lidhen me rripin e trupit të sigurisë apo ndenjësën e të punësuarit apo me mjete të tjera të njëjta të përshtatshme;

5.4.5. puna duhet të planifikohet dhe mbikëqyret siç duhet, në mënyrë që punëmarrësit dhe personat e tjerë, të mund të shpëtohen menjëherë në rast urgjence;

5.4.6. në përputhje me nenin 9 të kësaj rregulloreje, të punësuarit në fjalë duhet të trajtohen në mënyrë adekuate dhe specifike për operacionet e parashikuara, veçanërisht në procedurat e shpëtimit.

Në rrethana të jashtëzakonshme, kur në perspektivën e vlerësimit të riskut, përdorimi i një litari të dytë do ta bënte punën më të rrezikshme, mund të lejohet përdorimi i vetëm një litari, me kusht që të jenë marrë masa të përshtatshme për sigurinë, në përputhje me legjislacionin dhe/ose praktikën kombëtare.

RREGULLORE (MPMS) Nr.02/2016 - PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PËRDORIMIN E PAJISJEVE PERSONALE MBROJTËSE NË VENDIN E PUNËS

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse, më poshtë referuar si PPM në vendin e punës, të nevojshme për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të punësuarit në punë.
2. Kjo rregullore është në përputhshmëri me Direktivën 89/656/KEE për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës për përdorim të pajisjeve personale mbrojtëse nga ë punësuarit (Direktiva e tretë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE).

Neni 2

Fushveprimi

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që janë brenda fushës së veprimit të Ligjit nr. 04/L-161, datë 16.5.2013 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojit të ndërmarrjes dhe arsyeve për të cilat zhvillohet puna apo trajnimi në vendin e punës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtme kanë këtë kuptim:
 - 1.1. "**Pajisje personale mbrojtëse** " nënkupton çdo pajisje që përdoret nga të punësuarit dhe të vetëpunësuarit për t'u mbrojtur nga rreziqet të cilat rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin në punë si dhe çdo pjesë tjetër shtesë e prodhuar në përmbushje të këtij qëllimi (sipas shtojcës 1).
 - 1.2. "**Risku**"- nënkupton një kombinim i gjasave që dikush të dëmtohet ose të shkaktohet një dëmë tjetër nga rreziku- dhe pasojës të këtij dëmtimi. Risku përfaqëson një nivel – rëndësia e situatave të mundëshme të rrezikshme, kur një person(ose mjedis ose pronë) ekspozohet ndaj rrezikut.
 - 1.3. "**Rreziku**" - nënkupton një karakteristikë- aftësi potenciale e cdo gjëje(pajisje pune, veprimtarie, mjedisi pune, substance etj)për të shkaktoar lëndime ose dëmtime tjera.Rreziku është burimi i riskut të mundshëm për shëndetin dhe jetën e të punësuarve dhe të tjerëve.

2. Nuk do të konsiderohen si pajisje personale mbrojtëse;

2.1. veshjet që nuk janë përcaktuar në mënyrë të veçantë për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e të punësuarit dhe të vetëpunësuarve;

2.2. pajisjet personale mbrojtëse të veshura apo të përdorura nga forcat e armatosura, policia e shtetit dhe emergjencat civile;

2.3. pajisjet sportive;

2.4. pajisjet mbrojtëse dhe pajisje parandaluese për vetë-mbrojtje;

2.5. pajisjet, përfshirë ato të lëvizshme për zbulimin dhe sinjalizimin e risqeve dhe rreziqeve;

2.6. shërbimet e urgjencave dhe të shpëtimit;

2.7. mjetet e transportit rrugor.

3. Të gjitha shprehjet tjera të përdorura në këtë rregullore, kanë kuptimin e njëjtë sikurse shprehjet që janë përcaktuar me legjislacionin nga fusha e sigurisë dhe shëndetin në punë.

Neni 4

Rregulla të përgjithshme

Pajisjet personale mbrojtëse përdoren kur risqet nuk mund të shmangen apo zvogëlohen mjaftueshëm me anë të mjeteve teknike të mbrojtjes kolektive apo me masa, metoda dhe procedura të organizimit të punës.

Neni 5

Detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit

1. Punëdhënësi siguron për të punësuarit pajisjet personale mbrojtëse për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të tyre, në përputhje me Nenin 4 të kësaj Rregulloreje dhe mbi bazën e vlerësimit të riskut të veprimtarive të veçanta të punës.

2. Punëdhënësi bazuar në vlerësimin e riskut, përgatit me shkrim, për secilin profesion, listën e pajisjeve personale mbrojtëse me të cilat pajisjet punëmarrësi si dhe përcakton rregulla të veçanta lidhur me përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse.

3. Punëdhënësi vë në dispozicion, pa pagesë për punëmarrësin, pajisjet personale mbrojtëse. .

4. Punëdhënësi garanton funksionimin e mirë teknik dhe higjienën e pajisjeve personale mbrojtëse, nëpërmjet mirëmbajtjes, riparimit apo zëvendësimit në rastet e nevojshme.

5. Lista e veprimtarive të punës për të cilat sigurohen pajisjet personale mbrojtëse ndodhet në Shtojcën II.

Neni 6

Kërkesa për pajisjet personale mbrojtëse

1. Pajisjet personale mbrojtëse janë në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje, legjislacionin në fuqi, mbi konformitetin e PPM, higjienën, si dhe standardet ndërkombëtare të lidhura me to.

2. Pajisjet personale mbrojtëse të ofruara duhet të jenë të çertifikuara dhe të shënuara me shenjën CE.

3. Të gjitha pajisjet personale mbrojtëse :

3.1. sigurojnë mbrojtje të përshtatshme ndaj një rreziku ekzistues dhe/ose të mundshëm, pa shkaktuar vetë ndonjë rrezik të shtuar;

3.2. përshtaten me kushtet ekzistuese të vendit të punës përfshirë dhe ndryshimet e pritshme të tyre;

3.3. duhet ti përshtaten kërkesave ergonomike dhe gjendjes shëndetësore të punësuarave dhe të vetëpunësuarëve;

3.4. duhet ti përshtaten madhësisë së përdoruesit dhe nëse është e nevojshme, i bëhen rregullimet e duhura;

4. Pajisjet personale mbrojtëse , duhet të përshtaten njëra me tjetrën dhe duhet të jenë të efektshme kundër rreziqeve të cilat i kanosen të punësuarit dhe të vetëpunësuarit, gjatë përdorimit të më shumë se një PPM në të njejtën kohë, cilat i përdor ato në të njejtën kohë.

5. Kushtet dhe kohëzgjatja e përdorimit të pajisjeve personale e mbrojtjes përcaktohen në bazë të :

5.1. shkallës së riskut;

5.2. shpeshësisë së ekspozimit ndaj rrezikut;

5.3. karakteristikave të vendit të punës për çdo punëmarrës dhe të vetëpunësuar, si dhe

5.4. efektshmërisë së tyre.

6. Në përgjithësi, pajisjet personale mbrojtëse janë të parashikuara për përdorim personal.

7. Kur pajisjet personale mbrojtëse përdoren nga më shumë se një punëmarrës ose i vetëpunësuar, merren masat e duhura për të parandaluar krijimin e problemeve higjienike dhe shëndetësore.

Neni 7

Vlerësimi i riskut për përzgjedhjen e pajisjeve personale mbrojtëse

1. Punëdhënësi vlerëson nëse pajisjet personale mbrojtëse plotësojnë kërkesat e Nenit 6, përpara zgjedhjes së tyre i cili vlerësim përfshin:

1.1. identifikimin e rreziqeve ndaj të cilave mund të ekspozohen të punësuarit dhe të vetëpunësuarit;

1.2. analizën dhe vlerësimin e risqeve që mund të shmangen me mjete të tjera;

1.3. përcaktimin e karakteristikave që çdo pajisje personale mbrojtëse duhet t'i ketë për të qenë e efektshme kundër rreziqeve përkatëse, duke marrë parasysh edhe riskun që mund të krijohet nga përdorimi i tyre;

1.4. krahasimin e karakteristikave të pajisjeve personale mbrojtëse në dispozicion me karakteristikat e përmendura në nënparagrafin 1.3. të këtij paragrafi;

1.5. përgatitjen e dokumentit përfundimtar mbi vlerësimin e pajisjeve personale mbrojtëse dhe hartimin e listës së pajisjeve personale mbrojtëse për çdo rrezik dhe profesion (sipas Shtojcës III).

2. Vlerësimi i kërkesave të përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, rishikohet nëse bëhen ndryshime në proceset e punës, kushtet e punës, vendet e punës si dhe organizimit të punës.

Neni 8

Informimi, trajnimi, konsultimi dhe pjesëmarrja

1. Të Punësuarëve u sigurohet dhe u vihet në dispozicion informacion i nevojshëm për kushtet përdorimit për çdo lloj të pajisjeve personale mbrojtëse.

2. Punëdhënësi i informon paraprakisht të punësuarit dhe të vetëpunësuarit për risqet nga të cilat i mbron përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse. Udhëzimet përkatëse duhet të jenë të kuptueshme për të punësuarit dhe të vetëpunësuarit.

3. Punëdhënësi organizon trajnime dhe kur është e nevojshme, organizon demonstrime për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse.

4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e të punësuarëve dhe përfaqësuesve të tyre për përzgjedhjen, sigurimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve personale mbrojtëse si dhe llojeve të pajisjeve të tjera që mbulohen nga kjo Rregullore bëhet në përputhje me Nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-161, Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

5. Të punësuarit dhe të vetëpunësuarit janë të detyruar të përdorin pajisjet personale mbrojtëse në përputhje me udhëzimet e punëdhënësit dhe prodhuesit.

Neni 9

Shtojcat e Rregullore

1. Shtojcat që i janë bashkëngjitur kësaj j Rregullore, janë pjesë përbërëse e saj:

1.1. Shtojca 1: Listë jo shteruese e llojeve të pajisjeve personale mbrojtëse

1.2. Shtojca 2: Listë udhëzuese jo shteruese e veprimtarive dhe sektorëve të veprimtarisë që mund të kërkojnë sigurimin e pajisjeve personale mbrojtëse”

1.3.Shtojca 3: Model dokumenti të vlerësimit të riskut për përgatitjen e listës së pajisjeve personale mbrojtëse sipas profesioneve”.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Shtojca I

LISTË JO SHTERUESE E PAJISJEVE PERSONALE MBROJTËSË

1 .MBROJTJA E KOKËS

- 1.1.Kaska mbrojtëse për përdorim në industri (miniera, kantiere ndërtimi, përdorime në degë të tjera industriale);
- 1.2. Mbrojtja e lëkurës së kokës (kapelë, beretë, rrjetë për flokë me ose pa strehë për sytë);
- 1.3. Mbrojtëse e kokës(beretë, kapelë, kapele me lidhëse, etj, me pëlthurë, me pëlthurë mbrojtëse, etj).

2.MBROJTJA E DËGJIMIT

- 2.1. Tapa veshësh dhe pajisje të ngjashme;
- 2.2.Kaska për mbrojtje të plotë akustike;
- 2.3. Kufjet që mund t'i vendosen kaskave industriale;
- 2.4. Mbrojtëse (kufje) veshi me aparat dëgjimi me lak induksioni LF;
- 2.5. Mbrojtëse veshi me pajisje kufje me mikrofon.

3.MBROJTJA E SYVE DHE E FYTYRËS

- 3.1. Syze;
- 3.2. Syze hermetike;
- 3.3. Syze me rreze X, syze për rreze laser, ultraviolet, infra të kuqe, syze të rrezatimit të dukshëm;
- 3.4. Mbrojtëse për fytyrën;
- 3.5. Maska për saldim (maska dore, maska që lidhen në kokë apo maska që mund t'i vendosen kaskave mbrojtëse).

4. MBROJTJA E FRYMËMARRJES

- 4.1. Filtrat e pluhurit, filtrat e gazit dhe filtrat e pluhurit radioaktiv;
- 4.2. Pajisje izoluese me furnizim ajri;
- 4.3.Pajisje të frymëmarrjes, përfshirë maskën e lëvizshme të saldimit;
- 4.4. Pajisje zhytjeje;
- 4.5.Kostume zhytjeje.

5.MBROJTA E DUARVE DHE KRAHËVE

- 5.1. Dorëza me gishta që sigurojnë mbrojtje:
 - 5.1.1. nga makineritë (shpimet, prerjet, dridhjet, etj);
 - 5.1.2. nga lëndët kimike;
 - 5.1.3. nga elektriciteti dhe nga të nxehtit;
 - 5.1.4. Doreza me gishta të bashkuar;
 - 5.1.5. Gishtëza;
 - 5.1.6 Mbi mëngë;
 - 5.1.7. Mbrojtëse të kyçit të dorës për punë të rëndë;
 - 5.1.8. Doreza pa gishta;
 - 5.1.9. Doreza mbrojtëse.

6. MBROTJA E SHPUTAVE TË KËMBËVE DHE E KËMBËVE

- 6.1. Këpucë të sheshta, çizme deri tek kyçi i këmbës, çizme me gjatësi deri tek pulpa e këmbës, çizme të sigurisë;
- 6.2. Këpucë të cilat mund të zgjidhen apo hiqen me shpejtësi.;
- 6.3. Këpucë me kapak mbrojtës shtesë në majë;
- 6.4. Këpucë, çizme dhe mbi- çizme me shuall rezistuese ndaj të nxehtit;
- 6.5. Këpucë, çizme dhe mbi- çizme rezistuese ndaj të nxehtit;
- 6.6. Këpucë, çizme dhe mbi-çizme termike;
- 6.7. Këpucë, çizme dhe mbi-çizme rezistuese ndaj dridhjeve.;
- 6.8. Këpucë, çizme dhe mbi-çizme kundër elektrizimit ;
- 6.9. Këpucë, çizme dhe mbi-çizme izoluese;
- 6.10. Çizme mbrojtëse për operatorët e sharrave me zinxhir;
- 6.11. Nallane;
- 6.12. Gjunjëza;
- 6.13. Mbrojtës të çmontueshëm në qafën e këmbës;
- 6.14. Qafore e çmontueshme këpucësh;

6.15. Shuall i çmontueshëm (që nuk e përçon nxehtësinë, i pa shpueshëm dhe kundër djersës);

6.16. Thumba të çmontueshëm për akull, borë ose dysheme të rrëshqitshme.

7.MBROJTJA E LËKURËS

7.1.Kremra/ pomada mbrojtëse.

8.MBROJTJA E TRUNGUT DHE BARKUT

8.1. Jelekë, xhaketa mbrojtëse dhe përparëse për të siguruar mbrojtje nga makineritë (shpimet, prerjet, spërkatje me pika metali të shkrirë etj);

8.2. Jelekë, xhaketa mbrojtëse dhe përparëse për të siguruar mbrojtje nga lëndët kimike.

8.3. Jelekë me ngrohje;

8.4. Jelekë shpëtimi.

8.5. Përparëse për mbrojtje nga rrezet X.

8.6. Ripa mesi sigurie.

9.MBROJTJA E TË GJITHË TRUPIT

9.1. Pajisje të projektuara për të parandaluar rëniet;

9.2. Pajisje për parandalimin e rënieve (pajisje të plota me të gjithë aksesorët e nevojshëm);

9.3. Pajisje frenuese për amortizimin e energjisë kinetike (pajisje të plota me të gjithë aksesorët e nevojshëm);

9.4. Ripa trupi sigurie;

9.5. Veshje mbrojtëse;

9.6. Veshje pune të “sigurisë” (në dy-pjesë dhe si kominoshe);

9.7. Veshje që sigurojnë mbrojtje nga makineritë (shpimet, prerjet etj.) ;

9.8. Veshje që sigurojnë mbrojtje nga lëndët kimike;

- 9.9. Veshje të sigurojë mbrojtje nga spërkatjet me pika metali të shkrirë dhe nga rrezatimi i rrezeve infra të kuqe;
- 9.10. Veshje mbrojtëse ndaj nxehtësisë;
- 9.11. Veshje mbrojtëse ndaj të ftohtit;
- 9.12. Veshje që sigurojnë mbrojtje nga ndotja radioaktive;
- 9.13. Veshje mbrojtëse nga pluhuri;
- 9.14. Veshje kundër gazit;
- 9.15. Veshje dhe pjesë shtesë me sinjalizim fluoreshent, retro reflektues (shirit krahësh, doreza, etj.);
- 9.16. Mbulesa mbrojtëse.

Shtojca II

LISTË UDHËZUESE JO SHTERUESE E VEPRIMTARIVE DHE SEKTORËVE TË VEPRIMTARISË QË MUND TË KËRKOJNË SIGURIMIN E PAJISJEVE PERSONALE MBROJTËSE

1.MBROJTJA E KOKËS (MBROJTJA E KAFKËS)

1.1.Kaskat mbrojtëse

1.1.1.Punë ndërtuese, punë të kryera mbi, nën ose në afërsi të skelave dhe vendeve të punës të ngritura, ndërtim dhe heqje armature, montim dhe instalim dhe punë për shembjen e objekteve;

1.1.2. Punë në ura metalike, ndërtime të objekteve prej metali, direkë, kulla, struktura hidraulike prej metali, furra shkrireje, punimet me metal, mullinj rrotullues, kontenierë të mëdhenj, tubacione me diametër të madh, impiante ngrohjeje dhe nënstacionet elektrike;

1.1.3. Punë në gropa, trashe, puse dhe galeri;

1.1.4. Punë në tokë dhe shkëmbinj;

1.1.5.Punë në objektet nëntokësore, gurrëthyes, gërmimet e hapura, zhvendosja e rezervave minerale;

1.1.6. Punë për instalimin e pajisjeve rrufepritëse;

1.1.7. Punë me lëndë shpërthyes;

1.1.8. Punë në afërsi të ashensorëve, mekanizmave të ngritjes, vinçave dhe transportuesve;

1.1.9. Punë për instalimet e furnaltave të larta, instalimet e reduktimit të drejtpërdrejtë, instalimet në uzinat metalurgjike, në mullinjtë rrotullues, në punët me metale, në repartet e farkëtimit dhe fonderisë(kallupimit);

1.1.10. Punë me furrat industriale, kontenierët, makineritë, çisternat, bunkerët dhe tubacionet.

1.1.11. Punë për ndërtimin e anijeve;

1.1.12. Punë për zëvendësimin e shinave në hekurudha;

1.1.13. Punë në thertore.

2.MBROJTJA E SHPUTAVE TË KËMBËVE

2.1.Këpucë mbrojtëse kundër shpimeve

- 2.1.1.Punë për ndërtimin e kolonave të betonit, bazave të betonit dhe ndërtimin e rrugëve;
- 2.1.2.Punë në skelë;
- 2.1.3.Punë për shembjen e kolonave të betonit;
- 2.1.4.Punime në ndërtim me beton dhe me elementë parafabrikat, përfshirë vendosjen dhe heqjen e armaturës;
- 2.1.5.Punë në kantiere dhe hapësira magazinimi;
- 2.1.6. Punë në ndërtimin e çative;

2.2..Këpucë të sigurisë pa shoje kundër shpimeve;

- 2.2.1. Punë në ura metalike, në ndërtimin e ndërtesave prej metali, direktë, kulla, ashensorë, struktura hidraulike të çelikut, në furra të shkrirjes, industrinë e çelikut dhe mullinjtë rrotullues, kontenierë të mëdhenj, tubacione me diametër të gjërë, vinça, impiante të ngrohjes dhe në stacione elektrike;
- 2.2.2. Ndërtimi i furrave, instalimi i ngrohjes dhe ventilimi, montim i strukturave metalike;
- 2.2.3. Punë për riparimin dhe mirëmbajtjen;
- 2.2.4. Punë për instalimet e furnaltave të larta, instalimet e reduktimit të drejtpërdrejtë, instalimet në uzinat metalurgjike, në mullinjtë rrotullues, në punët me metale, në repartet e farkëtimit dhe fonderisë, impiante të presimit në të nxehtë dhe petëzimit;
- 2.2.5. Punë në gurrëthyes dhe gërmime të hapura, nxjerrja e rezervave të qymyrit;
- 2.2.6. Punë në njësitë e përpunimit të materialeve të ngurta;
- 2.2.7. Fabrikimi, përpunimi dhe trajtimi i prodhimeve prej qelqi;
- 2.2.8. Punë me kallëpe në industrinë e qeramikës;
- 2.2.9. Punimet e riveshjes së furrave në industrinë e qeramikës;
- 2.2.10. Punë me kallëpe në industrinë e artikujve qeramike dhe industrinë e materialeve të ndërtimit;
- 2.2.11. Transporti dhe magazinimi;

2.2.12. Punë me blloqe mishi të ngrirë dhe pako ushqimi të konservuara;

2.2.13. Ndërtimi i anijeve;

2.2.14. Punë për zëvendësimin e shinave hekurudhore;

2.3.Këpucë të sigurisë me taka apo taka ortopedike dhe shoje kundër shpimit

2.3.1. Punë mbi çati;

2.4.Këpucë mbrojtëse me shoje të izoluara

2.4.1.Punë me dhe mbi materiale shumë të nxehta dhe shumë të ftohta.

2.5. Këpucë të sigurisë, të cilat mund të hiqen lehtësisht;

2.5.1. Punë ku ka risk nga depërtimi i substancave të shkrira.

3.MBROJTJA E SYVE DHE E FYTYRËS

3.1.Syze mbrojtëse, maska apo ekrane për fytyrën;

3.1.1. Punë saldimi, mprehje dhe prerje;

3.1.2. Stukim dhe gdhendje metali.

3.1.3. Punim dhe përpunim i materialeve të ngurta.

3.1.4. Punë me trapano dhe pajisje të tjera shpuese;

3.1.5. Punë me makineritë e thyerjes dhe copëzimit të gurit (fronto);

3.1.6. Punime stampimi dhe farkëtimi;

3.1.7. Largim dhe thyerje e copëzave;

3.1.8. Spërkatje me substanca gërryese;

3.1.9. Punë me acide dhe lëndë gërryese,
desznfektues dhe produkte pastrimi gërryese;

3.1.10. Punë me spërkatës të lëngshëm;

3.1.11. Punë me dhe në afërsi të substancave të shkrira;

3.1.12. Punë me nxehtësi rrezatuese;

3.1.13. Punë me rreze lazer.

4.MBROJTJA RESPIRATORE

4.1.Maskat respiratore/Aparaturat e mbrojtjes së frymëmarrjes

- 4.1.1.Punë në kontenierë, zona të kufizuara dhe furra industriale me çlirim gazi, me rrezik helmimi ose pamjaftueshmëri oksigjeni;
- 4.1.2.Punë gjatë transportit të metalit të shkrirë.
- 4.1.3.Punë në afërsi të konvertuesve të gazit dhe tubave të gazit të furrave të shkrirjes;
- 4.1.4.Punë në afërsi të xhepave shkarkues të furrave të shkrirjes, ku çlirohen tymra të metaleve të rënda;
- 4.1.5.Punë në veshjen e brendshme të kaldajave dhe xhepave ku çlirohet pluhur;
- 4.1.6.Lyerje me pistoletë pa ajrim të mjaftueshëm;
- 4.1.7.Punë në trashe, kanalizime dhe zona të tjera nëntokësore që lidhen me ujërat e zeza;
- 4.1.8.Punë në impiante frigoriferike, ku ka rrezik nga avullimi i lëndës ftohëse.

5. MBROJTJA E DËGJIMIT

5.1.Mbrojtësit e veshëve

- 5.1.1.Punë me presat metalike;
- 5.1.2.Punë me trapan me ajër të komprimuar;
- 5.1.3.Punë e stafit në sheshet e aeroportit;
- 5.1.4.Punë me tokmak;
- 5.1.5.Punë me dru dhe tekstile.

6. MBROJTJA E TRUPIT, DUARVE DHE KRAHËVE

6.1.Veshjet mbrojtëse

- 6.1.1.Punë me ose përpunimi i lëndëve acide dhe ngjitëse, dezinfektuese dhe substancave pastruese gërryese;
- 6.1.2.Punë me ose në afërsi të materialeve të nxehta dhe ku ndihen efektet e nxehtësisë;

6.1.3.Punë me prodhimet e xhamit;

6.1.4.Punë në dhoma frigoriferike të ngrirjes së thellë.

6.2.Veshje mbrojtëse rezistuese ndaj zjarrit

6.2.1.Saldim në zona të kufizuara.

6.3.Përparëse kundër shpimit

6.3.1.Punë për therje dhe ndarjen e mishit nga kocka.

6.3.2.Punë me thikë dore që përfshin edhe tërheqjen e thikës në drejtim të trupit.

6.4. Përparëse prej lëkure;

6.4.1. Saldimi;

6.4.2. Farkëtimi;

6. 4.3. Fonderi.

6.5.Mbrojtja e parakrahut

6.5.1.Therja dhe ndarja e mishit nga kocka.

6.6. Dorezat

6.6.1. Saldimi;

6.6.2. Punë me objekte me teh të mprehtë, përjashtuar makinat me rrezik prerjen e dorezave;

6.6.3. Punë e pambrojtur me acide dhe solucione ngjitëse.

6.7.Dorezat me rrjetë metalike

6.7.1.Therja dhe ndarja e mishit nga kocka

6.1.1.Prerja e rregullt duke përdorur një thikë dore për prodhim dhe therje;

6.1.2.Ndryshimi i thikave të makinave prerëse.

7. VESHJE TË PAPËRSHKRUESHME NGA UJI

7.1.Punë në ambient të hapur, në shi dhe mot të ftohtë.

8.VESHJE REFLEKTUESE

8.1.Punë ku punëtorët duhet të jenë qartësisht të dukshëm.

9.VESHJE TRUPI ME RRIPA SIGURIE

9.1.Punë në skela:

9.1.1.Montimi i pjesëve të parafabrikaara;

9.1.2.Punë në direk.

10.LITARËT E SIGURISË

10.1.Punë në vinç, në lartësi

10.1.1.Punë në lartësi në raftet e magazinave dhe pajisjet "pirun";

10.1.2.Punë në pjesët e larta të kullave të shpimit;

10.1.3.Punë në puse dhe kanalizime.

11.MBROJTJA E LËKURËS

11.1.Përpunim i materialeve veshëse;

11.2.Përpunim kimik i lekurës.

SHTOJCA III:

MODEL DOKUMENTI TË VLERËSIMIT TË RISKUT PËR PËRGATITJEN E LISTËS SË PAJISJEVE PERSONALE MBROJTËSESIPAS PROFESIONEVE

(Vlerësimi dhe dokumenti realizohen për çdo profesion të veçantë)

A) Faqja e parë:

Shoqëria:	
FLETA E VLERËSIMIT TË RISKUT PËR PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE SIPAS PROFESIONIT Nr:	
Profesioni: (për shembull: Marangoz)	Departamenti, vendi i punës
Përshkrimi i veprimtarisë së punës	Rreziqet (risqet) që vijnë nga veprimtaria

B) Identifikimi dëmtimeve të mundshme të trupit

Profesioni

:

		RREZIQET, RISQET																				
		FIZIKE							KIMIKE				BIOLOGJIKE									
		MEKANIKE				TERMIKE			RREZA TIM		AVUJ		LËNGJE									
		Rënie nga lartësitë	Goditje, prerje përplasje, shtypje	Shpime, prerje, fshikje	Dridhje	Rrëshqitje, rënie	Nxehtësi, zjarr	Të ftohtët	ELEKTRIKE	Jo jonizuese	Jonizuese	ZHURMA	Pluhur, fibra	Tymra	Avuj	Zhytje	Spërkatjet, rrymat	GAZE, AVUJ	Baktere të dëmshme	Viruse të dëmshme	Kërpudha myku	Anti-gjene jo mikrobiologjike
PJESE TË TRUPIT	KOKA	Kafka																				
		Veshët																				
		Sytë																				
		Rrugët e frymëmarrjes																				
		Fytyra																				
		E gjithë koka																				
	GJYMITYRET E SPERMIT	Shputat e duarve																				
		Krahët (pjesë)																				
	GJYMITYRET E POSHTEM	Shputat e këmbës																				
		Këmbët (pjesë)																				
	TE NDRYSHME	Lëkura																				
		Trungu/ barku																				
Pasazhe parenterale																						
I gjithë trupi																						

C) Vlerësimi i riskut për përzgjedhjen e pajisjeve personale mbrojtëse

Rreziku	Pjesë të ekspozuara të trupit	Risku (1,2,3,4,5)	Kërkesa për PPM-në	PPM të propozuara (Shtojca 1)	Lloji(et) e PPM-në

D) Lista e pajisjeve personale mbrojtëse për profesionin..... (Dokumenti përfundimtar)

PPM	Lloji (et) e PPM-ve	Rreziku	Periudha e përdorimit	Kushtet e përdorimit të PMI-ve

RREGULLORE (MPMS) Nr. 03/2016 - PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR MBROJTJEN E PUNËSUARËVE LIDHUR ME PUNËN E KRAHUT ME NGARKESA

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për mbrojtjen e të punësuarve lidhur me punën e krahut me ngarkesa kur ka risk për shëndetin, veçanërisht për dëmtime muskulo-skeletore.
2. Kjo rregullore është në përputhshmëri me Direktivën 90/269/KEE e Këshillit e datës 29 maj 1990 për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë për mbajtjen manuale të ngarkesave kur ka një risk veçanërisht për dëmtime të shpinës për punonjësit (Direktiva e katërt individuale në kuptim të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që janë brenda fushës së veprimit të ligjit “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojit të ndërmarrjes dhe arsyeve për të cilat zhvillohet puna apo trajnimi në vendin e punës.

Neni 3

Përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtme kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **“Punë krahu me ngarkesa”**- nenkupton çdo mënyrë të transportimit ose mbajtjes së një ngarkese, nga një ose më shumë të punësuar, përfshirë ngritjen, uljen, shtytjen, tërheqjen, mbështetjen ose lëvizjen e një ngarkese, e cila për shkak të karakteristikave të saj ose të kushteve ergonomike të pafavorshme, përfshin një risk, veçanërisht për çrregullime muskulo-skeletore për të punësuarit.
2. Të gjitha shprehjet tjera të përdorura në këtë rregullore, kanë kuptimin e njëjtë sikurse shprehjet që janë përcaktuar me legjislacionin nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Neni 4

Detyrimet e punëdhënësit

1. Punëdhënësi merr masat e duhura organizative dhe përdor mjetet e përshtatshme, në veçanti pajisjet mekanike, për të shmangur nevojën për punën e krahut me ngarkesa nga ana e të punësuarit.

2. Në rastet kur nevoja për punën e krahut me ngarkesa nuk mund të shmanget, sipas paragrafit 1 të këtij neni, punëdhënësi merr masat e duhura organizative, përdor pajisjet e përshtatshme dhe u vë në dispozicion të punësuarit pajisjet e nevojshme sipas Shtojcës I të kësaj Rregulloreje, për të zvogëluar riskun nga puna e krahut me ngarkesa.

3. Në çdo rast kur puna e krahut me ngarkesa nuk mund të shmanget, punëdhënësi e organizon punën dhe vendet e punës në mënyrë të tillë që puna e krahut me ngarkesa të jetë sa më e sigurt dhe e shëndetshme dhe për këtë, punëdhënësi ndër të tjera:

3.1. vlerëson, paraprakisht nëse është e mundur, kushtet e sigurisë dhe shëndetit për llojin e punës dhe, në veçanti, shqyrton karakteristikat e ngarkesave, sipas Shtojcës I të kësaj rregulloreje; Nëse vlerësimi tregon një risk domethënës për dëmtime muskulo-skeletore të shpinës, atëherë personi përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë kryhen një vlerësim më specifik, duke pasur parasysh vlerat udhëzuese të Shtojcës I(5) të kësaj rregulloreje.

3.2. merr masat e duhura për të shmangur ose zvogëluar riskun për të punësuarit, veçanërisht për dëmtime muskulo-skeletore, duke pasur parasysh karakteristikat e mjedisit dhe veprimtarisë së punës, sipas Shtojcës I të kësaj rregulloreje.

4. Në çdo rast kur punëdhënësi i cakton të punësuarit punë krahu me ngarkesa, ai duhet të ketë parasysh faktorët individualë të riskut përfshirë aftësitë fizike të të punësuarit për sa i përket shëndetit dhe sigurisë, ashtu sic përcaktohet në Shtojcën I (5) të kësaj Rregulloreje, dhe rezultatet e ekzaminimeve mjekësore të kryera sipas legjislacionit në fuqi.

5. Në rastet kur është e nevojshme të vlerësohen aftësitë shëndetësore të të punësuarit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, punëdhënësi është i detyruar të sigurojë ekzaminimin dhe kujdesin shëndetësor.

Neni 5

Informimi dhe trajnimi i të punësuarve

1. Punëdhënësi informon të punësuarit, përfaqësuesit e tyre dhe të vetëpunësuarit mbi të gjitha masat që duhet të zbatohen për ruajtjen e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit lidhur me punën e krahut me ngarkesa.

2. Punëdhënësi siguron që të punësuarit, përfaqësuesit e tyre dhe të vetëpunësit të marrin informacione të përgjithshme dhe kur është e mundur informacione të hollësishme lidhur me:

2.1. peshën dhe karakteristikat të tjera të ngarkesës, të tilla si qendra e gravitetit e anës më të rëndë kur një ngarkesë ngarkohet në mënyrë të pabalancuar;

2.2. riskun e veçantë për dëmtime muskulo-skeletore.

3. Punëdhënësi u siguron të punësuarve udhëzime dhe trajnime të duhura për mënyrën korrekte të punës së krahut me ngarkesa dhe risqet ndaj të cilave ata mund të ekspozohen, veçanërisht nëse puna e krahut me ngarkesa nuk kryhet në mënyrë korrekte, sipas Shtojcave I të kësaj Rregulloreje.

4. Në këto trajnime duhet të ushtrohen teknikat e duhura për ngritjen lart, mbajtjen dhe shtytjen/ tërheqjen.

5. Gjatë trajnimit është e përshtatshme që të përfshihen ekspertë të tillë si fizioterapistë dhe/ose ergoterapistë.

Neni 6

Konsultimi dhe pjesëmarrja e të punësuarve

Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarve lidhur me punën e krahut me ngarkesa, duke i kushtuar vëmendje edhe Shtojcave të kësaj Rregulloreje, në përputhje me nenin 13 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Neni 7

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore, punëdhënësi merr masa për kryerjen e mbikëqyrjes shëndetësore për të punësuarin në rastet kur:

1.1. vlerësimi i riskut tregon një risk për shëndetin dhe sigurinë e tyre si pasojë e punës së krahut me ngarkesa;

1.2. është e nevojshme të sigurohemi që aftësitë fizike dhe kapacitetet shëndetësore të të punësuarit janë të përshtatshme për detyrën e ngarkuar, bazuar në rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore;

1.3. i punëmari vuan nga një çrregullim shëndetësor që dyshohet të jetë rezultat i punës së krahut me ngarkesa.

2. Rezultatet e mbikqyrjes shëndetësore merren në konsideratë kur zbatohen masat parandaluese në vendin specifik të punës.

3. Në përputhje me legjislacionin dhe praktikat kombëtare:

3.1. i punësuarit ka casje tek rezultatet e mbikqyrjes shëndetësore që ka lidhje me te, dhe

3.2. i punësuarit ose punëdhënësi mund të kërkojnë rishikimin e rezultateve të mbikqyrjes shëndetësore.

4. Të dhënat e mbikqyrjes shëndetësore, përfshirë rrezultatit përfundimtarë për aftësinë për punë për secilin të punësuarë, dokumentohen dhe përditësohen nga mjeku i punës, në përputhje me legjislacionin për mbikqyrjen shëndetësore dhe për mbrojtjen e të dhënave personale në një formë e cila lejon shqyrtimin e tyre të mëvonshëm.

5. I punësuarit, me kërkesë të tij/ saj ka të drejtë të caset tek të dhënat e kartelës së tij / saj të shëndetit në punë.

6. Kopje të kartelave të shëndetit në punë i vihen në dispozicion autoriteteve kompetente me kërkesë të tyre.

Neni 8

Shtojca

Shtojca I faktorë reference për punën e krahut me ngarkesa”, dhe Shtojca II “Vlerat kufi për punën e krahut me ngarkesa” janë pjesë përbërëse të kësaj rregullore.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Ministrit të MPMS.

SHTOJCA I

FAKTORËT REFERUES PËR PUNËN E KRAHUT ME NGARKESA

Gjatë kryerjes së vlerësimit të riskut për situatat e punës se krahut me ngarkesa, kur ka risk veçanërisht për dëmtime të sistemit muskulo-skeletor të të punësuarve, merren parasysh njëkohësisht faktorët e ndryshëm të renditur në këtë Shtojcë.

.1.Karakteristikat e ngarkesës

Puna e krahut me ngarkesa mund të paraqesë risk për shëndetin, veçanërisht për dëmtime muskulo-skeletore nëse ngarkesa është:

- 1.1.tepër e rëndë ose tepër e madhe;
- 1.2. voluminoze ose e vështirë për t'u kapur;
- 1.3. e paqëndrueshme apo ka elemente që mund të lëvizin..
- 1.4. e pozicionuar në një mënyrë që bën të detyrueshme mbajtjen ose manipulimin në një distancë të madhe nga trupi (më shumë se 0.25 m), ose me një përkulje ose përdredhje të trupit dhe
- 1.5. me risk shtesë për shkak të kontureve dhe/ose dendësisë së saj, veçanërisht në rastin e një përplasjeje.

2. Aktiviteti fizik i nevojshëm

Një aktivitet fizik mund të paraqesë risk, veçanërisht për dëmtime të sistemit muskulo-skeletor, në rastet kur:

- 2.1. është i tepruar;
- 2.2. arrihet vetëm me anë të një lëvizjeje përdredhëse të trupit;
- 2.3. mund të rezultojë në një lëvizje të papritur të ngarkesës;
- 2.4. realizohet duke e mbajtur trupin në një pozicion të paqëndrueshëm

3. Karakteristikat e mjedisit të punës

Karakteristikat e mjedisit të punës mund të rrisin riskun, veçanërisht për dëmtime të shpinës, nëse:

- 3.1. nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të zhvilluar veprimtarinë me ngarkesa, në veçanti në drejtim vertikal;

3.2. dysHEMEJA është e pasheshuar (jo e njëtrajtshme), duke paraqitur rreziqe për pengime, ose është e rrëshqitshme për llojin e veshjes së këmbëve të të punësuarve;

3.3. vendi i punës ose mjedisi i punës nuk lejon mbajtjen e ngarkesave në një lartësi të sigurt ose mbajtjen e trupit të të punësuarve në një pozicion të përshtatshëm;

3.4. ka ndryshime në nivelin e dyshemesë ose sipërfaqes së vendit të punës, të cilat kërkojnë manipulimin e ngarkesave në nivele të ndryshme;

3.5. dysHEMEJA ose vendi ku qëndron këmba janë të paqëndrueshme;

3.6. temperatura, lagështia ose ajrosja janë të papërshtatshme.

4. Kërkesat e veprimtarisë

Veprimtaria mund të përbëjë risk, veçanërisht për dëmtimin e sistemit muskulo-skeletor, nëse ajo përfshin një ose më shumë nga kërkesat e mëposhtme:

4.1. aktivitete fizike të tejkujtura, më të shpeshta seç duhet, ose që detyrojnë një qëndrim statik të shtyllës kurrizore;

4.2. një periudhë çlodhjeje e pamjaftueshme;

4.3. distanca të tepruara të ngritjes, uljes ose mbajtjes;

4.4. një ritëm pune të përcaktuar nga procesi i punës, i cili nuk mund të ndryshohet nga i punësuar.

5. Faktorët individualë të riskut

I punësuar mund të jetë në risk nëse ai:

5.1. është i papërshtatshëm për të kryer detyrën në fjalë nga pikëpamja fizike, si obeziteti apo përmasat trupore, ose nga pikëpamja shëndetësore, si probleme me zemrën dhe me qarkullimin e gjakut;

5.2. mban veshje, këpucë ose aksesore të tjerë personal të papërshtatshëm;

5.3. nuk ka njohuri të mjaftueshme ose trajnimin e duhur.

3. Karakteristikat e mjedisit të punës

Karakteristikat e mjedisit të punës mund të rrisin riskun, veçanërisht për dëmtime të shpinës, nëse:

3.1. nuk ka hapësirë të mjaftueshme për të zhvilluar veprimtarinë me ngarkesa, në veçanti në drejtim vertikal;

- 3.2. dysHEMEJA është e pasheshuar (jo e njëtrajtshme), duke paraqitur rreziqe për pengime, ose është e rrëshqitshme për llojin e veshjes së këmbëve të të punësuarve;
- 3.3. vendi i punës ose mjedisi i punës nuk lejon mbajtjen e ngarkesave në një lartësi të sigurt ose mbajtjen e trupit të të punësuarve në një pozicion të përshtatshëm;
- 3.4. ka ndryshime në nivelin e dyshemesë ose sipërfaqes se vendit të punës, të cilat kërkojnë manipulimin e ngarkesave në nivele të ndryshme;
- 3.5. dysHEMEJA ose vendi ku qëndron këmba janë të paqëndrueshme;
- 3.6. temperatura, lagështia ose ajrosja janë të papërshtatshme.

4. Kërkesat e veprimtarisë

Veprimtaria mund të përbëjë risk, veçanërisht për dëmtimin sistemit muskulo-skeletor, nëse ajo përfshin një ose më shumë nga kërkesat e mëposhtme:

- 4.1. aktivitete fizike të tejzgjata, më të shpeshta seç duhet, ose që detyrojnë një qëndrim statik të shtyllës kurrizore;
- 4.2. një periudhë çlodhjeje e pamjaftueshme;
- 4.3. distanca të tepruara të ngritjes, uljes ose mbajtjes;
- 4.4. një ritëm pune të përcaktuar nga procesi i punës, i cili nuk mund të ndryshohet nga i punësuar.

5. Faktorët individualë të riskut

I punësuar mund të jetë në risk nëse ai:

- 5.1. është i papërshtatshëm për të kryer detyrën në fjalë nga pikëpamja fizike, si obeziteti apo përmasat trupore, ose nga pikëpamja shëndetësore, si probleme me zemrën dhe me qarkullimin e gjakut;
 - 5.2. mban veshje, këpucë ose aksesore të tjerë personal të papërshtatshëm;
 - 5.3. nuk ka njohuri të mjaftueshme ose trajnimit të duhur.
 - 5.4. Kufijtë e forcës maksimale të ngarkesës që shtyhet dhe ngarkohet rregullisht (shpesh): 8 kg herë pas here: 15 kg
6. Për të punësuarit me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit në fuqi, përpara se t'u ngarkohet punë krahu me ngarkesa, nevojitet rekomandimi nga mjeku i punës.
7. Masat organizative janë p.sh. ndarja e detyrave të punës për dy të punësuar, ose zëvendësimi i ngritjes duke i shtyrë apo tërhequr. Mjetet e përshtatshme (teknike) janë për shembull ndihma me ngritje mekanike, siç janë sistemet pneumatike për ngritje, vinça të vegjël, etj.

SHTOJCA II

VLERAT KUFË PËR PUNËN E KRAHUT ME NGARKESA

1. Vlerat kufi të ngarkesës (pesha maksimale) për burra dhe gra në pozicion bazë në këmbë dhe në kushte pune optimale:

Mosha	Vlerat kufi të ngarkesës ¹ (kg)	
	Burrë	Grua
18 – 29 vjeç	50 kg	20 kg
30 – 39 vjeç	45 kg	15 kg
40 – 49 vjeç	40 kg	15 kg
50 – 65 vjeç	35 kg	10 kg

2. Kur kushtet e punës nuk janë optimale, pesha e ngarkesës duhet të reduktohet në mënyrë të përshtatshme. Kushtet jo optimale konsiderohen të tilla si vështirësi të kapjes, dysheme të pasheshuara, pozicione pune fiziologjikisht të pafavorshme, mbajtja e ngarkesës me riskun për tu rrëzuar, mungesa e formës fizike të punësuarve, etj.

3. Ngarkesat që peshojnë 30-50 kg mund të ngrihen nga burrat në mënyrë të vazhdueshme për për një periudhë maksimale kohore prej një orë. Pushimet ndërmjet seksioneve të kohës për ngritjen e ngarkesave nuk duhet të jenë më të shkurtra se 30 minuta.

4. Limitet e vlerës maksimale të ngarkesës (pesha maksimale) për detyra të ngritjes dhe bartjes për adoleshentët në një pozitë në këmbë:

mosha	Ngarkesa maksimale për ngritje dhe bartje me dorë	
	djemtë	vajzat
17 – 18 vjeç	20 kg	15 kg
16 – 18 vjeç	15 kg	10 kg

¹ Vlera kufi e ngarkesës është pesha e çdo ngarkese të vetme e cila nuk duhet të tejkalohet në çfarëdo lloj rrethanash

5. Mbrojtja e shtatëzanave dhe lehonave: Limitet e vlerave maksimale të ngarkesave

Kufizimet e punësimit të lidhura me aktivitetet për gratë shtatzëna dhe ato që ushqejnë fëmijën me gji për ngritje të ngarkesës dhe detyra të bartjes janë si më poshtë:

5.1. Kufijtë maksimale të ngarkesës për ngritje dhe barjte:

- rregullisht (shpesh): 5 kg

-: 10 kg

5.2. Kufijtë e forcës maksimale të ngarkesës që shtyhet dhe ngarkohet

- rregullisht (shpesh): 8 kg

- herë pas here: 15 kg

6. Për të punësuarit me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit në fuqi, përpara se t'u ngarkohet punë krahu me ngarkesa, nevojitet rekomandimi nga mjeku i punës.

7. Masat organizative janë p.sh. ndarja e detyrave të punës për dy të punësuar, ose zëvendësimi i ngritjes duke i shtyrë apo tërhequr. Mjetet e përshtatshme (teknike) janë për shembull ndihma me ngritje mekanike, siç janë sistemet pneumatike për ngritje, vinça të vegjël, etj.

RREGULLORE (MPMS) NR.04/2016 - PËR KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURIMIN E SHENJAVE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore i përcakton kërkesat minimale për sigurimin e shenjave të sigurisë dhe shëndetit në punë.
2. Kjo Rregullore është në përputshmëri me Direktivën e Këshillit 92/58/EEC e 24 Qershorit 1992 mbi kërkesat minimale për dispozitat e sigurisë dhe shëndetin në punë për shenjat në vend të punës (direktiva e nëntë individuale brenda kuptimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391).

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore vlen për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që hyjnë në kuadër të fushëveprimit të Ligjit Nr. 04/L-161 për “Sigurinë dhe Shëndetin në punë”, pavarësisht nga forma e organizimit, lloji i pronësisë dhe arsyet për të cilat kryhet puna apo trajnimi në vendin e punës.
2. Kjo Rregullore nuk vlen për shenjat për plasimin në treg të substancave dhe përzierjeve, produkteve dhe pajisjeve të rrezikshme, të cilat rregullohen me aktet të tjera ligjore.
3. Kjo Rregullore nuk vlen për shenjat që përdoren për rregullimin e transportit rrugor, hekurudhor, ujqor të brendshëm, detar apo ajror.

Neni 3

Përkufizimet

1. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje:

1.1. **“shenjat e sigurisë dhe shëndetit në punë”** -nënkuptojnë shenjat që i referohen një objekti, aktiviteti apo situatë të veçantë dhe që ofrojnë informata dhe udhëzime për sigurinë dhe shëndetin në punë me anë të një tabele, ngjyre, shenje të ndriçuar, sinjali akustik, komunikimi verbal, sinjali me dorë dhe sipas rastit;

- 1.2. **“shenja e ndalimit”**- do të thotë shenjë që e ndalon sjelljen që ka të ngjarë të sjellë apo shkaktojë rrezik;
- 1.3. **“shenjë e rrezikut”**- nënkupton shenjë që paralajmëron rrezik;
- 1.4. **“shenjë e detyrimit”-nënkupton** shenjë që detyron një sjellje të caktuar;
- 1.5. **“shenjë e daljes emergjente apo ndihmës së parë”** - shenjë që jep informata për daljet emergjente apo objektet e ndihmës së parë dhe shpëtimit;
- 1.6. **“shenjë e informimit”**- ë ofron informata të tjera nga ato që janë përmendur në nënparagrafet nga (1.2) deri në (1.5);
- 1.7. **“Tabelë”**- nënkupton shenjë që ofron informata specifike me anë të një kombinimi të trajtave dhe ngjyrave gjeometrike ,simboli,piktogrami e cila bëhet e dukshme përmes ndriçimit të mjaftueshëm;
- 1.8. **“tabelë plotësuese”**- nënkupton tabelë që përdoret së bashku me njërin nga shenjat që janë përshkruar në nënparagrafin (1.7) dhe që ofron informata plotësuese;
- 1.9. **“ngjyrë e sigurisë”**- nënkupton ngjyrë së cilës i jepet një domethënie e caktuar;
- 1.10. **“simbol dhe piktogrami”**- nënkupton figurë që përshkruan një situatë specifike dhe e cila përdoret në tabelë apo në ndonjë sipërfaqe të ndriçuar;
- 1.11. **“shenjë e ndriçuar”**- nënkupton shenjë që prodhohet nga ndonjë pajisje që përbëhet nga materiale transparente dhe të tejdukshme që ndriçohen nga brenda apo nga ana e pasme në atë mënyrë që ta japin pamjen e një sipërfaqeje të ndriçuar;
- 1.12. **“sinjal akustik”**- nënkupton sinjal i koduar i zërit që lirohet dhe transmetohet nga ndonjë pajisje që është dizajnuar për atë qëllim, pa përdorimin e zërit të njeriut apo zërit artificial;
- 1.13. **“komunikim verbal”**- nënkupton mesazh në të folur i paracaktuar me anë të zërit të njeriut apo zërit artificial;
- 1.14. **“sinjal i dorës”** -është lëvizje apo pozitë e duarve, në formë të koduar, për t'i udhëzuar personat që kryejnë manovrime që mund të përbëjnë rrezik për punëtorët.

Neni 4

Detyrimet e punëdhënësit

1 Punëdhënësit duhet ti sigurojnë shenjat e sigurisë dhe shëndetit në punë në vendet dhe objektet e tyre të punës sipas kësaj Rregulloreje nëse rreziqet nuk mund të

evitohen apo pakësohen në mënyrë adekuate përmes teknikave për mbrojtje kolektive ose përmes masave, metodave dhe procedurave që përdoren në organizimin e punës.

2. Punëdhënësi do të kontrolloj që shenjat sipas paragrafit 1, të këtij Neni, janë të vendosura në vend.

3. Punëdhënësit marrin parasysh çdo vlerësim të rrezikut që bëhet sipas nenit 16 të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë.

4 Pa i paragjykuar dispozitat e shtojcës V, shenjat që përdoren për transportin rrugor, hekurudhor, ujor dhe ajror instalohen kudo që të jetë e përshtatshme për llojet e tilla të transportit, brenda ndërmarrjes dhe firmave.

Neni 5

Kërkesat për shenjat e sigurisë dhe shëndetit në punë

1. Shenjat e sigurisë dhe shëndetit në punë që përdoren në vendin e punës dhe në objektin e punëdhënësit duhet t'i plotësojnë kërkesat minimale që janë përcaktuar në shtojcat nga 1 deri në 9.

Neni 6

Informimi, trajnimi, konsultimet dhe pjesëmarrja e të punësuarve

1. Pa e përjashtuar nenin 18 të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, të punësuarve duhet t'u ofrohen dhe t'u vihen në dispozicion informata adekuate për të gjitha masat që duhet të merren sa u përket shenjave të sigurisë dhe shëndetit.

2. Punëdhënësi i informon të punësuarit ti në formë të udhëzimeve, për shenjat e sigurisë dhe shëndetit që përdoren në punë.

3. Punëdhënësi është i obliguar që t'i jap udhëzimet që janë përmendur në nënparagrafin e parë dhe që e mbulojnë domethënien e shenjave, veçanërisht shenjave që përmbajnë fjalë, si dhe sjelljen e përgjithshme dhe specifike që duhet pasur.

4. Konsultimi dhe pjesëmarrja e të punësuarve punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre referohet dispozitës së nenit 19 të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, për çështjet që janë mbuluar nga kjo Rregullore, duke përfshirë shtojcat nga 1 deri në 9.

Neni 7

Shtojca e Rregullores

Shtojcat nga 1 deri në 9 janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje

- 1.1.Shtojca 1: “Kërkesat minimale të përgjithshme përkitazi me shenjat e sigurisë dhe shëndetit në punë”.
- 1.2. Shtojca 2: “Kërkesat e përgjithshme minimale përkitazi me tabelat “.
- 1.3. Shtojca 3: “Kërkesat minimale që i rregullojnë shenjat në kontejnerë dhe gypa”.
- 1.4. Shtojca 4: “Kërkesat minimale për identifikimin dhe lokalizimin e pajisjeve kundër zjarrit”.
- 1.5.Shtojca 5:“Kërkesat minimale që i rregullojnë shenjat që përdoren për pengesat dhe lokacionet e rrezikshme dhe për shënjimin e rrugëve të trafikut”.
- 1.6. Shtojca 6: “Kërkesat minimale për shenjat e ndriçuara” .
- 1.7. Shtojca 7: “Kërkesat minimale për shenjat akustike”.
- 1.8. Shtojca 8 :” Kërkesat minimale për komunikimin verbal” .
- 1.9. Shtojca 9: “Kërkesat minimale për sinjalet e dorës “.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

SHTOJCA I

KËRKESAT MINIMALE TË PËRGJITHSHME PËRKITAZI ME SHENJAT E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

1. Vërejtjet paraprake

1.1. Kjo shtojcë i paraqet ato kërkesa, i shpjegon mënyrat e ndryshme të përdorimit të shenjave të sigurisë dhe shëndetit dhe i jep rregullat e përgjithshme për ndërkëmbimin dhe kombinimin e shenjave.

1.2. Shenjat e sigurisë dhe shëndetit duhet të përdoren vetëm për ta bartur mesazhin apo informatën që është saktësuar në këtë Rregullore.

2. Llojet e shenjave

2.1. Shenjat e përhershme

2.1.1. Tabelat përhershme duhet të përdoren për shenjat e ndalimit, rrezikut dhe detyrimit, vendndodhjes dhe identifikimit të rrugëve të daljes emergjente dhe objekteve të ndihmës së parë.

2.1.2. Vendndodhja dhe identifikimi i pajisjeve pëer fikjen e zjarrit, duhet të shënohet në mënyrë të përhershme me tabela dhe ngjyrën e kuqe.

2.1.3. Tabelat në kontejnerë dhe gypa duhet të vendosen siç është përcaktuar në shtojcën 3.

2.1.4. Vendet ku ekziston rreziku i përplasjes me objekte apo i rrëzimit duhet të shënohen në mënyrë përhershme me njërin nga ngjyrat e sigurisë dhe me tabela.

2.1.5. Rrugët e trafikut duhet të shënohen në mënyrë përhershme me njëriën nga ngjyrën e sigurisë.

2.2. Shenjat e rastit (e përkohshme)

2.2.1. Shenjat e ndriçimit, sinjalet akustike, komunikimi verbal duhet të përdoren kurdo që e kërkon rasti (situata), duke i marrë parasysh mundësitë e ndërkëmbimit dhe kombinimit të shenjave që janë paraqitur në pjesën 3 të kësaj shtojce, për ta sinjalizuar rrezikun, për t'i bërë thirrje, lajmërim personave që të ndërëmarrin veprime të caktuara dhe për evakuimin emergjent të personave.

2.2.2. Sinjalet e dorës dhe/ose komunikimi verbal duhet të përdoren kurdo që e kërkon rasti (situata), për t'i udhëzuar personat që kryejnë veprime të rrezikshme.

3. Ndërkëmbimi dhe kombinimi i shenjave

3.1. Cilido nga kombinimet në vijim mund të përdoret nëse është njëjtë efektiv:

ndonjë ngjyrë e sigurisë ose tabelë për t'i shënuar vendet ku ka ndonjë pengesë ose ndonjë rënie, shenjat e ndriçimit, sinjalet akustike ose komunikimi verbal, sinjalet e dorës ose komunikimi verbal.

3.2. Disa lloje të shenjave mund të përdoren së bashku: shenjat e ndriçimit dhe sinjalet akustike, shenjat e ndriçimit dhe komunikimi verbal, sinjalet e dorës dhe komunikimi verbal.

4. Udhëzimet në tabelën e mëposhtme zbatohen për të gjitha shenjat që e përdorin ndonjë ngjyrë të sigurisë:

Ngjyra	Domethënia dhe qëllimi	Udhëzimet dhe informacioni
E kuqe	Shenjë e ndalimit	Sjellje e rrezikshme
	Alarm rreziku	Ndalo! Fik! Pajisje për ndërprerje automatike! Evakuo!
	Pajisje për fikjen e zjarrit	Identifikimi dhe lokacioni
E verdhë	Shenjë e paralajmërimit	Ke kujdes! Merr masa paraprake! Kontrolllo!
E kaltër	Shenjë e detyrimit	Sjellje apo veprim specifik; Mbani veshur pajisjet mbrojtëse personale!
E gjelbërt	Ikje emergjente; shenjë e ndihmës së parë	Dyert, daljet, rrugët, pajisjet, objektet
	Nuk ka rrezik	Kthim në normale

4. The instructions in the table below apply to all signs incorporating a safety colour:

Colour	Meaning or purpose	Instructions and information
Red	Prohibition sign	Dangerous behaviour
	Danger alarm	Stop, shutdown, emergency cutout devices, Evacuate
	Fire-fighting equipment	Identification and location
Yellow	Warning sign	Be careful, take precautions, Examine
Blue	Mandatory sign	Specific behaviour or action; wear personal protective equipment
Green	Emergency escape; first aid sign	Doors, exits, routes, equipment, facilities
	No danger	Return to normal

4. Uputstva iz dole prikazane tabele odnose se na svaki znak koji sadrži sigurnosnu boju:

Boja	Značenje ili svrha	Uputstva i informacije
Crvena	Znak zabrane	Opasno ponašanje
	Uzbuna zbog opasnosti	Zaustavljanje, gašenje, sprave za hitno sečenje, evakuacija
	Protivpožarna oprema	Identifikacija i lokacija
Žuta	Znak upozorenja	Budi pažljiv, budi obazriv, ispitaj
Plava	Znak obaveze	Određeno ponašanje ili radnja; nošenje lične zaštitne opreme
Zelena	Evakuacioni izlaz; znak prve pomoći	Vrata, izlazi, pravci kretanja, oprema, službe
	Nema opasnosti	Povratak u normalno stanje

5. Në efektivitetin e një shenje nuk duhet të ndikohet negativisht përmes:

5.1. pranisë së një burimi tjetër të emetimit të llojit të njëjtë që e pengon dukshmërinë ose dëgjueshmërinë; prandaj në veçanti ;

5.1.1. duhet të evitohet vendosja e shumë shenjave shumë afër njëra tjetrës;

5.1.2. dy shenja të ndriçimit që mund të ngatërrohen nuk duhet të përdoren në të njëjtën kohë;

5.1.3. shenja e ndriçimit nuk duhet të përdoret afër një burimi tjetër të ngjashëm të ndriçimit;

5.1.4. dy sinjale akustike nuk duhet të përdoren në të njëjtën kohë si dhe;

5.1.5. një sinjal akustik nuk duhet të përdoret nëse ka shumë zhurmë në ambient

5.2. dizajnit të dobët të saj , numrit të pamjaftueshëm të shenjave , pozicionimit jo të drejtë të tyre, gjendjës së dobët të riparimit të shenjave ose informatave të pasakta dhe mjeteve tjera të sinjalizimit.

6. Varësisht nga kërkesat, shenjat dhe mjetet e sinjalizimit duhet të pastrohen, mirëmbahen, kontrollohen, riparohen dhe, nëse ka nevojë, të zëvendësohen (ndërrohen) rregullisht për tu siguruar se i ruajnë cilësitë e tyre të vendosjes dhe funksionalitetin .

7. Numri dhe pozicionimi i shenjave ose mjeteve të sinjalizimit për t'u instaluar do të varet nga shkalla e rreziqeve ose zona që duhet të mbulohet.

8. Shenjat që kërkojnë një lloj energjie duhet të sigurohen me një furnizim të garantuar emergjent në rast të ndonjë ndërprerjeje të rrymës. Këto shenja nuk kërkojnë burim tjetër të energjisë nëse rreziku është eliminuar pas ndaljes së rrymës.

9. Ndezja e shenjës së ndriçimit dhe/ose sinjalit akustik tregon se kur duhet të fillojë veprimi i kërkuar për evitimin e rrezikut. Shenja apo sinjali duhet të aktivizohet për aq kohë sa kërkon veprimi i evitimit të rrezikut, dhe duhet të jetë në gjendje riaktivizohet menjëherë pas paraqitjes së problemit .

10. Shenjat e ndriçimit dhe sinjalet akustike duhet të kontrollohen për tu siguruar se funksionojnë në mënyrë korrekte dhe se janë efektive para se të vihen në shërbim e pastaj në intervale kohore mjaft të shpeshta.

11. Nëse pengohet dëgjimi apo pamja e punëtorëve në fjalë, përfshirë pengimin që shkaktohet nga mbajtja e pajisjeve mbrojtëse personale, duhet të merren masa për t'i plotësuar ose zëvendësuar shenjat përkatëse.

12. Zonat, hapësirat ose vendet e rrethuara që përdoren për magazinimin e sasive të konsiderueshme të substancave ose përzierjeve të rrezikshme duhet të tregohen përmes një shenje paralajmëruese të përshtatshme nga pjesa 3.2 e shtojcës II ose të shënjohe siç është paraparë në pjesën 1 të shtojcës III, përveç nëse etiketimi i pakove apo kontejnerëve individualë është adekuat për këtë qëllim.

SHTOJCA II

KËRKESAT E PËRGJITHSHME MINIMALE PËRKITAZI ME TABELAT

1. Veçoritë themelore

1.1. Forma dhe ngjyrat e tabelave janë përcaktuar në pjesën 3, sipas objektit specifik të tyre (tabelat që tregojnë ndonjë ndalesë, paralajmërim, veprim të detyrueshëm, rrugëdalje, pajisje emergjente apo për fikjen e zjarrit).

1.2. Simbolet dhe piktogramet duhet të jenë sa më të thjeshta që të jetë e mundur dhe duhet t'i përmbajnë vetëm të dhënat esenciale. Piktogramet e përdorura duhet të jenë pak më të ndryshme ose më të detajuara se ata që janë paraqitur në pjesën 3, me kusht që ta kenë domethënien e njëjtë dhe që asnjë dallim apo përshtatje të mos e mjegullojë domethënien e tyre.

1.3. Tabelat duhet të jenë të bëra nga materiali që është rezistent ndaj dëmtimeve dhe kushteve klimatike dhe që është i përshtatshëm për mjedisin.

1.4. Dimensionet, veçoritë e ngjyrave, dhe simbolet në tabelat duhet të jenë të tilla që të mund të shihen dhe të kuptohen lehtë.

2. Kushtet e përdorimit

2.1. Tabelat duhet të instalohen në parim në një lartësi të përshtatshme dhe në një pozitë që i përshtatet vijës së pamjes, duke marrë parasysh çfarëdo pengese, qoftë te pika e qasjes në ndonjë zonë në rast të ndonjë rreziku të përgjithshëm, apo në afërsi të ndonjë rreziku apo objekti të veçantë dhe në ndonjë lokacion të ndriçuar mirë dhe lehtësisht të qasshëm. Nëse niveli i dritës natyrale është i ulët, duhet të përdoren ngjyrat fosforeshente, materialet reflektuese ose ndriçimi artificial.

2.2. Tabela duhet të hiqet kur situata së cilës i referohet pushon së ekzistuari.

3. Tabelat që duhet të përdoren

3.1. Shenjat e ndalimit

Veçoritë e brendshme:

forma e rumbullakët,

piktogrami i zi në sfond të bardhë, shiriti i kuq dhe vija diagonale (pjesa e kuqe duhet të përfshijë së paku 35 % të sipërfaqes së shenjës).



















<p>Shenja që duhet të përdoret</p>  <p>Ndalohet pirja e duhanit</p>	 <p>Ndalohet pirja e duhanit dhe përdorimi i flakës së hapur</p>
 <p>Ndalohet qasja për këmbësorë</p>	 <p>Mos e shuaj me ujë</p>
 <p>I papijshëm</p>	 <p>Ndalja qasja për të paautorizuar</p>
 <p>Ndalohet qasja për automjete industriale</p>	 <p>Mos prek</p>

3.2. Shenjat e paralajmërimit

Veçoritë e brendshme:

forma trekëndëshe

piktogrami i zi në sfond të verdhë me shirit të zi (pjesa e verdhë duhet të përfshijë së paku 50 % të sipërfaqes së shenjës).

  <p>Material e ndezshëm ose temperaturë e lartë</p> <p>Material shpërthyes</p>	  <p>Material toksik</p> <p>Material korroziv</p>
  <p>Material radioaktiv</p> <p>Ngarkesë mbi kokë</p>	  <p>Automjete industriale</p> <p>Rrezik: Elektricitet</p>
  <p>Rrezik i përgjithshëm</p> <p>Rreze laserike</p>	  <p>Material oksidues</p> <p>Rrezitim jojonizues</p>
  <p>Fushë magnetike e fuqishme</p> <p>Pengesa</p>	  <p>Rënie</p> <p>Rrezik biologjik</p>
  <p>Temperaturë e ulët</p>	

3.3. Shenjat e detyrimit

Veçoritë e brendshme:

trajta e rrumbullakët

piktogrami i bardhë në sfond të kaltër (pjesa e kaltër duhet të përfshijë së paku 50 % të sipërfaqes së shenjës).








  <p>Duhet të mbahen pajisje për mbrojtjen e syve Duhet të mbahen helmata e sigurisë</p>	  <p>Duhet të mbahen pajisje për mbrojtjen e veshëve Duhet të mbahen pajisje për frymëmarrje</p>
  <p>Duhet të mbahen çizmet e sigurisë Duhet të mbahen dorëzat e sigurisë</p>	  <p>Duhet të mbahen kominoshet e sigurisë Duhet të mbahen pajisje për mbrojtjen e fytyrës</p>
  <p>Duhet të mbahen rripat e sigurisë Këmbësorët duhet ta përdorin këtë rrugë</p>	 <p>Shenjë e detyrimit të përgjithshëm (për tu shoqëruar me ndonjë shenjë tjetër sipas nevojës)</p>

3.4. Shenjat e daljes emergjente ose ndihmës së parë

Veçoritë e brendshme:

forma drejtkëndëshe ose katrore

piktogrami i bardhë në sfond të gjelbër (pjesa e gjelbër duhet të përfshijë së paku 50 % të sipërfaqes së shenjës).

 <p>Dalja emergjente/rrugëdalja</p>	 <p>Këtej (shenjë informuese plotësuese)</p>  <p>Kuti e ndihmës së parë</p>  <p>Lesë</p>
 <p>Dush i sigurisë për sy</p>  <p>Pastrues</p>	 <p>Telefon emergjent për ndihmë të parë ose shpëtim</p>









3.5. Shenjat kundër zjarrit

Shenjat për fikjen e zjarrit ofrojnë informata për pajisjet për fikjen e zjarrit

Veçoritë e brendshme:

-forma drejtkëndëshe ose këndore

-piktogrami i bardhë në sfond të kuq (pjesa e kuqe duhet të përfshijë së paku 50 % të sipërfaqes së shenjës).

			
Tub zjarri	Shkallë		
			
Fikës i zjarrit	Telefon emergjent për zjarr		
			
Këtej (shenjë informuese plotësuese)			

SHTOJCA III

KËRKESAT MINIMALE QË I RREGULLOJNË SHENJAT NË KONTEJNERË DHE GYPA

1. Kontejnerët që përdoren në punë për substancat ose përzierjet kimike që janë klasifikuar si të rrezikshme dhe kontejnerët që përdoren për magazinimin e substancave ose përzierjet të tilla të rrezikshme, së bashku me gypat e dukshëm që përmbajnë ose transportojnë substanca dhe përzierje të tilla të rrezikshme duhet të etiketohen me piktograme përkatëse të rrezikut sipas një rregulloreje specifike (CLP-GHS)*

Kjo kërkesë nuk vlen për kontejnerët që përdoren në punë për periudha të shkurtra e as për kontejnerët përmbajtja e të cilëve ndërron shpesh, me kusht që të merren masa alternative adekuate, në veçanti për informim dhe/ose trajnim, që e garantojnë shkallën e njëjtë të mbrojtjes.

Etiketat që janë përmendur në paragrafin e parë mund:

të zëvendësohen me shenjat që janë paraqitur në shtojcën 2, duke i përdorur piktogramet ose simbolet e njëjta. Nëse nuk ka asnjë shenjë paralajmërimi ekuivalente në shtojcën 2, duhet të përdoret piktogrami relevant i rrezikut nga rregullorja specifike, të plotësohen me informata shtesë, siç është emri dhe/ose formula e substancës ose përzierjes së rrezikshme dhe të dhënat për rrezikun, për transportimin e kontejnerëve në vendin e punës, duke u plotësuar ose zëvendësuar me shenjat që zbatohen për transportin e substancave ose përzierjeve të rrezikshme.

2. Shenjat duhet të montohen si vijon:

2.1. në anën (ët) e dukshme,

2.2. në formë të palakueshme, vetëngjithëse ose të ngjyrosura.

3. Sipas nevojës, shenjat që janë përmendur në pjesën 1 të kësaj shtojce duhet t'i kenë veçoritë e brendshme që janë përkufizuar në pjesën 1.4. të shtojcës II dhe t'i plotësojnë kushtet e përdorimit për tabelat që janë përcaktuar në pjesën 2 të shtojcës 2.

4. Në përputhje me pjesët 1,2 dhe 3, etiketat që përdoren në gypa duhet të vendosen në ndonjë vend të dukshëm në afërsi të pikave më të rrezikshme, siç janë valvulet dhe kyçet, dhe atë në intervale të arsyeshme.

5. Zonat, hapësirat ose vendet e rrethuara që përdoren për magazinimin e sasive të konsiderueshme të substancave ose përzierjeve të rrezikshme duhet të tregohen me një shenjë të përshtatshme të paralajmërimit të marrë nga pjesa 3.2 e shtojcës 2, ose të shënjojnë siç është paraparë në pjesën 1 të shtojcës 3, përveç nëse etiketimi i pakove ose kontejnerëve individualë është adekuat për këtë qëllim, duke e marrë

parasysh shtojcën 2, pikën 1.5, sa u përket dimensioneve. Magazinat e një numri të substancave ose përzierjeve të rrezikshme mund të tregohen përmes shenjës së paralajmërimit për rrezikun e përgjithshëm. Shenjat ose etiketat që janë përmendur më lart duhet të vendosen, sipas nevojës, afër zonës së magazinimit ose në derën që çon te dhoma e magazinimit.

SHTOJCA IV

KËRKESAT MINIMALE PËR IDENTIFIKIMIN DHE LOKALIZIMIN E PAJISJEVE KUNDËR ZJARRIT

1. Vërejtje paraprake

Kjo shtojcë vlen për pajisjet që përdoren përjashtimisht me qëllim të fikjes së zjarrit.

2. Pajisjet për fikjen e zjarrit duhet të identifikohen duke e përdorur një ngjyrë specifike për pajisje dhe duke e vendosur një tabelë të lokacionit dhe/ose duke e përdorur një ngjyrë specifike për vendet ku mbahen pajisjet e tilla ose pikat e qasjes së tyre.

3. Ngjyra për identifikimin e këtyre pajisjeve është ngjyra e kuqe. Sipërfaqja e kuqe duhet të jetë mjaft e madhe për ta mundësuar identifikimin e lehtë të pajisjeve.

4. Tabelat që janë paraqitur në pjesën 3.5 të Shtojcës II duhet të përdoren për t'i shënuar lokacionet e këtyre pajisjeve.

SHTOJCA V

KËRKESAT MINIMALE QË I RREGULLOJNË SHENJAT QË PËRDOREN PËR PENGESAT DHE LOKACIONET E RREZIKSHME DHE PËR SHËNJIMIN E RRUGËVE TË TRAFIKUT

1. Shenjat për pengesat dhe lokacionet e rrezikshme

1.1. Vendet ku ekziston rreziku nga përplasja me pengesa, apo nga rënia a objektet rënëse duhet të shënjohen me ngjyrë të verdhë dhe të zezë njëra pas tjetrës, ose me shirita të kuq dhe të bardhë në zonat e ndërtuara në ndërmarrjen e të cilave punëtorët kanë qasje gjatë punës së tyre.

1.2. Dimensionet e shenjave duhet të jenë në përpjesëtim me madhësinë e pengesës ose të lokacionit të rrezikshëm në fjalë.

1.3. Shiritat e verdhë dhe të zi ose të kuq e të bardhë duhet të jenë në një kënd prej përafërsisht 45° dhe të një madhësie pak a shumë të barabartë.

1.4. Shembull:



2. Shënjimi i rrugëve të trafikut

2.1. Kur kjo kërkohet për përdorimin dhe pajisjen e hapësirave dhe për mbrojtjen e punëtorëve, rregullat e trafikut për automjete duhet të identifikohen qartë përmes shiritave të vazhdueshëm në një ngjyrë që mund të shihet qartë, preferohet të bardhë ose të verdhë, duke e marrë parasysh ngjyrën e tokës.

2.2. Shiritat duhet të vendosen ashtu që ta tregojnë distancën e nevojshme të sigurtë midis automjeteve dhe cilitdo objekt që mund të jetë në afërsi si dhe midis këmbësorëve dhe automjeteve.

2.3. Rrugët e trafikut të përhershëm në zonat e ndërtuara duhet të shënjohen në mënyrë të ngjashme, për aq sa është e mundur, përveç nëse sigurohen me pengesa të përshtatshme ose trotuare.

SHTOJCA VI

KËRKESAT MINIMALE PËR SHENJAT E NDRIÇUARA

1. Veçoritë e brendshme (kryesore)

1.1. Drita që emetohet nga një shenjë duhet ta prodhojë një kontrast ndriçues që është i përshtatshëm për mjedisin e tij, sipas kushteve të synuara për përdorimin e asaj shenje, por pa prodhuar shkëlqim me sasi të tepërt të dritës ose dukshmëri të ulët si rezultat i dritës së pamjaftueshme.

1.2. Sipërfaqja ndriçuese që e emiton një shenjë mund ta ketë një ngjyrë të vetme ose ta përmbajë një piktogram në një sfond të caktuar.

1.3. Ngjyra e vetme duhet t'i përshtatet tabelës së ngjyrave dhe domethënive të tyre që janë paraqitur në pjesën 4 të shtojcës 1.

1.4. Po ashtu, nëse shenja përmban një piktogram, ky i fundit duhet të jetë në përputhje me të gjitha rregullat relevante që janë paraqitur në shtojcën 2.

2. Rregullat specifike që e rregullojnë përdorimin

2.1. Nëse një pajisje mund të emitojë shenja të vazhdueshme dhe me ndërprerje, shenja me ndërprerje duhet të përdoret për ta treguar një shkallë më të lartë të rrezikut ose ndonjë nevojë më urgjente për ndërhyrjen apo veprimin e kërkuar/imponuar se sa që është treguar në shenjën e vazhdueshme.

Kohëzgjatja e secilës shkreptimë dhe shpeshtësia e shkreptimave të një shenje të ndriçuar me ndërprerje duhet të jetë e tillë që ta sigurojë perceptimin e drejtë të mesazhit, dhe ta evitojë ngatërrimin qoftë midis shenjave të ndryshme të ndriçuara, qoftë me ndonjë shenjë të ndriçuar të vazhdueshme.

2.2. Nëse një shenjë flakëruese përdoret në vend të një sinjali akustik ose së bashku me të duhet të përdoren kodet e njëjta.

2.3. Pajisjet për emetimin e shenjave flakëruese në rast të rrezikut të madh duhet të jenë nën mbikëqyrje të veçantë dhe të përshtatura me një llambë ndihmëse.

SHTOJCËN VII

KËRKESAT MINIMALE PËR SHENJAT AKUSTIKE

1. Veçoritë e brendshme

1.1. Sinjalet akustike duhet:

1.1.1. ta kenë një nivel të tingullit që është në shkallë të konsiderueshme më i lartë se niveli i zhurmës së ambientit, në mënyrë që të mund të dëgjohen pa qenë të tepërta ose të dhimbshme;

1.1.2. të mund të dallohen lehtë, veçanërisht sa i përket kohëzgjatjes së pulsit or grupeve të pulseve, dhe të mund të dallohen qartë nga çdo sinjal akustik dhe zhurmë tjetër e ambientit.

1.2. Nëse një pajisje mund të emetojë sinjal akustik në shpeshtësi të ndryshme dhe konstante, shpeshtësia variabile duhet të përdoret për ta treguar një nivel më të lartë të rrezikut ose një nevojë më urgjente se sa ndërhyrja ose veprimi i kërkuar/imponuar në lidhje me shpeshtësinë stabile.

2. Kodi

Sinjali i evakuimit duhet të jetë i vazhdueshëm.

SHTOJCA VIII

KËRKESAT MINIMALE PËR KOMUNIKIMIN VERBAL

1. Veçoritë e brendshme

1.1 Komunikimi verbal është mesazh i folur që komunikohet nga një zë i njeriut apo zë artificial dhe që përmban fjalë të paracaktuara.

1.2. Komunikimi verbal midis një folësi ose emetuesi dhe një apo më shumë dëgjuesve duhet ta marrë formën (nganjëherë të koduar) e teksteve të shkurtra, frazave, grupeve të fjalëve dhe/ose fjalëve individuale.

1.3. Mesazhet e folura duhet të jenë sa më të shkurtra, të thjeshta dhe të qarta që të jetë e mundur; shkathësitë verbale të folësit dhe aftësitë dëgjuese të dëgjuesit (ve) duhet të jenë të tilla që ta sigurojnë komunikimin verbal të besueshëm.

1.4. Komunikimi verbal është:

direkt – me anë të zërit të njeriut) ose

indirekt - me anë të zërit të njeriut ose zërit artificial që transmetohet me çfarëdo mjeti që është i përshtatshëm.

2. Rregullat e veçanta që e rregullojnë përdorimin

2.1. Personat e përfshirë duhet të kenë njohuri të mira për gjuhën që përdoret në mënyrë që të mund ta shqiptojnë dhe kuptojnë drejt mesazhin e folur dhe që pastaj të sillen në një mënyrë që është e përshtatshme për shëndetin dhe sigurinë.

2.2. Nëse komunikimi verbal përdoret në vend ose së bashku me gjestet, duhet të përdoren fjalë të koduara siç janë:

2.2.1.fillo , për ta treguar fillimin e komandës,

2.2.2.ndal, për ta ndërprerë ose përfunduar një lëvizje,

2.2.3.përfundo, për ta ndalur operacionin,

2.2.4.ngrit, për ta ngritur një ngarkesë,

2.2.5.ul , për ta ulur një ngarkesë,

2.2.6.përpara ,

2.2.7.prapa , të bashkërendohen medjathtas sinjalet përkatëse të dorës,

2.2.8.majtas,

2.2.9.rrezik, për ndalje emergjente,

2.2.10.shpejt, për ta përshpejtuar lëvizjen për shkaqe sigurie.

SHTOJCA IX

KËRKESAT MINIMALE PËR SINJALET E DORËS

1. Veçoritë

Sinjalet e dorës duhet të jenë të sakta, të thjeshta, të zgjerueshme, të lehta për tu dhënë dhe për tu kuptuar dhe të dallueshme qartë nga sinjalet e tilla të tjera.

Kur të dyja duart përdoren në të njëjtën kohë, ato duhet të lëvizin në mënyrë simetrike dhe për ta dhënë vetëm shenjë e njëjtë.

Me kusht që t'i plotësojnë kushtet që janë dhënë më lart, sinjalet e përdorura duhet të dallojnë pak nga ato që janë treguar në pjesën 3 apo të jenë më detajuara se to. Megjithatë, ato duhet të jenë njëjtë domethënëse dhe të kuptueshme.

2. Rregullat e veçanta që e rregullojnë përdorimin

2.1. Personi që i jep shenjat, që këtu e tutje do të quhet 'sinjalizuesi', do t'i përdorë lëvizjet e kraharorit/duarve për tu dhënë udhëzime manovrimi personave që i marrin shenjat, e që këtu e tutje do të quhen 'operatorë'.

2.2. Sinjalizuesi duhet të jetë në gjendje t'i monitorojë të gjitha manovrat me sy pa qenë i rrezikuar nga to.

2.3. Detyrat e sinjalizuesit duhet të konsistojnë vetëm në udhëzimin e manovrave dhe në garantimin e sigurisë së punëtorëve në afërsi.

2.4. Nëse nuk plotësohen kushtet që janë përshkruar në pikën 2.2, duhet të dislokohen një apo më shumë sinjalizues.




2.5. Operatori duhet ta ndërpresë manovrën e vazhdueshme për të kërkuar udhëzime të reja kur nuk është në gjendje t'i zbatojë urdhrat që i ka marrë me garancitë e nevojshme të sigurisë.




2.6. Aksesorët: Operatori duhet të jetë në gjendje ta njohë sinjalizuesin pa vështirësi. Sinjalizuesi duhet të mbajë një apo më shumë sende dalluese të përshtatshme, p.sh. ndonjë xhaketë, helmetë, shirita të mëngëve ose të dorës ose të bartë shkopinj. Sendet dalluese duhet të kenë ngjyra të ndritshme; preferohet që të gjitha ta kenë ngjyrën e njëjtë dhe të përdoren vetëm nga sinjalizuesi.


3. Sinjalet e koduara që duhet të përdoren





Vërejtje paraprake:


Tërësia e sinjaleve të koduara në vijim nuk i paragjykon kodet e tjera që përdoren në nivel të komunitetit dhe që përdoren për manovrimet e njëjta në disa sektorë:

Domethënia	Përshkrimi	Ilustrimi
A. Sinjalet e përgjithshme		
FILLO Vëmendje Fillim i komandës	të dyja duart zgjaten horizontalisht me shuplakat e duarve të kthyer përpara	
NDALO Ndërprerje Përfundim i lëvizjes	dora e djathtë ngritët përpjetë me pëllëmbë të kthyer përpara	
PËRFUNDO operacionin	dora e djathtë ulet teposhtë me pëllëmbë të kthyer përpara	

B. Lëvizjet vertikale		
NGRIT	dora e djathtë ngritet përpjetë me pëllëmbë të kthyer përpara dhe e bën një rreth ngadalë	
UL	dora e djathtë ulet teposhtë me pëllëmbë të kthyer kah brendia dhe e bën një rreth ngadalë	
DISTANCË VERTIKALE	duart tregojnë distancën përkatëse	

C. Lëvizjet horizontale		
LËVIZ PËRPARA	të dyja duart ulen teposhtë me pëllëmbë të kthyer para, ndërsa parakrahët bëjnë lëvizje të ngadalshme drejt trupit	

<p>LËVIZ PRAPA</p>	<p>të dyja duart ulen teposhtë më pëllëmbë të kthyer teposhtë, ndërsa parakrahët bëjnë lëvizje të ngadalta larg trupit</p>	
<p>NË TË DJATHTË të sinjalizuesit</p>	<p>dora e djathtë zgjatet pak a shumë horizontalisht me pëllëmbë të kthyer teposhtë dhe ngadalë bën lëvizje të vogla në të djathtë</p>	
<p>NË TË MAJTË TË sinjalizuesit</p>	<p>dora e majtë zgjatet pak a shumë horizontalisht me pëllëmbë të kthyer teposhtë dhe ngadalë bën lëvizje të vogla në të majtë</p>	
<p>DISTANCA HORIZONTALE</p>	<p>duart tregojnë distancën përkatëse</p>	

D. Rreziku		
<p>RREZIK</p> <p>Ndalje emergjente</p>	<p>të dyja duart ngriten lart me pëllëmbë të kthyer përpara</p>	
<p>SHPEJT</p>	<p>të gjitha lëvizjet më shpejtë</p>	
<p>NGADALË</p>	<p>të gjitha lëvizjet më ngadalë</p>	

RREGULLORE (MPMS) Nr.05/2016 - PËR KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË TË PUNËMARRËSVE NË RISK NGA AMBIENTET SHPËRTHYESE

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në ambiente shpërthyes.
2. Kjo rregullore është në përputhshmëri me Direktivën 1999/92/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 16 dhjetorit 1999, mbi kërkesat minimale për përmirësimin e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së punonjësve ndaj rrezikut të mundshëm nga ambientet shpërthyes (Direktiva e 15të individuale, brenda kuptimit të Nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC)

Neni 2

Fushveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që janë brenda fushës së veprimit të ligjit nr. 04/L-161, datë 16.5.2013 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojit të ndërmarrjes dhe arsyeve për të cilat zhvillohet puna apo trajnimi në vendin e punës.
2. Kjo Rregullore nuk zbatohet për:
 - 2.1. zonat që shërbejnë drejtpërdrejt për trajtimin mjekësor të pacientëve;
 - 2.2. përdorimin e pajisjeve që punojnë me lëndë djegëse të gazta;
 - 2.3. prodhimin, trajtimin, përdorimin, magazinimin dhe transportimin e eksplozivëve ose substancave kimike të paqëndrueshme;
 - 2.4. industrinë e nxjerrjes së mineraleve;
 - 2.5. mjetet e transportit tokësor, ujor dhe ajror, përdorimi i të cilave rregullohet me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, me përjashtim të mjeteve të transportit të synuara për përdorim në ambientet shpërthyes
3. Dispozitat e legjislacionit përkatës të shëndetit dhe sigurisë janë plotësisht të zbatueshme në të gjithë fushën e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, përveç rasteve kur ka një dispozitë më specifike në këtë rregullore.

Neni 3

Përkufizime

1. Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

1.1. "**Ambient shpërthyes**" është çdo përzierje me ajrin, nën kushtet atmosferike, të substancave të ndezshme në formën e gazrave, avujve, aerosoleve ose pluhurave në të cilat, pasi ka ndodhur ndezja, djegia përhapet në të gjithë përzierjen e padjegur.

1.2. "**Substancë e ndezshme**" apo e djegshme konsiderohen materialet të cilat mund të krijojnë një mjedis shpërthyes, përveç nëse një hulumtim i karakteristikave të tyre ka treguar se gjatë përzierjes me ajrin ato nuk janë në gjendje që në mënyrë të pavarur të shkaktojnë shpërthimin.

1.3. "**Shpërthimi**" është një reaksion i papritur oksidimi ose zbrërthimi, që prodhon rritje të temperaturës ose të presionit, ose të dyja në të njëjtën kohë.

1.4. "**Proces pune normal**" është situata kur instalimet përdoren brenda parametrave të projektimit të tyre.

Neni 4

Parandalimi i shpërthimeve dhe mbrojtja ndaj tyre

1. Punëdhënësi siguron parandalimin dhe mbrojtjen nga shpërthimet, duke marrë masa teknike dhe organizative të përshtatshme me natyrën e procesit të punës, në përputhje me parimet bazë të mëposhtme të renditura sipas përparësisë:

1.1. të parandalojë krijimin e ambeinteve shpërthyes, ose ku natyra e veprimtarisë nuk e lejon këtë;

1.2. të shmangë ndezjen e ambienteve shpërthyes, dhe

1.3. të zvogëlojë efektet negative të një shpërthimi në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e punëmarrësve dhe personave të tjerë.

2. Kur është e nevojshme, masat e parandalimit dhe të mbrojtjes sipas paragrafit 1 të këtij neni kombinohen dhe plotësohen me masa të tjera kundër përhapjes së shpërthimeve.

3. Punëdhënësi rishikon rregullisht masat parandaluese dhe mbrojtëse të përcaktuara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, në periudhat e përcaktuara nga vetë ai, dhe sa herë që ndodhin ndryshime të rëndësishme.

Neni 5

Vlerësimi i risqeve të shpërthimit

1. Punëdhënësi vlerëson çdo risk që krijohet nga ambientet shpërthyes, duke marrë parasysh të paktën:

- 1.1. mundësinë e krijimit të ambienteve shpërthyes dhe qëndrueshmërinë e tyre;
- 1.2. mundësinë që burimet e ndezjes, përfshirë shkarkimet elektrostатike, të jenë të pranishme dhe të bëhen aktive dhe efektive;
- 1.3. instalimet, substancat e përdorura, proceset dhe ndërveprimet e tyre të mundshme;
- 1.4. shkallën e pasojave të parashikuara.

2. Risqet e shpërthimit vlerësohen në tërësi, duke marrë parasysh të gjitha aspektet e punës.

3. Në vlerësimin e risqeve të shpërthimit merren parasysh hapësirat që janë të lidhura ose mund të lidhen me vendet ku mund të krijohen ambiente shpërthyes.

Neni 6

Klasifikimi i vendeve ku mund të krijohen ambiente shpërthyes

1. Punëdhënësi, për të garantuar sigurinë dhe shëndetin e të punësuarëve dhe të personave të tjerë në vendet e punës ku mund të krijohen ambiente shpërthyes, merr masat e nevojshme në mënyrë që:

- 1.1. të klasifikojë vendet ku mund të krijohen ambientet shpërthyes sipas zonave në përputhje me Shtojcën I;
- 1.2. të sigurohet që kërkesat minimale të përcaktuara në Shtojcën II janë zbatuar në vendet e klasifikuara në nën paragrafin 1.1;
- 1.3. të pajisë me shenja dalluese, kur është e nevojshme, vendet ku ambientet shpërthyes mund të krijohen në shkallë të tillë sa rrezikohet shëndeti dhe siguria e të punësuarit, në burim dhe pikat e hyrjes në përputhje me Shtojcën III të kësaj rregulloreje;
- 1.4. të sigurojë hartimin e një Dokumenti me shkrim të Mbrojtjes nga Shpërthimi dhe përditësimin e tij në përputhje me nenin 8.

2. Kur ambientet shpërthyes mund të krijohen në sasi të tilla që rrezikojnë sigurinë dhe shëndetin e të punësuarit, punëdhënësi siguron mbikëqyrje të përshtatshme ose/dhe monitorim të vazhdueshëm nëpërmjet përdorimit të mjeteve teknike në përputhje me vlerësimin e riskut, gjatë pranisë së të punësuarit.

Neni 7

Detyrimi për koordinim

1. Në rastet kur i punësuar nga ndërmarrje të ndryshme janë të pranishëm në të njëjtin vend pune:

- 1.1. secili punëdhënës është përgjegjës për të gjitha çështjet që janë nën kontrollin e tij;
- 1.2. punëdhënësi përgjegjës për vendin e punës koordinon zbatimin e të gjitha masave dhe procedurave që lidhen me sigurinë dhe shëndetin e të punësuarit;
- 1.3. punëdhënësi pasqyron në Dokumentin për Mbrojtjen nga Shpërthimi të përcaktuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje qëllimin, masat dhe mënyrat e zbatueshmërisë së këtij koordinimi

Neni 8

Dokumentit për Mbrojtjen nga Shpërthimi

1. Në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 54, punëdhënësi siguron hartimin dhe përditësimin e Dokumentit për Mbrojtjen nga Shpërthimi i cili pasqyron veçanërisht:

- 1.1. përcaktimin dhe vlerësimin e riskut për shpërthim;
- 1.2. marrjen e të gjitha masave të përshtatshme për të arritur qëllimin e kësaj rregulloreje ;
- 1.3. klasifikimin e vendeve në zona sipas Shtojcës I;
- 1.4. kërkesat minimale për përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, të përcaktuara në Shtojcën II, sipas zonave;
- 1.5. projektimin, vënien në punë dhe mirëmbajtjen e vendit dhe pajisjeve të punës, përfshirë edhe pajisjet paralajmëruese, duke marrë parasysh sigurinë;
- 1.6. koordinimin e masave dhe procedurave sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje.

2. Përmbajtja e Dokumentit për Mbrojtjen nga Shpërthimi, në mënyrë të detajizuar është e përcaktuar në Shtojcën 2, nënparagrafin 1.2.7 të kësaj rregulloreje.. Dokumenti për mbrojtjen nga shpërthimi hartohet përpara fillimit të punës dhe rishikohet në rastet kur vendi, pajisjet ose organizimi i punës pësojnë ndryshime, zgjerime ose shndërrime të rëndësishme.

3. Punëdhënësi mund të kombinojë vlerësimet ekzistuese të riskut nga shpërthimi, dokumente ose raporte të tjera të barazvlefshme të prodhuara në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Kërkesa të veçanta për pajisjet dhe vendet e punës

1. Pajisjet e punës për përdorim në vendet ku mund të krijohen ambiente shpërthyes janë në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në Shtojcën II.
2. Vendet e punës dhe hapësirat ku mund të krijohen ambiente shpërthyes duhet të jenë në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në këtë rregullore.
3. Për çdo ndryshim, zgjerim ose ristrukturim që kryhet në vendet e punës dhe hapësirat ku mund të krijohen ambiente shpërthyes, punëdhënësi merr masat e nevojshme në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në këtë rregullore.

Neni 10

Shtrojca

Shtojcat 1, 2 dhe 3 janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

SHTOJCA I

KLASIFIKIMI I VENDEVE KU MUND TË KRIJOHEN AMBIENTE SHPËRTHYESE

Shënim paraprak

Sistemi i klasifikimit në vijim duhet të aplikohet në vendet ku merren masa paraprake, në përputhje me Nenin 4 të kësaj rregulloreje.

1. Klasifikimi i vendeve

1.1 Një vend konsiderohet i rrezikshëm nëse në të mund të krijohet një ambiente shpërthyesë në shkallë të tillë, që të kërkojë masa speciale parandaluese për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e punëmarrësve në fjalë.

1.2 Një vend konsiderohet jo i rrezikshëm nëse në të nuk pritet të krijohet një atmosferë shpërthyesë në shkallë të tillë, që të kërkojë masa të veçanta parandaluese.

2. Klasifikimi i vendeve të rrezikshme

Vendet e rrezikshme klasifikohen zonat mbi bazën e shpeshtësisë dhe kohëzgjatjes së krijimit të një atmosfere shpërthyesë.

Niveli i masave që duhen marrë në përputhje me Shtojcën II/A, përcaktohet sipas këtij klasifikimi.

Zona 0

Një vend në të cilin një atmosferë shpërthyesë, e përbërë nga një përzierje me ajrin e substancave të ndezshme në formë gazi, avulli ose aerosoli, është e pranishme në mënyrë të vazhdueshme, për periudha të gjata ose shpesh.

Zona 1

Një vend në të cilin gjatë procesit normal të punës ekziston mundësia e krijimit të një atmosfere shpërthyesë, e përbërë nga një përzierje me ajrin e substancave të ndezshme në formë gazi, avulli ose aerosoli.

Zona 2

Një vend në të cilin një mjedis shpërthyes, i përbërë nga një përzierje me ajrin e substancave të ndezshme në formën e gazit, avullit ose lagështisë nuk ka gjasa të ndodhë gjatë operacioneve normale, por në qoftë se kjo ndodhë do të zhvillohet vetëm për një periudhë të shkurtër.

Zona 20

Një vend në të cilin, një ambient shpërthyes në formën të resë apo të pluhurit të djegshëm në ajër, është i pranishëm vazhdimisht, ose për periudha të gjata ose të shpeshta.

Zona 21

Një vend në të cilin, një mjedis shpërthyes në formën e një reje apo të pluhurit të djegshëm në ajër, ka të ngjarë të ndodhë herë pas herë gjatë operacionit normal.

Zona 22

Një vend në të cilin, një ambient shpërthyes në formën e një reje apo pluhuri të djegshëm në ajër, nuk ka të ngjarë të ndodhë gjatë operacionit normal, por, në qoftë kjo ndodh, do të zhvillohet vetëm për një kohë të shkurtër.

Shënime:

1. Shtresat, depozitat dhe grumbujt e pluhurit të djegshëm duhet të merren në konsideratë si çdo burim tjetër që mund të krijojë një atmosferë shpërthyes.

SHTOJCA II

A. PËR KËRKESAT MINIMALE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË TË PUNËMARRËSVE NË RISK NGA AMBIENTET SHPËRTHYESE

Shënim paraprak

Punëdhënësi është i detyruar të zbatojë kërkesat e përcaktuara në këtë shtojcë për: vendet e klasifikuara si të rrezikshme në përputhje me Shtojcën I, sa herë kjo kërkohet nga veçoritë e ambientit të punës, vendeve individuale të punës, pajisjet, substancat e përdorura ose rreziku i shkaktuar nga veprimtaria e lidhur me risqet nga ambientet shpërthyes, pajisjet për vende jo të rrezikshme që nevojiten dhe ndihmojnë sigurimin e funksionimit të sigurt të pajisjeve të ndodhura në vende të rrezikshme.

1. Masat organizative

1.1 Informimi dhe trajnimi i punëmarrësve

1.1.1. Punëdhënësi informon punëmarrësit dhe përfaqësuesit e tyre për të gjithë aspektet e mbrojtjes së punëmarrësve në risk nga atmosferat shpërthyes në vendin individual të punës;

1.1.2. Punëdhënësi informon punëmarrësin që punon në vende ku mund të krijohen atmosfera shpërthyes për Dokumentin e Mbrojtjes nga Shpërthimi dhe udhëzimet me shkrim të proceseve të punës;

1.1.3. Punëdhënësi u siguron punëmarrësve që punojnë në vendet ku mund të krijohen atmosfera shpërthyes, trajnim të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm në lidhje me përdorimin e pajisjeve dhe mbrojtjen nga shpërthimet.

1.2. Udhëzimet me shkrim dhe lejimi i përkohshëm për të hyrë dhe/ose punuar në ambientet shpërthyes

1.2.1. Punëdhënësi harton udhëzimet me shkrim të proceseve të punës në vendet e rrezikshme ku mund të krijohen atmosferat shpërthyes;

1.2.2. Punëdhënësi harton mënyrën e organizimit dhe funksionimit të procesit të lejimit të përkohshëm, për të hyrë dhe punuar në ambientet shpërthyes, me qëllim kryerjen e proceseve jo të zakonshme të punës, që lidhen me mirëmbajtjen, riparimin, pastrimin, ose çdo proces tjetër dhe merr masa për zbatimin e tij;

1.2.3. Udhëzimet me shkrim përmbajnë të paktën:

1.2.3.1. tabelat e të dhënave të sigurisë ose të dhëna të tjera për karakteristikat e substancave të pranishme dhe të përdorura, të cilat mund të krijojnë risqe të shpërthimit;

1.2.3.2. karakteristikat e vendeve që paraqesin risk shpërthimi;

1.2.3.3. udhëzime mbi procesin e punës, procedurat e konfigurimit, kontrollit dhe testimin të sistemeve mbrojtës, kontrollues, matës dhe sinjalizues;

1.2.3.4. masat për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe për mbrojtjen nga zjarri të cilat duhet të përdoren gjatë vënies në punë të pajisjeve dhe / ose ndalimit të tyre;

1.2.3.5. rregullat për procedurat e pastrimit;

1.2.3.6. kohëzgjatja dhe periudhat e kontrollit dhe testimin si dhe ekzaminimet e tjera specifike;

1.2.3.7. kohëzgjatja, periudhat dhe procesi i zbulimit të krijimit të substancave të ndezshme në formë gazi, avulli, aerosoli dhe pluhuri;

1.2.3.8; masat në rastin e krijimit të një atmosfere shpërthyes dhe të një risku serioz për shpërthim, përfshirë evakuimin nga vendi i punës, dhënien e ndihmës së parë dhe masat për të eliminuar pasojat e një shpërthimi;

1.2.3.9. lista e llojit të punëve për të cilat kërkohet leja për të punuar;

1.2.3.10. lista e personave përgjegjës për lëshimin e përkohshëm të lejes për të punuar.

1.2.4 Leja e përkohshme për të punuar duhet të përmbajnë të paktën:

1.2.4.1. emrin dhe funksionin e personit kompetent, përgjegjës për kryerjen e punës;

1.2.4.2. emrin dhe funksionin e personit kompetent, përgjegjës për mbikëqyrjen e punës së kryer;

1.2.4.3. lista e anëtarëve të grupit të punës që kryejnë punën;

1.2.4.4. përshkrimin me saktësi të vendit ku do të kryhet puna;

1.2.4.5. identifikimin e qartë të punës që do të kryhet;

1.2.4.6. identifikimin e rrezikut - cilat substanca të rrezikshme mund të krijohen;

1.2.4.7. shenjimin e vendit të punës;

1.2.4.8. mënyrën e mbikqyrjes;

1.2.4.9. mënyrën e pajisjes së punëmarrësve dhe vendit të punës me masa mbrojtëse dhe garantuese gjatë kryerjes së punës dhe pas përfundimit të punës;

1.2.4.10. masat parandaluese dhe mbrojtëse për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe për mbrojtjen nga zjarri dhe shpërthimi,

1.2.4.11. periudhën e vlefshmërisë së lejës.

1.2.5. Leja e punës jepet nga një person me përgjegjësi për këtë funksion përpara fillimit të punës, i caktuar nga punëdhënësi.

1.2.6 Anëtarët e grupit të punës të përmendur në nënparagrafin 3” të paragrafit 1.2.4 informohen me shkrim lidhur me përmbajtjen e lejës të përkohshëm për punë, shenjat paralajmëruese që informojnë rreth rrezikut të mundshëm të shpërthimit.

1.2.7. Dokumenti për Mbrojtjen nga Shpërthimi përmban të paktën:

1.2.7.1. përshkrimin e vendit të punës dhe zonave të punës, si emrin e ndërtesës, llojin e impiantit, projektin e ndërtesave/dhomave dhe personat përgjegjës, numrin e punëmarrësve;

1.2.7.2. përshkrimin e hapave dheaktiviteteve të procesit me anë të një teksti të shkurtër , mundësisht të kombinuar me një paraqitje grafike të tyre;

1.2.7.3. përshkrimin e substancave të përdorura/parametrave të sigurisë, listën e parametrave të dobishëm të sigurisë lidhur me mbrojtjen nga shpërthimi;

1.2.7.4 rezultatet e analizës së riskut, vendet/zonat e rrezikshme mund të përshkruhen me anë të një teksti dhe gjithashtu të paraqiten në mënyrë grafike në formën e planimetrisë së zonës;

1.2.7.5. masat teknike dhe organizative për mbrojtjen nga shpërthimi;

1.2.7.6. zbatimin e masave të mbrojtjes nga shpërthimi, kush është përgjegjës, efektshmëria e masës;

1.2.7.7. koordinimin e masave të mbrojtjes nga shpërthimi;

1.2.7.8. shtojcat e dokumentit të mbrojtjes nga shpërthimi, si certifikatat e testimi CE, certifikatat CE të konformitetit, tabelat e të dhënave të sigurisë, udhëzimet e përdorimit për pajisjen apo mjetet.

2. Masat për mbrojtjen nga shpërthimi

2.1. Çdo dalje dhe/ose lirim, qoftë i qëllimshëm ose jo, i gazrave, avujve, aerosoleve të ndezshëm ose pluhurave të djegshëm, që mund të krijojë rrezik për shpërthim, duhet të devijohet ose të largohet në mënyrë të përshtatshme në një vend të sigurt, ose, kur kjo nuk është e mundur praktikisht, të izolohet në mënyrë të sigurt ose të bëhet e sigurt nëpërmjet ndonjë metode tjetër të përshtatshme.

2.2. Nëse një atmosferë shpërthyesë përmban disa lloje gazesh, avujsh, aerosolësh ose pluhurash të djegshëm dhe të ndezshëm, masat parandaluese duhet të jenë të përshtatshme me riskun më të madh të mundshëm.

2.3. Parandalimi i rreziqeve të ndezjes në përputhje me nenin 4 të kësaj rregulloreje merr parasysh gjithashtu shkarkimet elektrostatische, kur punëmarrësit ose mjedisi i punës veprojnë si bartës ose prodhues të ngarkesave. Punëmarrësit duhet të pajisen me veshje pune të përshtatshme të bëra nga materiale që nuk prodhojnë shkarkime elektrostatische, të cilat mund të ndezin ambientet shpërthyesë.

2.4. Impianti, pajisjet, sistemet e mbrojtjes dhe çdo pajisje lidhëse ndërmjet tyre vihen në punë, vetëm nëse Dokumenti për Mbrojtjen nga Shpërthimi tregon se ato mund të përdoren në mënyrë të sigurt në një atmosferë shpërthyesë. Kjo zbatohet edhe për pajisjet e punës dhe pajisjet lidhëse që nuk konsiderohen si pajisje ose sisteme mbrojtëse sipas kuptimit të Rregullores për kërkesat teknike për pajisjet e përdorura në ambientet shpërthyesë, nëse montimi i tyre në një instalim mund të krijojë në vetvete një rrezik ndezjeje. Masa të nevojshme duhet të merren për të parandaluar ngatërrimin ndërmjet pajisjeve lidhëse.

2.5. Duhet të merren të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që vendi i punës, pajisjet e punës dhe çdo pajisje lidhëse ndërmjet tyre, të vëna në dispozicion të punëmarrësve, të jenë projektuar, ndërtuar, montuar dhe instaluar, mirëmbajtur dhe vënë në punë, në mënyrë të tillë që të minimizohen risqet e një shpërthimi dhe, nëse ndodh një shpërthim, të kontrollohet ose minimizohet përhapja e tij brenda atij vendi dhe/ose pajisje pune. Për vende të tilla pune merren masa të përshtatshme për të zvogëluar risqet për punëmarrësit nga pasojat fizike të një shpërthimi.

2.6. Kur është e nevojshme, punëmarrësve u jepen paralajmërime optike dhe/ose akustike dhe evakohen përpara se të jenë arritur kushtet e shpërthimit.

2.7. Kur kërkohet nga Dokumenti për Mbrojtjen nga Shpërthimi, daljet për evakuimin duhet të projektohen dhe të mirëmbahen për të siguruar që, në rast rreziku, punëmarrësit të mund të largohen nga vendet e rrezikuara në kohë në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt.

2.8. Përpara se vendi i punës që përmban hapësira ku mund të krijohen ambiente shpërthyes të përdoret për herë të parë, duhet të verifikohet siguria e tij e përgjithshme ndaj shpërthimit. Të gjitha kushtet e nevojshme për të siguruar mbrojtjen nga shpërthimi duhet të plotësohen . Ky verifikim duhet të kryhet nga persona që kanë eksperiencën dhe trajnimin e duhur profesional në fushën e mbrojtjes nga shpërthimet.

2.9. Kur vlerësimi i riskut tregon se është e nevojshme:

2.9.1. në rast se ndërprerja e energjisë sjell rreziqe shtesë, të sigurohet funksionimi në siguri të plotë i pajisjeve dhe sistemeve mbrojtëse, në mënyrë të pavarur nga pjesa tjetër e instalimit;

2.9.2. të jetë i mundur komandimi manual për të fikur pajisjen dhe sistemet mbrojtëse të montuara në proceset automatike, të cilat devijojnë nga kushtet e projektuara të funksionimit, me kusht që kjo të mos çënojë sigurinë. Këto ndërhyrje kryhen vetëm nga punëmarrësit kompetentë;

2.9.3.kur aktivizohet sistemi i fikjes në rast emergjence, energjia e akumuluar duhet të shpërndahet sa më shpejt dhe në mënyrën më të sigurt të mundshme, ose të izolohet në mënyrë që ajo të mos përbëjë më një rrezik.

B. KRITERE PËR PËRZGJEDHJEN E PAJISJEVE DHE SISTEMEVE MBROJTËSE

1.Nëse Dokumenti i Mbrojtjes nga Shpërthimi bazuar në vlerësimin e riskut nuk përcakton ndryshe, pajisjet dhe sistemet e mbrojtjes për të gjithë vendet ku mund të krijohen ambiente shpërthyes, përzgjidhen mbi bazën e kategorive të përcaktuara Rregulloren Nr.00/2014 “për pajisjet dhe sistemet mbrojtëse të destinuara për përdorim në atmosfera potencialisht shpërthyes” .).

2. e mëposhtme të pajisjeve përdoren në zonat e treguara, me kusht që ato të jenë të përshtatshme për gazrat, avujt, aerosolet dhe/ ose pluhurat sipas rastit:

2.1. pajisjet e kategorisë 1 në zonën 0 ose zonën 20,

2.2. pajisjet e kategorisë 1 ose 2 në zonën 1 ose zonën 21,

2.3. pajisjet e kategorisë 1, 2 ose 3 në zonën 2 ose zonën 22.

C. MASAT E VEÇANTA PËR VENDE ME RISK PËR SHPËRTHIME

1. Masat e veçanta të zbatueshme në vendet në ambiente shpërthyes janë si më poshtë:

- 1.1. Ndalohet përdorimi gjatë punës i substancave dhe pajisjeve të punës, që mund të ndezin atmosferën shpërthyes;
- 1.2. Temperatura e sipërfaqes ose e pajisjeve të punës, përfshirë instalimet dhe sistemet mbrojtëse nuk duhet të kalojë temperaturën e lejueshme, në vartësi të temperaturës minimale të ndezjes të substancës së ndezshme të pranishme.
2. Nëse risku i shpërthimit nuk eliminohet, është e nevojshme:
 - 2.1. të ndalohet puna dhe të urdhërohet evakuimi i punëmarrësve nga vendi i punës në rast të rritjes së përqendrimit të substancave të ndezshme të pranishme mbi 25% të nivelit të ulët të shpërthimit.
 - 2.2. të ndalohet hyrja në vendet e punës, në të cilat përqendrimi i substancave të ndezshme rritet mbi 50% të nivelit të ulët të shpërthimit.
3. I punësuar mund të lejohet:
 - 3.1. për të hyrë në vende me atmosferë shpërthyesë pasi të jetë siguruar oksigjeni të paktën në 19 % në vëllim. Në të kundërt, punëmarrësi është i detyruar të përdorë aparatin e frymëmarrjes së izoluar;
 - 3.2. për të punuar në vende me ambiente potencialisht shpërthyesë, ku përdoren pajisje të punës që mund të ndezin atmosferën shpërthyesë, vetëm pas zbulimit të substancave që potencialisht krijojnë atmosferë shpërthyesë dhe monitorimit të karakteristikave të mjedisit në çdo kohë gjatë punës.
4. Nxehtësia që krijohet gjatë punës duhet të reduktohet, në mënyrë që ajo të mos ndezë një atmosferë shpërthyesë.
5. Punëdhënësi duhet të informojë të punësuarin para hyrjes në një vend me atmosferë shpërthyesë, ku përqendrimi i substancave të ndezshme tejkalon vlerën maksimale të lejuar dhe e pajis me mjete mbrojtëse individuale të frymëmarrjes dhe të shpëtimit. Punëmarrësi duhet të shoqërohet (monitorohet) gjatë kësaj pune nga një i punësuar tjetër.
6. Të sigurohet vendi i punës me teknika të adekuate të sigurisë dhe ndihmës së parë.
7. Punëdhënësi është i obliguar të ofrojë trajnim praktik për punëmarrësin përpara fillimit të punës, veçanërisht lidhur me:
 - 7.1. përdorimin e aparaturës së frymëmarrjes së izoluar;
 - 7.2. veprimin në situata emergjence gjatë drejtimit të makinerisë dhe zbatimit të masave për të zvogëluar pasojat negative të shpërthimit.
8. Modulet e trajnimit përcaktohen nga punëdhënësi dhe kryhen të paktën një herë në vit.

SHTOJCA III

Shenja e paralajmërimit për vendet ku mund të krijohen ambiente shpërthyes, në bazë të nenit 6(1.3) të kësaj rregulloreje:



1.Vend ku mund të krijohet një atmosferë shpërthyes

1.1.Tipare dalluese:

1.1.1. formë trekëndore,

1.1.2. shkronja të zeza në sfond të verdhë me kontur të zi (pjesa e verdhë të zërë të paktën 50 % të sipërfaqes së shenjës).

2.Rekomandohet që shenjës t'i shtohen të dhëna të tjera shpjeguese si klasifikimi i zonës, substancat e pranishme në mjedis, masat e nevojshme, informacion mbi pajisjet mbrojtëse individuale të nevojshme, etj.

RREGULLORE (MPMS) Nr. 06/2016 - PËR KËRKESAT MINIMALE TË SIGURISË DHE SHËNDETIT PËR PUNËN ME PAJISJE ME EKRAN SHFAQËS

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit për punën me pajisje me ekran shfaqës.
2. Kjo rregullore është në përputhshmëri me Direktivën 90/270/KEE e datës 29 maj 1990 për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë për punën me pajisje me ekrane shfaqëse (Direktiva e pestë individuale në kuptim të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/KEE)

Neni 2

Fushveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që janë brenda fushës së veprimit të Ligjit nr. 04/L-161, datë 16.5.2013 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojit të ndërmarrjes dhe arsyeve për të cilat zhvillohet puna apo trajnimi në vendin e punës.
2. Kjo rregullore nuk zbatohet për:
 - 2.1. pajisjet me ekran shfaqës në kabinat e shoferëve ose kabinat e kontrollit për automjetet ose makineritë;
 - 2.2. sistemet kompjuterike në bordin e mjeteve të transportit;
 - 2.3. sistemet kompjuterike të cilat janë kryesisht për përdorim publik;
 - 2.4. pajisjet “lwvzwse” me ekran shfaqës jo me përdorim të zgjatur në një vend individual pune;
 - 2.5. makina llogaritëse, pajisjet numëruese te parave dhe çfarëdo pajisje që ka një ekran shfaqës të vogël të të dhënave ose të matjes, të nevojshëm për përdorimin direkt të pajisjes;
 - 2.6. makinat e shtypit me projektimin tradicional, të njohura si ”makina shtypi me dritare”.

Neni 3

Përkufizime

1. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, termit e mëposhtme kanë kuptimet:

1.1.” **Pajisje me ekran shfaqës**”- është çdo ekran shfaqës që reflekton shkronja, numra, shenja ose figura, pavarësisht procesit të shfaqjes që përdoret;

1.2. “ **Vendi individual i punës**”- është një tërësi elementesh që përfshin pajisjet me ekran shfaqës që mund të shoqërohen me tastierë ose pajisje për hedhjen e informacionit dhe/ose *software*-in i cili përcakton ndërfaqen operator-makinë, pajisjet ndihmëse fakultative, pajisjet e jashtme duke përfshirë telefonin, modem, printerin, mbajtësen e dokumenteve, karrigen dhe tryezën e punës ose sipërfaqen e punës, si dhe mjedisin e punës përreth tij.

1.3.” **I punësuar në punë me pajisje me ekran shfaqës** “- është çdo i punësuar siç përkufizohet në Ligjin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i cili përdor rregullisht pajisje me ekran shfaqës jo më pak se katër (4) ore punë në ditë.

Neni 4

Detyrimet e punëdhënësve

1. Punëdhënësi analizon vendet individuale të punës për të vlerësuar kushtet e sigurisë dhe shëndetit për të punësuarit, veçanërisht lidhur me risqet e mundshme për shikimin, lodhjen fizike dhe mendore.

2. Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për të korrigjuar kushtet e punës dhe për të zvogëluar ose eliminuar risqet e gjetura, mbi bazën e vlerësimit të përmendur në paragrafin 1, duke marrë parasysh efektet shtesë dhe të kombinuara të risqeve të konstatuara.

3. Punëdhënësi ndërmerr hapa të përshtatshme për të siguruar që vendi individual i punës të plotësojë kërkesat e përcaktuara në Shtojcën 1 të kësaj Rregulloreje.

4. Punëdhënësi planifikon veprimtaritë e të punësuarit në mënyrë të tillë që puna me ekran shfaqës të ndërpritet rregullisht, nëpërmjet pushimeve ose ndryshimeve të veprimtarisë, për të zvogëluar ngarkesën e punës me ekran shfaqës.

Neni 5

Informimi dhe trajnimi punëmarrësve

1. Pa e përjashtuar nenin 18 të Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë, punëdhënësi informon të punësuarin dhe përfaqësuesit e tyre për të gjitha aspektet e sigurisë dhe shëndetit mbi vendin e tyre individual të punës lidhur me pajisjet me ekran shfaqës,

veçanërisht për masat e përcaktuara në nenet 4 dhe 7, si dhe për çdo masë të sigurisë dhe shëndetit të marrë në përputhje me këtë Rregullore.

2. Punëdhënësi siguron trajnim të përshtatshëm për sigurinë dhe shëndetin në vendin individual të punës lidhur me pajisjet me ekran shfaqës, përpara fillimit të punës dhe sa herë që organizimi i vendit individual të punës ndryshon në mënyrë thelbësore.

Neni 6

Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve

Në përputhje me nenin 19 të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, punëdhënësi merr masa të përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarit dhe përfaqësuesit e tyre në lidhje me punën me pajisje me ekran shfaqës, rezultatet e analizës së vendeve të punës dhe masat që duhet të merren, për të zvogëluar dhe eliminuar aspektet negative të punës.

Neni 7

Mbikqyrja shëndetësore

1. Mbrojta e syve dhe e shikimit të punëmarrësve:

1.1. Punëdhënësi siguron për të punësuarin testim të përshtatshëm të syve dhe shikimit nga një specialist i fushës:

1.1.1. përpara fillimit të punës me ekrane shfaqëse;

1.1.2. më pas, në intervale të rregullta, minimumi një (1) herë në tri (3) vjet;

1.1.3. nëse paraqesin vështirësi të shikimit që mund të jenë për shkak të punës me ekrane shfaqëse.

1.2. Punëdhënësi siguron ekzaminim oftalmologjik për të punëmarrësin kur rezultatet e testit të përmendur në nenparagrafin 1.1 të këtij neni tregojnë se kjo është e nevojshme.

1.3. Nëse rezultatet e testit të përmendur në nenparagrafin 1.1, ose të ekzaminimit të përmendur në nenparagrafin 1.2 të këtij neni, tregojnë se është e nevojshme dhe nëse pajisjet korrigjuese për përdorim normal nuk mund të përdoren, punëdhënësi pajis të punësuarin me pajisje korrigjuese speciale të përshtatshme për punën në fjalë.

2. Nëse i punësuarit paraqet ndonjë problem shëndetësor në lidhje me punën me ekran shfaqës, punëdhënësi siguron ekzaminim shëndetësor të sistemit muskulo- skeletor, neurologjik dhe të venave.

3. Masat e marra në bazë të këtij Neni në asnjë rrethanë nuk mund t'i ngarkojnë të punësuarit me kosto financiare shtesë.

Neni 8

Shtojca

Shtojca 1 është pjesë përberëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

SHTOJCË

KËRKESAT MINIMALE

Koment paraparak

Detyrimet e përcaktuara në këtë Shtojcë zbatohen për të arritur objektivat e kësaj Rregulloreje në mënyrë që:

elementet e nevojshëm të pajisjeve me ekran shfaqës të jenë të pranishëm në vendin individual të punës, dhe

kërkesat baze ose karakteristikat e punës me pajisje me ekran shfaqës të mos e pengojnë zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Përshtatjet teknike me kërkesat e kësaj Rregulloreje duhet të marrin parasysh progresin teknik.

1. PAJISJET

1.1. Koment i përgjithshëm

1.1. Përdorimi i pajisjes me ekran shfaqës në vendin individual të punës nuk paraqet risk për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarit.

1.2. Ekрани shfaqës

1.2.1. Shenjat në ekran duhet të jenë mirë të përcaktuara dhe qartësisht të formuara, me përmasa të përshtatshme dhe me hapësirë të mjaftueshme ndërmjet shenjave dhe rreshtave;

1.2.2. Imazhi në ekran duhet të jetë i qëndrueshëm, pa dridhje ose forma të tjera të paqëndrueshmërisë;

1.2.3. Ndriqimi dhe kontrasti ndërmjet shenjave dhe sfondit janë lehtësisht të ndryshueshme nga punëmarrësi dhe lehtësisht të përshtatshme me kushtet e ambientit.

1.2.4. Ekрани duhet të jetë i kthyeshëm dhe i lëvizshëm për t'iu përshtatur nevojave të punësuarit

1.2.5. Duhet të jetë e mundur që për ekranin të përdoret një bazë apo një tavolinë e rregulluar.

1.2.6. Ekрани duhet të jetë pa shkëlqim verbues dhe reflektime që shkaktojnë parehati për të punësuarin.

1.2.7. Distanca optimale e të pamurit ndërmjet syrit të punësuarin dhe detajit të vëzhguar në ekran varet nga përmasa e detajit dhe ekranit shfaqës dhe është ndërmjet 500 – 700 mm. Distanca e të pamurit nuk duhet të jetë me e vogël se 400 mm.

1.3. Tastiera

1.1.1. Tastiera duhet të jetë e rregullueshme dhe ndarë nga ekranin në mënyrë që të lejojë punësuarin të gjejë pozicion të rehatshëm në punë duke shmangur lodhjen në krahe dhe duar.

1.1.2. Hapësira përballë tastierës duhet të jetë mjaftueshme për të ofruar mbështetje për duart dhe krahët e punësuarin.

1.1.3. Tastiera duhet të ketë një sipërfaqe jo reflektuese për të shmangur shkëlqimin verbues.

1.1.4. Dizajni dhe përmasat e butonave të tastierës lehtësojnë përdorimin e saj.

1.1.5. Simbolet në butonat e tastierës duhet të jenë me kontrast të mjaftueshëm dhe të lexueshme nga pozicioni normal i punës.

1.4. Tryeza e punës ose platforma e punës

1.4.1. Tryeza ose supina e punës duhet të ketë sipërfaqe të mjaftueshme, me reflektim të ulët dhe lejojnë vendosje të përshtatshme të ekranit, tastierës, dokumenteve dhe pajisjeve të lidhura.

1.4.2. Mbajtësja e dokumenteve duhet të jetë e qëndrueshme dhe e përshtatshme dhe pozicionohet në mënyrë që të minimizojë nevojën për lëvizje të parëhatshme të kokës dhe të syve.

1.4.3. Duhet të ketë hapësirë të mjaftueshme për të punësuarin që të kenë/gjejnë pozicion të rehatshëm.

1.5. Karrigia e punës

1.5.1. Karrigia e punës duhet të jetë e qëndrueshme dhe i lejon të punësuarit lirshmëri lëvizjeje dhe pozicion të rehatshëm.

1.5.2.Ndenjësja duhet të ketë lartësi te ndryshueshme prej 400 deri 520 mm, thellësi prej 350 deri 500 mm dhe gjerësi rreth 480 mm.

1.5.3.Mbështetësja e ndenjësës duhet të jetë e ndryshueshme në lartësi dhe në pjerrësi.

1.5.4.Është e volitshme që ndenjësja të jetë e pajisur me mbështetëse për çlodhjen e krahëve, me lartësi rreth 270mm mbi ndenjësën, gjerësi minimale prej 70 mm dhe distanca ndërmjet vendeve për çlodhjen e krahëve prej 500 mm.

1.5.5.Mbështetëse për këmbët ofrohet për çdo punëmarrës sipas kërkesës se tij. Mbështetësja për këmbët ka lartësi dhe pjerrësi të ndryshueshme nga 5° deri 15°, gjatësi minimale prej 450 mm, gjerësi minimale prej 300 mm dhe sipërfaqe jo rrëshqitëse.

2. MJEDISI

2.1. Kërkesa të hapësirës

2.1.1.Vendi individual i punës duhet të dimensionohet dhe dizajnohet në mënyrë që të sigurojë një hapësirë të mjaftueshme që përdoruesit të ndërrojnë pozitën dhe të ndryshojnë levizjet.

2.2. Ndriçimi

2.2.1. Ndriçimi i mjedisit të punës dhe ndriçimi i vendit individual të punës sigurohet në nivele nga 300 deri 700 luks, dhe me kontrast të përshtatshëm ndërmjet ekranit dhe mjedisit në sfond, duke marrë parasysh llojin e punës dhe nevojat e shikimit të përdoruesit.

2.2.2. Shkëlqimi i mundshëm verbues shqetësues dhe reflektimet në ekran ose pajisje të tjera parandalohen nëpërmjet përshtatjes së vendit të punës dhe vendit individual të punës me pozicionimin dhe karakteristikat teknike të burimeve artificiale të dritës.

2.3. Reflektimet dhe shkëlqimi verbues

2.3.1.Vendet individuale të punës projektohen në mënyrë të tillë që burimet e dritës, si dritaret dhe pjesë të tjera të hapura, sipërfaqet ndarëse të tejkrahshme ose që lejojnë kalimin e dritës, dhe instalimet ose muret e ngjyrosura me ngjyra të shndritshme, të mos shkaktojnë shkëlqim verbues të drejtpërdrejtë dhe as reflektime shpërqendruese mbi ekran.

2.3.2. Dritaret pajisen me sistem të përshtatshëm mbulimi të ndryshueshëm për të zbutur dritën e diellit që bie mbi vendin individual të punës.

2.4. Zhurma

2.4.1. Gjatë mobilimit të vendit ose vendeve individuale të punës, merret parasysh që zhurma e emetuar nga pajisjet të mos kalojë vlerën prej 60dB(A), nëse është zhurma e vazhdueshme të mos e kalojë vlerën prej 45 dB në vendin individual për të mos shpërqendruar vëmendjen ose vështirësuar komunikimin.

2.5. Temperatura

2.5.1. Pajisjet që i përkasin vendit ose vendeve individuale të punës nuk prodhojnë nxehtësi të tepërt që mund të shkaktojë parehati për të punësuarit, ku temperatura optimale është 22 - 27°C dhe temperatura e pranueshme 18 - 30°C.

2.6. Rrezatimi

2.6.1. Rrezatimi, me përjashtim të pjesës së dukshme të spektrit elektromagnetik, është në nivele të papërfillshme nga pikëpamja e mbrojtjes së sigurisë dhe shëndetit të punësuarin.

2.7 Lagështia

Niveli i lagështisë mbahet në nivele të pranueshme ndërmjet 30 - 70%.

3. NDËRFAQJA E OPERATORIT/ KOMPJUTERIT

Në projektimin, përzgjedhjen, autorizimin dhe modifikimin e *software*-it dhe në projektimin e detyrave që përfshijnë përdorimin e pajisjeve me ekran shfaqës, punëdhënësi merr parasysh parimet e mëposhtme:

3.1. *software*-i është i përshtatshëm për detyrën;

3.2. *software*-i është i lehtë për tu përdorur dhe, kur është e përshtatshme, i adaptueshëm me nivelin e njohurive ose përvojën e punëmarrësit; asnjë sistem kontrollues sasior ose cilësor nuk mund të përdoret pa dijeninë e të punësuarit;

3.3. sistemet i japin informacion punëmarrësit mbi ecurinë e punës së tyre;

3.4. sistemet paraqesin informacion në një format dhe në një ritëm të përshtatshëm për punësuarit;

3.5. parimet e ergonomisë së *software*-it zbatohen, në veçanti, për përpunimin e të dhënave njerëzore;

3.6. sistemet e kontrollit sasior dhe cilësor nuk mund të përdoren pa informimin paraprak të punësuarit.

RREGULLORE (MPMS) Nr.01/2017 - PËR MBROJTJEN E TË PUNËSUARËVE NGA RREZIQET LIDHUR ME DRIDHJEN NË VENDIN E PUNËS

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore, përcakton kërkesat minimale për mbrojtjen e e të punësuarëve nga rreziqet për sigurinë dhe shëndetin, që krijohen ose mund të krijohen nga ekspozimi ndaj dridhjes mekanike.
2. Kjo rregullore është në përputhshmëri me Direktivën 2002/44/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 25 qershor 2002, për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë në lidhje me ekspozimin e punonjësve ndaj rreziqeve që krijohen nga agjentët fizikë (dridhjet) (direktiva e gjashtëmbëdhjetë individuale në kuptim të nenit 16(1) të Direktivës 89/391/KEE).

Neni 2

Fushveprimi

1. Kërkesat e kësaj Rregulloreje zbatohen për vendet e punës dhe veprimtaritë, në të cilat të punësuarit janë të ekspozuar ose mund të ekspozohen ndaj rrezikut nga dridhjet mekanike gjatë punës së tyre.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha ndërmarrjet dhe vendet e punës që janë brenda fushës së veprimit të Ligjit nr. 04/L-161, datë 16.5.2013 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojit të ndërmarrjes dhe arsyeve për të cilat zhvillohet puna apo trajnimi në vendin e punës.

Neni 3

Përkufizime

1. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtme kanë këtë kuptim :
 - 1.1. **“Dridhje mekanike”** është një oshilacion mekanik rreth një pike ekuilibri. Në mjedisin e punës merret parasysh vetëm dridhja e transmetuar nga një mjedis i ngurtë në organizmin e njeriut;
 - 1.2. **“Dridhja dorë–krah”** është dridhje mekanike e transmetuar në trupin e njeriut nëpërmjet duarve, që përbën rrezik për sigurinë dhe shëndetin e të punësuarit, duke shkaktuar veçanërisht çrregullime vaskulare, të kockave ,artikulacioneve, neurologjikesi dhe muskulore;

1.3. **“Dridhja e të gjithë trupit”** është dridhja mekanike, e cila kur transmetohet në të gjithë trupin e njeriut nëpërmjet këmbëve, vitheve, shpinës dhe pjesëve anësore të trupit, përbën risk, duke shkaktuar veçanërisht sëmundje në pjesën e poshtme të shpinës dhe trauma të shtyllës kurrizore;

1.4. **“Ekspozimi ndaj dridhjes”** është veprimi i dridhjes në punëmarrësin gjatë një periudhe kohore të përcaktuar.

1.5. **“Ekspozimi ditor ndaj dridhjes”** është ekspozimi ndaj dridhjes gjatë një ditë pune prej 8 orësh, që mund të llogaritet sipas Shtojcës 3 të kësaj Rregulloreje;’

1.6. **“Vlera e veprimit të ekspozimit ditor $A(8)_{veprimi}$ ”** është vlera e ekspozimit ditor ndaj dridhjes në mjedisin e punës, e standardizuar në një periudhë reference prej tetë 8 orësh, që mund të përbëjë rrezik për sigurinë dhe shëndetinku duhen marrë masa për zvogëlimin ose shmangien e ekspozimit;

1.7. **“Vlera kufitare e ekspozimit ditor $A(8)_{kufi}$ ”** është vlera e ekspozimit ditor ndaj dridhjes, e standardizuar në një periudhë reference prej tetë orësh, e cila nuk duhet të tejkalohet për një punëmarrës gjatë ditës së tij të punës;

1.8. **“Vlera kufitare e ekspozimit afat shkurtër $A(0.5)_{kufi}$ ”**- është vlera e ekspozimit ndaj dridhjes, e cila nuk duhet të tejkalohet nga një punëmarrës gjatë një periudhe kohore prej 30 min ose më pak , që mund të llogaritet sipas shtojcës 3 të kësaj Rregulloreje;

1.9. **“Autoritetet kompetente”** janë institucionet përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Vlerat kufitare të ekspozimit dhe vlerat e veprimit të ekspozimit

1. Vlerat kufitare dhe vlerat e veprimit të ekspozimit për **dridhjen Dorë – krah** janë:

1.1. Të përgjithshme:

1.1.1. Vlera kufitare e ekspozimit ditor, $A(8)_{kufi}$ është 5 m/s^2 ;

1.1.2. Vlera kufitare e ekspozimit afat-shkurtër $A(0.5)_{kufi}$ është 16 m/s^2 ;

1.1.3. Vlera e veprimit e ekspozimit

ditor $A(8)_{\text{veprim}}$ është $2,5 \text{ m/s}^2$;

1.2. Për gratë shtatzëna dhe të punësuarit e mitur nën moshën 18 vjeç:

1.2.1. Vlera kufi e ekspozimit ditor $A(8)_{\text{kufi}}$ është $1,4 \text{ m/s}^2$;

1.2.2. Vlera kufi e ekspozimit afat – shkurtër $A(0.5)_{\text{kufi}}$ është 6 m/s^2 .

1.3. Ekspozimi i të punësuarëve ndaj dridhjes dorë- krah vlerësohet ose matet siç përcaktohet në pikën A të Shtojcës 1.

2. Vlerat kufitare dhe vlerat e veprimit të ekspozimit për dridhjen e të gjithë trupit janë:

2.1. Të përgjithshme:

2.1.1. Vlera kufitare e ekspozimit ditor $A(8)_{\text{kufi}}$ është $1,15 \text{ m/s}^2$;

2.1.2. Vlera kufitare e ekspozimit afat – shkurtër $A(0.5)_{\text{limit}}$ është $4,6 \text{ m/s}^2$;

2.1.3. Vlera e veprimit të ekspozimit ditor $A(8)_{\text{veprim}}$ është $0,5 \text{ m/s}^2$.

2.2. Për gratë shtatzëna, ndalohet terresisht ekspozimi ndaj dridhjes;

2.3. Për të punësuarit e mitur nën moshën 18 vjeç:

2.3.1. Vlera kufitare e ekspozimit ditor $A(8)_{\text{kufi}}$ është $0,3 \text{ m/s}^2$;

2.3.2. Vlera kufitare e ekspozimit afat-shkurtër $A(0.5)_{\text{kufi}}$ është $1,1 \text{ m/s}^2$.

2.4. Ekspozimi i të punësuarëve ndaj dridhjes së të gjithë trupit vlerësohet ose matet siç përcaktohet në pikën B të Shtojcës 1.

Neni 5

Vlerësimi i riskut

1. Punëdhënësi, në përputhje me nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, siguron vlerësimin e risqeve që mund të shkaktohen nga dridhja mekanike, ndaj të cilit janë të ekspozuar të punësuarit. Nëse pritet tejkalim i vlerës

së veprimit të ekspozimit ditor, kryhen matjet e nevojshme të niveleve të dridhjes mekanike. Kjo realizohet në përputhje me pikën 2 të Pjesës A ose pikën 2 të pjesës B të Shtojcës 1 të kësaj Rregulloreje, sipas rastit.

2. Niveli i ekspozimit ndaj dridhjes mekanike mund të vlerësohet nëpërmjet vrojtimit të praktikave specifike të punës dhe referimit tek informacioni përkatës mbi magnitudën e mundshme të dridhjeve që i korrespondon pajisjeve ose llojeve të pajisjeve të përdorura në kushte të veçanta të përdorimit, përfshirë informacione të ofruara nga prodhuesi i pajisjes. Ky vlerësim dallohet nga matja, e cila kërkon përdorimin e aparateve specifike dhe të metodologjisë së përshtatshme.

3. Vlerësimi i riskut kryhet nga shërbime të specializuara sipas legjislacionit në fuqi, në intervalet e mëposhtme:

3.1. çdo vit nëse vlerësimi i riskut tregon se vlerat e veprimit të ekspozimit e kanë arritur vlerën referente të përcaktuar Nenit 3 ose i kanë tejkaluar ato;

3.2. çdo dy vjet nëse vlerësimi i riskut tregon se vlerat e veprimit të ekspozimit nuk janë arritur dhe 1/5 e vlerës kufitare të ekspozimit është tejkaluar.

4. Nëse vlerësimi i riskut i kryer dy herë në një interval prej 2 vitesh tregon se 1/5 e vlerës kufitare të ekspozimit nuk është arritur, punëdhënësi mund të mos e vazhdojë vlerësimin e mëtejshëm, me përjashtim të rasteve kur ka pasur ndryshime të rëndësishme, që e bëjnë vlerësimin e riskut të pavlefshëm, ose kur rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore tregojnë se kjo është e nevojshme.

5. Vlerësimi i riskut mund të përfshijë një arsyetim nga ana e punëdhënësit që natyra dhe shkalla e risqeve të lidhura me dridhjen mekanike bëjnë të panevojshëm një vlerësim të mëtejshëm të detajuar të risqeve.

6. Gjatë kryerjes së vlerësimit të riskut, punëdhënësi i kushton vëmendje të veçantë aspekteve të mëposhtme:

6.1. nivelit, llojit dhe kohëzgjatjes së ekspozimit, përfshirë edhe çdo ekspozim ndaj dridhjeve të ndërprera ose goditjeve të përsëritura;

6.2. vlerave kufitare të ekspozimit dhe vlerave të veprimit të ekspozimit, të përcaktuara në nenin 3 të kësaj Rregulloreje;

6.3. çdo efekti mbi sigurinë dhe shëndetin e grupeve më të ndjeshme të punëmarrsve ;

6.4. çdo efektindirekt mbi sigurinë dhe shëndetin e të punësuarëve, që rezultojnë nga ndërveprimet mes dridhjeve mekanike dhe vendit të punës ose pajisjeve të tjera të punës, veçanërisht nëse dridhja çrregullon funksionimin normal të elementeve drejtues të pajisjes ose leximin e shenjave të vendosura, ose ndikon në qëndrueshmërinë e strukturës dhe sigurinë e makinerive;

- 6.5. çdo informacioni të ofruar nga prodhuesit e pajisjeve të punës;
- 6.6. pranisë së pajisjeve të tjera alternative të prodhuara për të reduktuar nivelet e ekspozimit ndaj dridhjes mekanike;
- 6.7. zgjatjes së ekspozimit ndaj dridhjeve të të gjithë trupit përtej kohës normale të punës nën përgjegjësinë e punëdhënësit;
- 6.8. kushteve specifike të punës, të tilla si temperaturat e ulëta ose lagështia dhe të tjera;
- 6.9. informacionit të siguruar nga mbikëqyrja shëndetësore, përfshirë informacione të publikuara, kur kjo është e mundur.
7. Të dhënat nga vlerësimi dhe matja e nivelit të ekspozimit ndaj dridhjes mekanike ruhen në formë të përshtatshme, që të jenë të disponueshme për përdorim të mëvonshëm, sipas legjislacionit në fuqi. Vlerësimi i riskut do të dokumentohet në baza të rregullta, veçanërisht nëse ka pasur ndryshime të rëndësishme që e bëjnë atë të pavlefshëm, ose kur rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore tregojnë se kjo është e nevojshme.
8. Vlerësimi i riskut përfshin edhe informacion mbi ndikimin e masave që duhen marrë sipas neneve 6 dhe 7 të kësaj Rregulloreje.

Neni 6

Shmangia ose zvogëlimi i ekspozimit ndaj dridhjes

1. Punëdhënësi duhet që të ndërmarrë masat e nevojshme që rreziku nga ekspozimi i e të punësuarëve ndaj dridhjes të eliminohet në burim.. ur kjo nuk është e mundur, risku duhet të zvogëlohet në minimum, duke marrë parasysh progresin teknik dhe ekzistencën e masave për kontrollin e riskut në burim, bazuar në parimet e përgjithshme të parandalimit të riskut sipas pikës 1.3 të nenit 8 7 të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”
2. Mbi bazën e vlerësimit të riskut, kur tejkalohe vlerat e veprimit të ekspozimit të përcaktuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje, punëdhënësi harton dhe zbaton një plan të masave teknike dhe/ose organizative, që synojnë zvogëlimin në minimum të ekspozimit ndaj dridhjes mekanike dhe risqeve të lidhura me të, duke marrë parasysh në veçanti:
- 2.1. metoda të tjera të punës, që mundësojnë ekspozim më të vogël ndaj dridhjes mekanike;
- 2.2. përzgjedhjen e pajisjeve të duhura të punës me projektim të përshtatshëm ergonomik, që shkaktojnë dridhje në nivelin më të ulët të mundshëm, duke pasur parasysh punën që duhet kryer;

- 2.3. sigurimin e pajisjeve ndihmëse që reduktojnë riskun e dëmtimeve të shkaktuara nga dridhja, si ndenjës të në mënyrë të efektshme zvogëlojnë dridhjen e të gjithë trupitdhedorëzat që zvogëlojnë dridhjen e transmetuar në sistemin dorë- krah;
 - 2.4. plane të përshtatshme për mirëmbajtjen e pajisjeve të punës, vendit të punës dhe sistemeve të vendit të punës;
 - 2.5. projektimin dhe organizimin e vendeve të punës dhe vendeve individuale të punës;
 - 2.6. informimin dhe trajnimin e përshtatshëm për të udhëzuar të punësuarit mbi përdorimin e pajisjeve të punës në mënyrë korrekte dhe të sigurt, në mënyrë që ekspozimi i tyre ndaj dridhjes mekanike të zvogëlohet në minimum;
 - 2.7. kufizimin e kohëzgjatjes dhe intensitetit të ekspozimit;
 - 2.8. grafikë të përshtatshëm të punës me periudha të mjaftueshme për çlodhje, ku të punësuarit nuk ekspozohen ndaj dridhjes;
 - 2.9. sigurimin e veshjeve mbrojtëse për të punësuarit e ekspozuar ndaj të ftohtit dhe lagështisë.
3. Ekspozimi i të punësuarëve nuk lejohet të kalojë vlerat kufitare të ekspozimit, sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje. Nëse konstatohen ekspozime mbi vlerat kufitare të ekspozimit, punëdhënësi:
- 3.1. ndërmerr veprime të menjëhershme për ta reduktuar ekspozimin nën vlerat kufitare të ekspozimit;
 - 3.2. identifikon arsyet përse ka ndodhur mbi ekspozimi;
 - 3.3. merr masa për të parandaluar çdo përsëritje.
4. Punëdhënësi përshtat masat e përmendura në këtë nen me kërkesat e të punësuarëve me ndjeshmëri të lartë ndaj riskut.

Neni 7

Informimi dhe trajnimi i të punësuarëve

1. Pa cënuar nenin 18 dhe 20 të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” punëdhënësi garanton që të punësuarit e ekspozuar ndaj risqeve të dridhjes mekanike në punë si dhe përfaqësuesit e tyre të marrin informacion dhe trajnim të mjaftueshëm.
2. Informimi dhe trajnimi i të punësuarëve të ekspozuar përfshijnë në veçanti:

- 2.1. masat e marra për të shmangur ose zvogëluar në minimum risqet nga dridhja mekanike;
- 2.2. vlerat kufitare të ekspozimit dhe vlerat e veprimit të ekspozimit;
- 2.3. rezultatet e vlerësimit të riskut, së bashku me një interpretim të tyre dhe risqeve potenciale;
- 2.4. rëndësinë dhe mënyrën e konstatimit dhe raportimit të shenjave të dëmtimit;
- 2.5. rrethanat, në të cilat e të punësuarëve u lind e drejta për mbikëqyrje shëndetësore, dhe qëllimin e kësaj mbikëqyrjeje, sipas nenit 9 të kësaj rregulloreje;
- 2.6. grafikët e përshtatshëm të punës me periudha të mjaftueshme të çlodhjes pa ekspozim ndaj dridhjes;
- 2.7. praktikatat e sigurta të punës për të minimizuar ekspozimin ndaj dridhjes mekanike.

Neni 8

Konsultimi dhe pjesëmarrja e e të punësuarëve

Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e të punësuarëve, në përputhje me nenin 19 të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, në veçanti lidhur me vlerësimin e riskut dhe masat e marra ose që duhen marrë për të shmangur ose zvogëluar ekspozimin ndaj dridhjeve , në përputhje me nenet 5, 6 dhe 7 të kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Punëdhënësi merr masa për kryerjen e mbikëqyrjes shëndetësore të të punësuarëve, për të cilët vlerësimi i riskut që paraqet rrezik për shëndetin nga dridhja, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën përkatëse për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore.
2. Mbikëqyrja shëndetësore dhe ekzaminimet mjekësore, rezultatet e të cilave merren parasysh në zbatimin e masave parandaluese në një vend pune të caktuar, synojnë parandalimin dhe diagnostikimin e shpejtë të çdo çrregullimi lidhur me ekspozimin ndaj dridhjes mekanike. Mbikëqyrja shëndetësore kryhet kur:
 - 2.1. mund të provohet një lidhje ndërmjet ekspozimit ndaj dridhjes në vendin e punës dhe një sëmundjeje të identifikueshme ose efekteve të dëmshme mbi shëndetin;

2.2. është e mundur që sëmundje apo efekte të dëmshme të shkaktohen në kushte të veçanta të punës të një punëmarrësi, dhe,

2.3. ekzistojnë ekzaminime për diagnostikimin e sëmundjeve ose të efekteve të dëmshme për shëndetin.

3. Në çdo rast, të punësuarit e ekspozuar ndaj dridhjes mekanike përtej vlerave të përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje duhet të kenë kontrollë shëndetsore.

4. Lloji dhe shpeshtësia e ekzaminimeve mjekësore të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni janë përcaktuar në shtojcën 4 të kësaj Rregulloreje.

5. Kur nga mbikëqyrja shëndetësore mjeku i punës konstaton së punëmarrësi ka një sëmundje të identifikueshme ose pasojë negative në shëndet, si rezultat i ekspozimit ndaj dridhjes mekanike në punë:

5.1. i punësuarit informohet nga mjeku i punës mbi rezultatin e mbikëqyrjes shëndetësore që lidhet me të personalisht dhe, në veçanti, merr informacion dhe këshillim lidhur me çdo mbikëqyrje shëndetësore, së cilës duhet t'i nënshtrohet pas përfundimit të ekspozimit;

5.2. punëdhënësi informohet për çdo gjetje të rëndësishme nga mbikëqyrja shëndetësore, duke marrë parasysh konfidencialitetin mjekësor.

5.3. punëdhënësi:

5.3.1. rishikon vlerësimin e riskut;

5.3.2. rishikon masat e parashikuara për të shmangur ose zvogëluar risqet në bazë të nenit 6 të kësaj Rregulloreje;

5.3.3. merr parasysh çdo këshillë të dhënë nga mjeku i punës, nga një person me kualifikim të përshtatshëm ose nga autoriteti kompetent për zbatimin e masave për shmangien ose zvogëlimin e riskut, përfshirë mundësinë e caktimit të të punësuarit në një punë tjetër, ku nuk ka risk për ekspozim të mëtejshëm ndaj dridhjes;

5.3.4. siguron mbikëqyrje të vazhdueshme shëndetësore dhe ofron një ekzaminim të shëndetit të çdo punëmarrësi tjetër, i cili ka qenë i ekspozuar në mënyrë të ngjashme.

6. Të dhënat e mbikëqyrjes shëndetësore, përfshirë konkluzionet mbi aftësinë për punë për secilin punëmarrës, dokumentohen dhe përditësohen nga mjeku i punës, në përputhje me Legjislacionin për mbikëqyrjen shëndetësore dhe atë për mbrojtjen e të dhënave personale, në mënyrë që të jetë i mundur shqyrtimi i tyre i mëvonshëm.

Punëmarrësi me kërkesë të tij ka qasje tek të dhënat e kartelës së tij të shëndetit në punë. Kopje të kartelave të shëndetit në punë i vihen në dispozicion autoritetit kompetent me kërkesë të këtij të fundit.

Neni 10

Shtojcat

Shtojcat 1, 2, 3 dhe 4 janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

RREGULLORE (MPMS) Nr.02/2017 - PËR MBROJTJEN E E TË PUNËSUARËVE NGA RREZIQET LIDHUR ME ZHURMËN NË VENDIN E PUNËS

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo Rregullore përcakton kërkesat minimale të nevojshme për mbrojtjen e e të punësuarëve nga rreziqet për sigurinë dhe shëndetin, të cilat krijohen ose mund të krijohen nga ekspozimi ndaj zhurmës në vendet e punës, dhe, në veçanti, riskun për dëmtimin e dëgjimit.

2. Kjo rregullore është në përputhshmëri me Direktiva 2003/10/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 6 shkurt 2003 për kërkesat minimale të shëndetit dhe sigurisë lidhur me ekspozimin e punonjësve ndaj risqeve që krijohen nga agjentët fizikë (zhurma, (Direktiva e shtatëmbëshjetë individuale brenda kuptimit të nenit 16(1) të Direktivës 89/391/KEE).

Neni 2

Fushveprimi

1. Kërkesat e kësaj Rregulloreje zbatohen për veprimtaritë në punë në të cilat të punësuarit janë ose ka të ngjarë të ekspozohen ndaj rreziqeve nga zhurma.

2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha vendet e punës që janë brenda fushës së veprimit të Ligjit nr. 04/L-161, datë 14 Qershor 2013 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, pavarësisht mënyrës së organizimit, llojit të ndërmarrjes dhe arsyeve për të cilat zhvillohet puna apo trajnimi në vendin e punës.

Neni 3

Përkufizime

1. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, termat e mëposhtme kanë këtë kuptim :

1.1. “**Zhurme**” është çdo tingull i padëshiruar që është shqetësues ose i dëmshëm për shëndetin ose që mund të rrisë riskun për aksidente në punë;

- 1.2. “**Niveli ditor i ekspozimit ndaj zhurmës ($L_{EX, 8h}$)**”² është mesatarja e ponderuar (përlllogaritur) në kohën e niveleve të ekspozimit ndaj zhurmës të ponderuar në A për një ditë punë nominale prej tetë orësh, që përcaktohet siç përshkruhet në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje;
- 1.3. “**Niveli javor i ekspozimit ndaj zhurmës ($L_{EX, \dot{e}}$)**”³ është mesatarja e ponderuar në kohë e niveleve të ekspozimit ndaj zhurmës ponderuara (përlllogaritura) sipas A (sipas ISO 1999), për një javë nominale prej pesë ditësh pune tetë-orëshe, siç përshkruhet në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje;
- 1.4. “**Niveli i zhurmës impulsive**” është niveli kulmor (*peak*) i presionit të tingullit, i ponderuar në C (L_{Cpeak})⁴ ndaj të cilit ekspozohet një punëmarrës, që përcaktohet siç përshkruhet në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje;
- 1.5. “**Vlera kufitare e ekspozimit**” është niveli i ekspozimit ditor, javor ose niveli i presionit kulmor të tingullit të ponderuar në C (sipas ISO 1999), që nuk duhet të tejkalohet në vendin e punës;
- 1.6. “**Vlerat e sipërme dhe të poshtme të veprimit të ekspozimit**” janë nivelet ditore, javore të ekspozimit ose niveli i presionit kulmor të tingullit të ponderuar në C, që nëse arrihen ose tejkalohen, kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve të veçanta për të reduktuar riskun, sipas neneve 5, 7, 8 dhe 10 të kësaj Rregulloreje;
- 1.7. “**Autoritetet kompetente**” janë institucionet përgjegjëse për sigurinë dhe shëndetin në punë, sic e përcakton legjislacioni në fuqi.

Neni 4

Vlerat kufitare të ekspozimit dhe vlerat e veprimit

1. Vlerat kufitare të ekspozimit janë:

1.1. të përgjithshme:

1.1.1. Niveli ditor ose javor i ekspozimit ndaj zhurmës ($L_{EX, 8h}$ ose $L_{EX, \dot{e}}$) prej 87 dB;

1.1.2. Niveli i zhurmës impulsive (L_{Cpeak}) prej 140 dB.

1.2. për të punësuarit e mitur (nën 18

² L_{EX} : Level of Exposure (niveli i ekspozimit), h: hours (orë)

³ L_{EX} : Level of Exposure (niveli i ekspozimit), w: weeks (javë)

⁴ L: level (niveli), peak (kulm)

vjeç):

1.2.1. Niveli ditor ose javor i ekspozimit ndaj zhurmës ($L_{EX,8h}$ ose $L_{EX,\dot{e}}$) prej 80 dB;

1.2.2. Niveli i zhurmës impulsive (L_{Cpeak}) prej 130 dB.

1.3. për gratë shtatzëna:

1.3.1. Niveli ditor ose javor i ekspozimit ndaj zhurmës ($L_{EX,8h}$ ose $L_{EX,\dot{e}}$) prej 65 dB;

1.3.2. Niveli i zhurmës impulsive (L_{Cpeak}) prej 130 dB.

2. Vlerat e sipërme të veprimit të ekspozimit janë:

2.1. Niveli ditor ose javor i ekspozimit ndaj zhurmës ($L_{EX,8h}$ ose $L_{EX,\dot{e}}$) prej 85 dB;

2.2. Niveli i zhurmës impulsive (L_{Cpeak}) prej 137 dB.

3. Vlerat e poshtme të veprimit të ekspozimit janë:

3.1. Niveli ditor ose javor i ekspozimit ndaj zhurmës ($L_{EX,8h}$ or $L_{EX,\dot{e}}$) prej 80 dB;

3.2. Niveli i zhurmës impulsive (L_{Cpeak}) prej 135 dB.

4. Në respektimin e vlerave kufitare të ekspozimit merret parasysh zbutja që realizohet nga mbrojtësit individualë të dëgjimit, të cilët mbahen nga punëmarrësit, me përjashtim të grave shtatzëna. Vlerat e veprimit të ekspozimit nuk marrin parasysh efektet e mbrojtësve individual.

5. Kur ekspozimi i një punëmarrësi ndaj një zhurme ndryshon dukshëm nga njëra ditë në tjetrën, për vlerësimin e riskut në vend të nivelit ditor mund të përdoret niveli javor i ekspozimit ndaj zhurmës, me kusht që niveli javor i ekspozimit ndaj zhurmës sic tregohet nga një monitorim i përshtatshëm të mos tejkalojë vlerën kufitare të ekspozimit prej 87 dB. Nëse kalohet kjo vlerë duhet të mëren masat reduktimit e riskut.

Neni 5

Vlerësimi i riskut

1. Punëdhënësi, në përputhje me nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” siguron kryerjen e vlerësimit të riskut, ku identifikohen masat që

duhen marrë dhe, nëse është e nevojshme, siguron gjithashtu kryerjen e matjeve të nivelit të zhurmës në vendin e punës.

2. Metodatat dhe pajisjet e përdorura për vlerësimin e riskut janë në përputhje me standardet aktuale europiane dhe ndërkombëtare, sipas Shtojcës II të kësaj Rregullore.

3. Matjet dhe vlerësimi i riskut planifikohen dhe zhvillohen nga shërbime të specializuara sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

4. Të dhënat e siguruar nga vlerësimi i riskut dhe matja e nivelit të ekspozimit ndaj zhurmës ruhet në një formë të përshtatshme që lejon konsultimin në një fazë të mëvonshme.

5. Vlerësimi i rezultateve të matjeve merr në konsideratë pasaktësitë e matjes të përcaktuara në përputhje me praktikën metrologjike.

6. Matjet dhe vlerësimi i riskut kryhen rregullisht në vendin e punës, sipas rastit, si dhe kur punëdhënësi ka në posedim dokumentin e vlerësimit të riskut ku janë identifikuar masat që duhen ndërmarrë.

Neni 6

Shpeshtësia e kryerjes së vlerësimit të riskut

1. Shpeshtësia e kryerjes së vlerësimit të riskut është si më poshtë:

1.1. të paktën një herë në dy vite nëse vlerësimi i riskut tregon që vlerat e poshtme të veprimit të ekspozimit janë arritur ose janë tejkaluar dhe vlerat e sipërme të veprimit të ekspozimit nuk janë arritur;

1.2. të paktën një herë në vit nëse vlerësimi i riskut tregon që vlerat e sipërme të veprimit të ekspozimit janë arritur ose janë tejkaluar;

2. Vlerësimet e mëtejshme të riskut mund të mos kryhen, nëse vlerësimi i riskut tregon që vlerat e poshtme të veprimit të ekspozimit nuk janë arritur.

3. Në çdo rast, nëse ka pasur ndryshime përmbajtësore në procesin e punës ose kur rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore tregojnë se kjo është e nevojshme, duhet të ndermerren masa të menjëhershme për kryerjen e matjeve dhe vlerësimeve shtesë.

4. Vlerësimi i riskut përfshin:

- 4.1. nivelin, llojin dhe kohëzgjatjen e ekspozimit, ndaj zhurmës impulsive;
- 4.2. vlerat kufitare të ekspozimit dhe vlerat e veprimit të ekspozimit të përcaktuara në Nenin 4 të kësaj Rregullore;
- 4.3. efektet e ekspozimit ndaj zhurmës tek punëmarrësit ose grupet e të punësuarëve, shëndeti i të cilëve është në risk të veçantë nga një ekspozim i tillë;
- 4.4. çdo efekt në shëndetin dhe sigurinë e të punësuarëve që rezulton nga ndërveprimet ndërmjet zhurmës dhe substancave ototoksike të lidhura me punën, si dhe ndërmjet zhurmës dhe dridhjeve;
- 4.5. çdo efekt të tërthortë mbi sigurinë dhe shëndetin e të punësuarëve që rezulton nga ndërveprimi ndërmjet zhurmës dhe sinjaleve paralajmëruese zanore si dhe tingujve të tjerë që duhet të jenë të dëgjueshëm për të reduktuar riskun në punë;
- 4.6. çdo informacion i siguruar nga prodhuesi i pajisjeve të punës;
- 4.7. praninë e pajisjeve alternative të projektuara për të reduktuar emetimin e zhurmës;
- 4.8. informacion mbi çdo zgjatje të ekspozimit ndaj zhurmës në vendin e punës përtej kohës normale të punës, përfshirë ekspozimin në mjediset e çlodhjes të mbikëqyrura nga punëdhënësi;
- 4.9. çdo informacion të siguruar nga mbikëqyrja shëndetësore, përfshirë informacione të publikuara sipas nevojës;
- 4.10. pajisjen me mjete mbrojtëse personale të dëgjimit me karakteristika të përshtatshme të zvogëlimit së zhurmës.

5. Punëdhënësi dokumenton vlerësimin e riskut dhe masat që ka ndermarrë ose synon të ndermarrë për të përmbushur kërkesat e neneve 5, 6, 7, 8 dhe 9 të kësaj Rregulloreje.

Neni 7

Shmangia ose zvogëlimi i ekspozimit ndaj zhurmës

1. Punëdhënësi garanton që risku nga ekspozimi i e të punësuarëve ndaj zhurmës të shmanget që në fazën e projektimit, dhe më tej në burim, dhe kur kjo nuk është e mundur, të zvogëlohet në minimum, duke marrë parasysh progresin teknik dhe ekzistencën e masave për kontrollin e riskut në burim, bazuar në parimet e përgjithshme të parandalimit të riskut sipas paragrafit 1.3 të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”.

2. Zvogëlimi i risqeve nga ekspozimi ndaj zhurmës merr parasysh në veçanti:

2.1. mënyra të tjera të punës, që mundësojnë ekspozim më të vogël ndaj zhurmës;

2.2. përzgjedhjen e pajisjeve të përshtatshme të punës, që emetojnë zhurmën më të vogël të mundshme duke pasur parasysh punën që duhet kryer;

2.3. projektimin dhe strukturën adekuate të vendeve të punës dhe vendeve individuale të punës;

2.4. informimin dhe trajnimie përshtatshëm, për të udhëzuar punëmarrësit mbi përdorimin e duhur të pajisjeve të punës, për të minimizuar ekspozimin e tyre ndaj zhurmës;

2.5. zvogëlimin e zhurmës nëpërmjet mjeteve teknike, si:

2.5.1. zvogëlimi i zhurmave ajrore

përmes ekraneve mbrojtëse,

rrethimeve, mbulesave që përthithin

zhurmën;

2.5.2. zvogëlimi i zhurmës strukturore, si me anë të izolimit ose amortizimit të strukturave që shkaktojnë dridhje;

2.6. plane të përshtatshme të mirëmbajtjes për pajisjet e punës, vendin e punës dhe sistemet në vendin e punës;

2.7. kufizimin e kohëzgjatjes dhe intensitetit të ekspozimit ndaj zhurmës;

2.8. organizimin e përshtatshëm të kohës së punës me periudha të mjaftueshme çlodhjeje.

3. Nëse vlerat e sipërme të veprimit të ekspozimit arrihen ose tejkalohen, punëdhënësi harton dhe zbaton një plan me masa teknike dhe organizative, që synojnë zvogëlimin e ekspozimit ndaj zhurmës, sipas nenit 6 të kësaj rregulloreje dhe paragrafit 1 të këtij neni.

4. Mbi bazën e vlerësimit të riskut, vendet e punës ku ekspozimi ndaj zhurmës arrin ose tejkalon vlerat e sipërme të veprimit të ekspozimit shënjohe me shenja të

përshtatshme; zonat në fjalë kufizohen dhe qasja në to kufizohet kur është teknikisht e mundur dhe risku i ekspozimit e arsyeton një gjë tilla.

5. Në mjediset për çlodhjen e e të punësuarëve, punëdhënësi siguron që ekspozimi ndaj zhurmës të reduktohet në një nivel të përshtatshëm për qëllimin dhe kushtet e përdorimit të tyre.

6. Punëdhënësi zbaton masat e përmendura sipas këtij neni, duke pasur parasysh në veçanti kërkesat për të punësuarit e grupeve me ndjeshmëri të lartë ndaj zhurmës, sipas nenit 4 paragrafit 1 nenparagrafit 1.2 dhe 1.3, të kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Kufizimi i ekspozimit

1. Ekspozimi i e të punësuarëve nuk lejohet të kalojë vlerat kufitare të ekspozimit sipas nenit 4 të kësaj Rregulloreje.

2. Nëse konstatohen ekspozime mbi vlerat kufitare të ekspozimit, punëdhënësi:

2.1. ndërmerr veprime të menjëhershme për ta reduktuar ekspozimin poshtë vlerave kufitare të ekspozimit;

2.2. identifikon arsyet përse ka ndodhur mbi ekspozimi;

2.3. ndërmerr masa për të parandaluar çdo përsëritje.

Neni 9

Mbrojtja individuale

1. Nëse rreziqet që krijohen nga ekspozimi ndaj zhurmës nuk mund të parandalohen me metoda dhe mjete të tjera, dhe kur ekspozimi ndaj zhurmës arrin ose tejkalon vlerat e poshtme të veprimit të ekspozimit, punëdhënësi vë në dispozicion të e të punësuarëve pajisje mbrojtëse personale të dëgjimit të përshtatshme sipas përmasave të duhura.

2. Nëse rreziqet që krijohen nga ekspozimi ndaj zhurmës nuk mund të parandalohen me mjete të tjera dhe ekspozimi ndaj zhurmës arrin ose tejkalon vlerat e sipërme të veprimit të ekspozimit, përdoren pajisje mbrojtëse personale të dëgjimit, të përshtatshme sipas përmasave të duhura si dhe përdorimi i tyre mbikëqyret nga punëdhënësi.

3. Punëdhënësi përzgjedh për të punësuarit, pajisjet mbrojtëse personale të dëgjimit të përshtatshme dhe në përmasat e duhura, sipas legjislacionit në fuqi për pajisjet mbrojtëse personale, si dhe në përputhje me standardet aktuale europiane dhe

ndërkombëtare si dhe sipas Shtojcës II të kësaj Rregulloreje për të eliminuar riskun për dëgjimin ose për të reduktuar riskun në minimum.

4. Punëdhënësi është përgjegjës për inspektimin e efektshmërisë së masave të marra në përputhje me këtë nen.

5. Ky nen nuk zbatohet:

5.1. në situata ku, për shkak të natyrës së punës, përdorimi i duhur i pajisjeve mbrojtëse personale të dëgjimit mund të shkaktojë rreziqe më të mëdha për shëndetin ose sigurinë se sa mospërdorimi i tyre, veçanërisht nga persona që drejtojnë operacionet e shpëtimit për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit, mbrojtjen e pronës ose mjedisit si dhedhe parandalimin e katastrofave natyrore;

5.2. për artistët në performancat muzikore dhe të argëtimit.

6. Të punësuarit, subjekt sipas paragrafit 5 të këtij neni, i nënshtrohen mbikëqyrjes shëndetësore të përforcuar.

Neni 10

Informimi dhe trajnimi i e të punësuarëve

1. Pa cenuar nenin 18 dhe 20 të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” nëse vlerësimi i riskut tregon ekspozim të e të punësuarëve ndaj zhurmës në ose mbi një vlerë të poshtme të veprimit të ekspozimit, punëdhënësi informon, udhëzon dhe trajnon punëmarrësit dhe përfaqësuesit e tyre në mënyrë të përshtatshme dhe të mjaftueshme.

2. Informimi dhe trajnimi i e të punësuarëve të ekspozuar ndaj zhurmave përfshijnë në veçanti:

2.1. natyrën e rreziqevenga ekspozimi ndaj zhurmës;

2.2. masat organizative dhe teknike të marra për të eliminuar ose reduktuar në minimum rreziqet nga zhurma;

2.3. vlerat kufitare të ekspozimit dhe vlerat e poshtme të veprimit të ekspozimit;

2.4. rezultatet e vlerësimit të riskut, së bashku me një interpretim të tyre dhe rreziqeve potenciale;

2.5. disponueshmërinë dhe përdorimin korrekt të pajisjeve mbrojtëse të dëgjimit;

2.6. rëndësinë dhe mënyrën e konstatimit dhe raportimit të shenjave të dëmtimit të dëgjimit;

2.7. rrethanat në të cilat të punësuarit kanë të drejtë për mbikëqyrje shëndetësore dhe qëllimin e kësaj mbikëqyrjeje sipas nenit 9 të kësaj Rregulloreje;

2.8. praktikat e sigurta të punës për të minimizuar ekspozimin ndaj zhurmës.

Neni 11

Konsultimi dhe pjesëmarrja e e të punësuarëve

1. Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e e të punësuarëve, në përputhje me zbatimin e dispozitave të nenit 19 të Ligjit Nr. 04/L-161 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, në veçanti lidhur me:

1.1. vlerësimin e riskut dhe masat e marra ose që duhet ndër marrë për të shmangur ose zvogëluar ekspozimin ndaj zhurmës, në përputhje me nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9 të kësaj Rregulloreje;

1.2. përzgjedhjen e mjeteve mbrojtëse personale të dëgjimit në përputhje me nenin 9 të kësaj Rregulloreje.

Neni 12

Mbikëqyrja shëndetësore

1. Punëdhënësi merr masa për të siguruar mbikëqyrjen shëndetësore të punësuarëve, për të cilët vlerësimi i riskut tregon se vlerat e poshtme të veprimit të ekspozimit janë arritur ose janë tejkaluar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe praktikën përkatëse për sistemin e mbikëqyrjes shëndetësore.

2. Gjithashtu:

2.1. Nëse ekspozimi ndaj zhurmës tejkalon vlerat e sipërme të veprimit, punëdhënësi ofron me kërkesë të e të punësuarëve të ekspozuar, kontroll të dëgjimit nga një mjek otojatër.

2.2. Kur vlerësimi i riskut tregon se ekspozimi ndaj zhurmës arrin ose tejkalon vlerat e poshtme të veprimit:

2.2.1. kryhet një test fillestar audiometrik në fillim të punës;

2.2.2. kryhen teste të mëtejshme audiometrike të paktën një herë në vit për të kontrolluar nëse punëmarrësi është ose jo i mbi ndjeshëm ndaj zhurmës dhe, pas kësaj periudhe, të paktën një herë në tri (3) vjet;

2.2.3. nëse konstatohet një përkeqësim serioze i dëgjimit të një punëmarrësi, atëherë janë të nevojshme teste audiometrike më të shpeshta ose largimi nga kjo punë.

2.3. Kur si rezultat i mbikëqyrjes shëndetësore një punëmarrës konstatohet me një dëmtim serioz të dëgjimit, mjeku i punës, i cili, kur e konsideron të nevojshme, mund të konsultohet me një specialist të fushës, vlerëson nëse dëmtimi është rezultat ose jo i ekspozimit ndaj zhurmës në punë.

2.4. Nëse dëmtimi i dëgjimit është rezultat i ekspozimit ndaj zhurmës në punë, punëdhënësi:

2.4.1. nëpërmjet mjekut të punës informon punëmarrësin mbi rezultatet e mbikëqyrjes shëndetësore të tij.

2.4.2. rishikon vlerësimin e riskut;

2.4.3. rishikon masat e marra për të shmangur ose zvogëluar risqet;

2.4.4. merr parasysh çdo këshillë të mjekut të punës, të një personi me kualifikim të përshtatshëm ose të një autoriteti kompetent në zbatimin e masave për shmangien ose zvogëlimin e riskut, përfshirë mundësinë e caktimit të punëmarrësit në një punë alternative, ku nuk ka risk nga ekspozimi ndaj zhurmës;

2.4.5. siguron mbikëqyrje të vazhdueshme shëndetësore dhe ofron një ekzaminim të shëndetit të çdo të punësuarit tjetër, i cili ka qenë i ekspozuar në mënyrë të ngjashme.

3. Të dhënat e mbikëqyrjes shëndetësore për secilin të punësuar dokumentohen dhe përditësohen, në përputhje me legjislacionin për mbikëqyrjen shëndetësore. Këto të dhëna mbahen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe në mënyrë të tillë që të jetë i mundur shqyrtimi i tyre i mëvonshëm. I punësuarit me kërkesë të tij ka qasje tek të dhënat e shëndetit që kanë lidhje me të personalisht. Kopje të kartelave të shëndetit në punë i vihen në dispozicion autoritetit kompetent me kërkesë të këtij të fundit.

Neni 13

Shtojcat

Shtojcat 1 dhe 2 janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale.

SHTOJCA I

(neni 2)

NIVELET E EKSPOZIMIT NDAJ ZHURMËS

NIVELI DITOR I EKSPOZIMIT

1. Niveli Ditor i Ekspozimit ndaj Zhurmës ($L_{EX,8h}$) është mesatarja e ponderuar në kohë e niveleve të ekspozimit ndaj zhurmës të ponderuar në A për një ditë punë nominale prej 8 orësh; i përcaktuar në standardin ndërkombëtar ISO 1999: (Akustika— Përcaktimi i ekspozimit në punë ndaj zhurmës dhe vlerësimi i dëmtimit të dëgjimit të induktuar nga zhurma) klauzola 3.6, shprehet në decibel dhe përcaktohet duke përdorur formulën:

$$L_{EX,8h} = L_{Aeq,T_e} + 10 \log \left(\frac{T_e}{T_0} \right) \text{ dB}$$

Ku:

T_e është kohëzgjatja e ditës së punës së personit, në orë (ose në minuta);

T_0 është koha e referencës e barabartë me 8 orë (ose 480 minuta);

L_{Aeq,T_e} është niveli i presionit të tingullit i ponderuar në A, siç përcaktohet në ISO 1999: (Akustika— Përcaktimi i ekspozimit në punë ndaj zhurmës dhe vlerësimi i dëmtimit të dëgjimit të induktuar nga zhurma) klauzola 3.5, në decibel, që përfaqëson tingullin, ndaj të cilit personi ekspozohet gjatë ditës së punës.

2. Nëse puna është e tillë, që ekspozimi ditor përbëhet nga dy ose më shumë periudha me nivele të ndryshme të tingullit, niveli ditor i ekspozimit personal ndaj zhurmës ($L_{EX,8h}$) për kombinimin e periudhave përcaktohet sipas formulës:

$$L_{EX,8h} = 10 \log \left[\frac{1}{T_0} \sum_{i=1}^{i=n} (T_i 10^{0.1(L_{Aeq,T_i})}) \right]$$

Ku:

n është numri i periudhave kohore individuale gjatë ditës së punës;

T_i është kohëzgjatja e periudhës kohore i ;

(L_{Aeq,T_i}) është niveli ekuivalent i vazhdueshëm i presionit të tingullit të ponderuar në A që përfaqëson tingullin ndaj të cilit personi ekspozohet gjatë periudhës i ; $\sum_{i=1}^n T_i$ është shuma e periudhave kohore individuale, e barabartë me T_e .

NIVELI JAVOR I EKSPOZIMIT NDAJ ZHURMËS

Niveli Javor i Ekspozimit Personal ndaj Zhurmës ($L_{EX,8}$) është mesatarja e ponderuar në kohë e niveleve të ekspozimit ndaj zhurmës, ponderuar në A për një javë nominale prej pesë ditësh pune prej tetë orësh; i përcaktuar në standardin ndërkombëtar ISO 1999: (Akustika— Përcaktimi i ekspozimit në punë ndaj zhurmës dhe vlerësimi i dëmtimit të dëgjimit të induktuar nga zhurma), klauzola 3.6, shprehet në decibel dhe përcaktohet me formulën:

$$L_{EX,W} = 10 \log \left[\frac{1}{5} \sum_{i=1}^{i=n} (T_i 10^{0.1(L_{EX,8h,i})}) \right]$$

Ku:

n është numri i ditëve të punës në të cilat personi ekspozohet ndaj zhurmës gjatë një jave;

$L_{EX,8h,i}$ është $L_{EX,8h}$ për ditën e punës i .

NIVELI I ZHURMËS IMPULSIVE

Niveli i zhurmës impulsive (L_{Cpeak}) do të thotë vlera kulmore e presionit të zhurmës të ponderuar në frekuencën C, ndaj të cilit ekspozohet një punëmarrës.

L_{Cpeak} , shprehet në decibel dhe përcaktohet duke përdorur formulën:

$$L_{Cpeak} = 20 \log \left(\frac{p_{Cpeak}}{p_0} \right)$$

Ku:

p_{Cpeak} është vlera kulmore e presionit të tingullit të ponderuar në C, në Paskal (Pa), ndaj të cilit është ekspozuar një person gjatë ditës së punës;

p_0 është $20 \mu\text{Pa}$.

SHTOJCA II

REFERENCA TË STANDARDEVE TË REKOMANDUARA

(Neni 4, neni 7)

Standarde lidhur me matjen e zhurmës:

- ISO 1999, Acoustics – Determination of occupational noise exposure and estimation of noise-induced hearing impairment (Akustika— Përcaktimi i ekspozimit në punë ndaj zhurmës dhe vlerësimi i dëmtimit të dëgjimit të induktuar nga zhurma).
- ISO 9612, Acoustics – Determination of occupational noise exposure – Engineering method (Akustika— Përcaktimi i ekspozimit në punë ndaj zhurmës—metoda inxhinierike).

Standarde lidhur me aparatet:

- IEC 60942, Electroacoustics- Sound calibrators (Elektroakustika— Kalibrues të tingullit)
- IEC 61252, Electroacoustics- Specifications for personal sound exposure meters (Elektroakustika— Specifikime për matësit e ekspozimit personal ndaj tingullit)
- IEC 61672-1, Electroacoustics- Sound level meters- Part 1: Specifications (Elektroakustika— Matësit e nivelit të tingullit— Pjesa 1: Specifikimet)

Standard lidhur me mbrojtësit e dëgjimit:

- EN 458, Hearing protectors. Recommendations for selection, use, care and maintenance. Guidance document. (Mbrojtësit e dëgjimit. Rekomandime për përzgjedhjen, përdorimin, kujdesin dhe mirëmbajtjen. Dokument udhëzues.)

KY PUBLIKIM ËSHTË REALIZUAR ME NDIHMËN E ZYRËS SË BE NË KOSOVË. PËRMBAJTJA E KËTIJ PUBLIKIMI ËSHTË PËRGJEGJËSI E VET ARCHIDATA DHE NË ASNJË MËNYRË NUK PARAQET QËNDRIMET E BASHKIMIT EUROPIAN.